



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 3. 5. 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 3. 05. 2012. GODINE**

**MAJ– MAJA
2012**

E enjte, më 3.5. 2012

Drejton seancën kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hapim punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me kryetarët e grupeve parlamentare.

Për diskutime jashtë rendit të ditës nuk na duhet kuorumi.
Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës-

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Sipas radhës të lajmëruar me elektronikë, fjalën e ka deputetja Alma Lama. Nuk është.
Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedniče,
Uvaženi zamenice premijera,
Uvaženi ministri,
Kolege deputeti,

Za ovom govornicom htela bi izraziti jedno veliko zahvalnost Ministarstvu za Kulturu, Omladinu i Sport, odnosno ministru Memljiu Krasnićiju, njenom sekretaru Vetonu Firziju, kao i Ministarstvu za Zajednice i Povratak, ministru Radojci Tomiću, koji su nam pomogli da organizujemo jednu veliku kulturnu - sportsko manifestaciju u našem kraju, u Prizrenskoj opštini, na kojoj je bilo prisutno više od 10 hiljada ljudi. Tako da se u ime organizacionog odbora, u ime Bošnjačke Zajednice, još jednom zahvaljujem pomenuti ministrima. Zahvaljujem, predsedniče!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Haki Demolli,

HAKI DEMOLLI: Kryetar, në emër të Grupit Parlamentar, thash.

Të nderuar deputetë,
Kosova si njëri prej shteteve më të ri në botë, fatkeqësisht është duke dështuar në masë të madhe në aplikimin praktik të sundimit të ligjit, jo vetëm në rrafshin e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, por edhe në sferën e krimit dhe shpëputjes së marrëdhënies së punës. Konkretisht, në këtë sferë shumë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve të rëndomtë të Kosovës, në njërin anën kemi punëdhënësin e në anën tjetër punëtorin. Këto dy subjekte krijojnë marrëdhënie në të cilat për fat të keq punëdhënësi synon shfrytëzimin maksimal të fuqisë punëtore përmes një eksploatimi të egër dhe rëndom të kundërligjshëm, e në anën tjetër ekziston punëtori në një gjendje tejte të rëndë ekonomike, puna e të cilit nuk shpërblehet thajse as për minimumin ekzistencial të tij.

Në kushte dhe rrethana të këtilla është sajuar dhe funksionon tregu i punës në Kosovë , i cili dominohet nga kërkesat e qindra, mijëra kosovarëve për punë si një nevojë e mbijetesës e në anën tjetër haset oferta minimale për punë nga punëdhënësit.

Aktualisht, sipas vlerësimeve të institucioneve ndërkombëtare të biznesit në Kosovë, është e papunë mbi 40% e fuqisë punëtore.

Ky fakt krijon rrethanë tejet të volitshme për punëdhënësin jo vetëm për përzgjedhje dhe pagesë të punëtorëve, por edhe për keqpërdorime të shumta gjatë punësimit dhe largimit të punëtorëve.

Sipas Bankës Botërore Kosova zë vendin e 34 në rrafshin e punësimit dhe shkarkimit, fakt që ilustron situatën e pasigurt në të cilën ndodhet punëtori kosovar.

Pasojat e kësaj pasigurie tanimë i kanë përjetuar me qindra kosovarë, kurse unë po i theksoj vetëm disa prej rasteve të paraqitura gjatë vitit të fundit.

Në maj të vitit 2011 në Spitalin Rajonal të Prizrenit janë larguar pa paralajmërim 22 punëtorë, me pretekst se nuk ka buxhet të mjaftueshëm.

Në qershor të vitit 2011 u larguan pa paralajmërim 16 punëtorë të Hotelit Grand, ndonëse pronarët e hotelit me rregullat e privatizimit, janë të obliguar të mbajnë numrin e caktuar të punëtorëve.

Në gusht të vitit 2011, pra 63 punëtorëve të Fabrikës së Tubave iu ishte ndaluar të shkojnë në vendin e punës, ndonëse po atë ditë ishin larguar një muaj më parë.

Në dhjetor të vitit 2011, KEP- Trusti ka paralajmëruar 60 punëtorë të sigurimit fizik pa paralajmërim se do t'i largojë nga puna dhe do t'i hedh në rrugë.

Në mars të këtij viti “Kosova-teks” e privatizuar në vitin 2006 me spinof special, për shkak të krizës në tregjet evropiane, ka larguar përkohësisht 95 punëtorë.

Në prill të vitit 2012 “Sharçemi” ka hequr nga lista e pagave 86 punëtorë duke i dërguar në pushim me pagesë ndonëse me paragrafët e privatizimit të “Sharçemit” figuron zotimi i bërë për t'i trajtuar vendet e të gjithë punëtorëve në tri vjetët në vijim.

Duke pasur parasysh këtë pasiguri juridike në të cilin ndodhet punëtori kosovar, këtë nëpërkëmbje dhe mospërfillje të dinjitetit dhe personalitetit të tij, kërkoj nga Inspektorati i Punës, nga Ministria e Punës si dhe nga të gjitha organet tjera kompetente të vendit, që të angazhohen maksimalisht në zbatimin strikt të dispozitave për marrëdhënien e punës dhe në këtë mënyrë t'i ofrojmë punëtorit kosovar mbrojtje ligjore të drejtave të tij. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja, Alma Lama.

ALMA LAMA: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Sot është Dita botërore e lirisë së shtypit. Liria e shprehjes është një e drejtë themelore e shënuar në nenin 19 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut. Po kështu edhe në

Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut, neni 10 thotë se kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë pjesë dhe për të dhënë informata ose mendime, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë shtetëror.

Një nga vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, i cituar më së shumti është formuluar kështu.

Liria e shprehjes është një nga shtyllat e shoqërisë demokratike bazë për zhvillimin e saj dhe kusht për vetë realizimin e individit. Ajo nuk mund të përfshijë vetëm informacionet dhe opinionet e perceptuara pozitivisht ose të konsideruara si të padëmshme apo indiferente, por edhe të tilla që fyejnë, turbullojnë apo që janë shqetësim për shtetin dhe për një grup të caktuar të shoqërisë. Të tilla janë kriteret e pluralizmit, të tolerancës dhe të hapjes, pa të cilat një shoqëri demokratike nuk mund të ekzistojë.

Edhe Kosova në Kushtetutën e saj ka marrë përsipër të respektojë këto konventa të nxjerra nga institucionet ndërkombëtare, mirëpo çfarë po ndodh në praktikë?

Faktet e përditshme tregojnë se numri i mediave në Kosovë, që nuk u nënshtrohen autoriteteve shtetërore, është më i pakët se gishtat e njërës dorë; se Qeveria dhe institucionet e tjera përpiqen të në mënyrë sistematike të pengojnë lirinë e mediave, të cilat nuk i shkojnë asaj përshtat, që kritikojnë, publikojnë artikuj me fakte komprometuese apo inkriminuese. Faktet tregojnë se autoritetet në Kosovë, veçanërisht ato qeveritare një pjesë të mirë të mediave i ka vënë nën kontroll dhe i përdorin ato për interesa ditore, kryesisht për të bërë propagandë. Faktet tregojnë se gazetarët profesionistë dhe me integritet moral shpesh detyrohen ta braktisin profesionin, pasi hapësira e tyre është ngushtuar si pasojë e obstrukcioneve të vazhdueshme në lirinë e mediave.

Gazetaria investigative në Kosovë, e cila është më e rëndësishmja në vendet demokratike, ende është në hapat e saj fillestar, megjithë përpjekjet që bëhen nga disa media. Atmosfera në Kosova është tepër e rrezikshme për investigim.

Nga ana tjetër gazetarët hasin në vështirësi të jashtëzakonshme për të marrë dokumente zyrtare, pasi Ligji për qasje në dokumente zyrtare nuk gjen zbatim as në institucione qendrore dhe as në ato lokale. Të sigurosh dokumente për një tender publik, është më e vështirë se të marrësh një dokument që përbën sekret shtetëror.

E kam fjalën për ndonjë vend tjetër se Kosova s'ka as sekrete shtetërore.

Por sikur te mos mjaftonin te gjitha këto, dy javë më parë ishte Kuvendi ai që u bë obskurantisti kryesor i lirisë së mediave, kur vendosi të miratojë nenin 37 të Kodit Penal, nen

i cili, ashtu siç është krijon mundësi të pafund për inkriminimin e mediave dhe i shpall ato fajtores kujdestare sa herë t'ju teket autoriteteve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Jo asnjë minutë, respektoni kohën. Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Para disa ditëve, para Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, studentët e Fakultetit të Muzikës, protestuan dhe kërkuan kushte më të mira për të studiuar, hapësira për ushtrimet e tyre dhe kështu me radhë.

Ndërsa nga Rektorati si përgjigje morën, injorancën dhe neglizhencën. Zëdhënësja e Rektoratit, në vend që t'i trajtonte kërkesat e studentëve me seriozitet dhe me sinqeritet, ajo i përqeshi studentët duke iu drejtuar se sot nuk po dëgjon kërkesa, por po dëgjon muzikë. Prandaj, kërkoj nga Rektorati i Universitetit të Prishtinës dhe nga të gjitha organet kompetente, që kërkesat e studentëve, pavarësisht se nga cili fakultet vijnë, t'i trajtojnë me seriozitet, sepse janë pjesa më vitale e Kosovës. Andaj, le të jetë kjo hera e fundit që dikush nga institucionet e vendit përqesh studentët dhe kërkesat e tyre. Falemnderit, shumë!

KRYETARI: Fjalën e ka Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zotni kryetar,

Zotni zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Më 15 mars, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me një shumicë të cilësuar përtej 80 deputetë, ka votuar një rezolutë me të cilën në pikën 2 thotë: "që Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk lejon kurrfarë zgjedhje të Serbisë në Kosovë dhe e obligon Qeverinë që ta zbatojë këtë vendim".

Lëvizjet e ditëve të fundit, sidomos ato që kemi dëgjuar më shumë nëpër mjete të komunikimit se sa në komunikime institucionale, thonë, që është OSBE-ja që ka marrë pajtimin e Qeverisë së Kosovës dhe të Serbisë që të bëhen zgjedhje ose votime në Republikën e Kosovës, për zgjedhje presidenciale dhe parlamentare të Serbisë. Thuhet që këto votime do t'i bëjë OSBE-ja me një farë roli, ta quajmë ne të një ambasadë, meqë Serbia s'paska ambasadë në Kosovë.

E para, është jo ligjore që një organizatë e tillë të marrë rolin e ambasadës të një shteti në Kosovë, që i bie që është bërë palë.

Dhe e dyta, unë mendoj që është koha që para 6-it Qeveria para Kuvendit të tregojë- a ka lejuar të mbahen zgjedhje parlamentare, presidenciale të Serbisë në Kosovë dhe pse dhe me

këtë veprim a e ka shkelur Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 15 mars 2012? Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Falemnderit!

I nderuar zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Me anë të këtij fjalimi dua ta ngre shqetësimin tim si deputete dhe të 17 mijë banorëve të katër lagjeve të qytetit të Gjakovës, të cilët tashmë disa ditë me radhë kanë reaguar kundër një vendimi të njëanshëm që ka marrë kryetari i komunës së Gjakovës, Pal Lekaj, për ngritjen e një përmendore të dëshmorit Agron Rama, në sheshin e lagjes” Mulla Isuf.”

Jemi shumë të shqetësuar me faktin se nuk është rasti i vetëm që qeverisja lokale tenton të ekspozohet para qytetarëve duke i përdorur dëshmorët e kombit, bile duke nxitur urrejtje, fshat – qytet.

Qytetarët janë shumë të revoltuar se kaluan 13 vjet pas luftës së fundit në Kosovë e për dëshmorët dhe martirët e rënë të këtij qyteti nuk është ngritur ende një lapidar, përkujtimore që tani pas 13 vjetëve, mu në lagjen më të frekontuar “Mulla Isuf” është paraparë të ngritët lapidari apo busti për një dëshmor.

Me fillimin e punimeve në sheshin e kësaj lagje, është vërejtur se po ndërtohet edhe bazamenti për lapidar, i cili është kërkuar që të ngritët katër vjet më parë dhe nga kuvendi komunal është premtuar se do të shqyrtohet mundësia e ngritjes së lapidarit për dëshmorët dhe martirët e kësaj lagje.

Po në ndërkohë kanë marrë njohuri se aty do të ngrihet lapidari i dëshmorit nga Smolica dhe komandat i dalluar, i cili së shpejti do të shpallet hero i kësaj komune e që lapidari i tij meriton në ngritët në qendër të qytetit.

Unë personalisht jam banor e njërës prej këtyre katër lagjeve dhe pasi që reagimi i këtyre qytetarëve ka hasur në vesh të shurdhër nga ana e udhëheqjes komunale dhe pasi që këta banorë kanë bërë thirrje për gjithë deputetë e komunës tonë, që të dëgjojnë nga afër problemin e tyre, unë jam gjendur pranë, jo për ndonjë marketing politik, por thjesht për respektin ndaj këtyre të rënëve në luftën e fundit.

Pasi që jam njoftuar konkretisht me problemin, kam tentuar që të kontaktoj direkt me kryetarin në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për shqetësimin e qytetarëve. Fatkeqësisht, kryetari ka nënvlerësuar kërkesën tonë dhe para nesh ka dërguar kryesuesin Agim Koci, i cili pat thënë, fatkeqësisht se nuk i dinte as emrat e të rënëve, ku filloi të shkruante aty në një fletore dhe nuk ishte në gjendje të na epte një përgjigje në mënyrë që ne t'i qetësonim familjarët dhe banorët që protestonin para kuvendit, përveç se do të shqyrtohet mundësia të takoheni me kryetarin javën e ardhshme.

Dje, bashkë me familjarët, jemi takuar me kryetarin Pal Lekaj, i cili përveç që kishte një sjellje arrogante, me sharje dhe fyerje dhe në vend se të jepte një përgjigje konform kërkesave të tyre dhe insistimit tim që të sqarojë vendimin e njëanshëm që e ka marrë, ai kujdesej që të na rikujtonte se vendimet i merr vetë dhe se nuk njih as president as kryeministër se lere më mua si deputete.

Shfrytëzoj rastin që nga kjo foltore t'i bëj thirrje Ministrisë së Pushtetit Lokal që t'ia rikujtojë zotit Lekaj mandatin e deputetit, të drejtat dhe përgjegjësitë që i kanë të garantuara me ligj si dhe i lus kolegët deputetë nga AAK, që të ndikojnë te kryetari Lekaj, që të jetë më i përgjegjshëm ndaj qytetarëve të komunës sonë dhe mos të shkelë mbi betimin e dhënë si kryetar.

Sikurse që në takimin e parë, ashtu vazhdoj t'i lus familjarët dhe banorët që ta ruajnë qetësinë, se mjaft kemi vuajtur qyteti ynë dhe veçanërisht ato lagje dhe se nuk e meritojmë edhe këtë.

Andaj i inkurajoj dhe i mbështes që bashkërisht ta ndjekim rrugën institucionale, përmes petitionit dhe kërkesës në Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe qoftë nevoja deri te Gjykata Kushtetuese, për legjitimitetin e atij vendimi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, kryetar!

Mendoj se kjo që dëgjuam deri më tani është abuzim serioz me foltoren e Kuvendit. Është e vërtetë se Kuvendi i Kosovës kujdeset për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Kosovën, mirëpo në Kosovë ka nivele të pushtetit. Edhe ngritja në mënyrë të këtillë, me emër e problemeve të cilat zgjidhen në nivelin lokal, në Kuvend të Kosovës, është abuzim serioz me foltoren e Kuvendit.

Ne nuk e kemi bërë një gjë të tillë deri më tani dhe nëse kjo bëhet praktikë, atëherë Kuvendi i Kosovës do të shndërrohet në një institucion, i cili merret me probleme lokale e nuk është për atë punë.

Çështja tjetër është se të gjitha ato për të cilat deputetja paraprake e akuzoi kryetarin e komunës së Gjakovës, i ka bërë vetë me partinë e vet në Gjakovë. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Ju e dini që kjo pikë e rendit të ditës është zgjedhje e vetë deputetëve. Fjalën e ka deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar,

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dola të flas për zhvillimet e fundit. E kemi harrur ndoshta t'i përmendim zgjedhjet në komunën e Ferizajt. Ne jemi zgjedhur këtu deputetë të gjithë dhe ka kaluar që një vit dhe edhe më tutje njolla, se këtu jemi me vota të vjedhura, se koalicioni qeveritar ka vjedhur vota, që ne e kemi keqpërdorur votën, nuk na u ka hequr prej trupit dhe prej fytyrave tona.

Mirëpo, çka ndodhi në komunën e Ferizajt? Çka ndodhi në komunën e Ferizajt, më së miri u tregua këto ditët e fundit që nuk e pash asnjë reagim prej forcave opozitare. Ka ndodhur një heshtje, sikur të kishte pasur mort. Nuk ka pasur mort, qytetarët e Ferizajt e treguan se e votuan koalicionin qeverisës. Pra, ju që flisni në emër të popullit më 16% të votave, unë nuk po them që ju s'keni të drejtë të flisni fare, mirëpo, më shumë se sa ju, kemi të drejtë ne të flasim në emër të popullit. I kemi fituar 40% të votave të qytetarëve. Mund të përdorni edhe ilaçe qetësuese, mund të përdorni çfarëdo ilaçesh, mirëpo humbjen e Ferizajt nuk do t'ua zvogëlojë asgjë. Falemnderit shumë!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Falemnderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Para disa ditësh në Butel të Shkupit u vranë pesë qytetarë maqedonas. Ky akt ndodhi pas vrasjes së dy shqiptarëve në Gostivar, nga ana e një polici maqedonas. Dikush po investon në Maqedoni për eskalim tensionesh dhe ne duhet ta shtrojmë pyetjen, kujt po i konvenon kjo gjë? Me siguri, që shqiptarëve jo.

Në fillim qëndrimi zyrtar i shtetit të Maqedonisë për vrasjen e pesë shtetasve maqedonë ishte që të mos i kontribuohet tensioneve etnike, nëpërmjet paragjykit, përkatësisë dhe motiveve të vrasësve. Por, ajo që nuk po paragjykohet me deklarata, po paragjykohet me një fushatë arrestimesh të egra të shqiptarëve nga ana e policisë. Vetëm para tri ditësh u arrestuan mbi 20 shqiptarë, prej tyre edhe një plakë 60- vjeçe, që jetonte e vetme në shtëpi.

Si mund të thuhet se nuk bën të paragjykohet prejardhja etnike e vrasësve e që të gjithë të arrestuarit të jenë shqiptarë, njëkohësisht?

Shpjegimi zyrtar i Ministrisë së Brendshme ishte ky: Kemi arrestuar shqiptarë radikal islamistë. Në këtë mënyrë, jo vetëm që po paragjykohet krimi, por këtij krimi po tentohet t'i jepet karakter fetar, terrorist. Përderisa terrorizmin e qartë të strukturave të Beogradit ndaj Selver Haradinajt dhe familjes së tij, po e vënë në dyshim, aktit kriminal të vrasjes së maqedonasve, që s'dihet kush i vrau, po i jepet në konotacione të radikalizmit islamik, i cili na qenka shqiptar.

Qëllimi është ky:

- Së pari të thuhet se të pesë qytetarët maqedonas u vranë nga shqiptarët,
- Së dyti, se këta shqiptarë janë terroristë islamik,
- Së treti, se të vetmit shqiptarë të pakënaqur janë radikalë islamistë.
- Së katërti, që kështu lufta kombëtare e shqiptarëve, atje kundër shtypjes, të kthehet në luftë fetare,
- Së pesti, që çdo kërkesë apo demonstratë e shqiptarëve për më shumë të drejta dhe kundër shtypjes, të kualifikohet si automatikisht terroriste dhe që pastaj lufta konkrete dhe e patolerueshme politike kundër shqiptarëve të kamuflohet nën luftën e përgjithshme globale kundër terrorizmit, të cilës i prijnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ky plan maqedonas, me sherr, duhet të demaskohet edhe nga politika jonë. Institucionet tona është mirë, që ashtu sikurse që e dënuan aktin e vrasjes së pesë maqedonasve, ta dënojnë edhe këtë fushatë persekutimesh të shqiptarëve.

Po ashtu, duhet të kundërshtohet përpjekja e dëmshme, për ta kthyer luftën e shqiptarëve për më shumë të drejta kombëtare, në komplete të shpikura terroriste, islamike si dhe të demaskohet përpjekja maqedonase, që shtypja ndaj shqiptarëve të paraqitet si luftë e konsensusit global kundër terrorizmit islamik. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po dua ta jap një sqarim në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës rreth dy neneve të Kodit Penal, të cilat janë përfolur aq shumë dhe me të cilat është bërë një propagandë shumë e madhe, sidomos nga zëvendëskryeministri Kuçi e të cilat lidhen me lirinë e shprehjes dhe burimet.

Po dua ta sqaroj edhe një herë, që në ditën e seancës, domethënë, në seancën e kaluar, përmes shefit të Grupit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka qartësuar shumë saktë qëndrimin e vet dhe ka votuar kundër këtyre dy neneve dhe mund të shihet në transkript.

Pas kësaj, me kërkesë të zëvendëskryeministrit Kuçi, deputetët e pozitës shumica prej tyre, kanë votuar “pro” këtyre dy neneve, prandaj, të jemi shumë të saktë se kush ka qenë “kundër” dhe kush ka qenë “pro” këtyre dy neneve dhe të përfundojë kjo lojë e fjalëve dhe kjo propagandë dhe demagogji, e cila po ndodhë prej seancës së fundit, duke tentuar që t’ia rolin, do të thotë përgjegjësinë deputetëve për dy nene, të cilat të cilat në fakt janë sponsorizuar nga vetë zoti Kuçi dhe për të cilat ka kërkuar që të votohen.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës edhe njëherë po e ripërtëritë qëndrimin e seancës së kaluar se ne kemi qenë “kundër”, jemi “kundër” dhe do të vazhdojmë të jemi “kundër” këtyre dy neneve, që cenojnë lirinë e shprehjes në Kosovë. Ju falemnderit!

KRYETARI: Vendimet në Kuvend merren me shumicë votash. Fjalën e ka deputeti, Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

E pamë Qeverinë e Kosovës prapë të zbrapset. Shumë herë e nganjëherë shumë ashpër deklaroi se nuk do ta lejojë në asnjë mënyrë Serbinë të mbajë zgjedhje në Republikën e Kosovës, vetëm e vetëm për t’i mirëpritur këto zgjedhje dhe për t’i lejuar ato gjatë kësaj jave që po e lëmë pas, më saktësisht, në mbledhjen e Kryesisë, dje dhe përmes një komunikate, pardje.

Askush më nuk mund ta marrë seriozisht këtë Qeveri. E kur nuk e marrin seriozisht Qeverinë, atëherë natyrisht që rrezikojnë të mos e marrin seriozisht as shtetin e as Republikën.

Pasi i pranoi dhe madje i mirëpriti këto zgjedhje të Serbisë në Kosovë, kjo Qeveri tentoi të shfaqësohet duke thënë se OSBE-ja do të organizojë zgjedhjet e jo Republika e Serbisë. Mirëpo, sipas deklaratave edhe të OSBE-së edhe të Qeverisë së Serbisë, OSBE-ja vetëm do t'i monitorojë dhe do të lehtësojë zgjedhjet e Serbisë në Kosovë, me një ekip prej 35 monitoruesish. OSBE-ja nuk organizon zgjedhje, për shkak se organizimi i zgjedhjeve është pjesë e sovranitetit shtetëror. OSBE-ja nuk është shtet, por është organizatë. Pranimi, lehtësimi dhe mirëpritja e këtyre zgjedhjeve të Serbisë, janë në kundërshtim me parimet dhe vlerat evropiane. Serbia nuk e njeh Kosovën si shtet dhe në Kushtetutën e saj, Serbia Kosovën e paraqet si pjesë të pandashme të saj.

Edhe këto zgjedhje Serbia i organizon në bazë të Kushtetutës së saj, ku qytetarët e Serbisë, në gjithë territorin e saj do të votojnë për president dhe për Parlamentin e ardhshëm të Serbisë. Pra, Qeveria e Kosovës po ia mundëson respektimin e Kushtetutës së vet në territorin e Kosovës.

Si edhe disa herë më parë, gjatë dialogut të Qeverisë Thaçi me Serbinë, kjo Qeveri po ia njeh Serbisë kushtetutën e saj dhe automatikisht po e mohon shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Mohimi i shtetësisë së vendit tënd për t'ia përshtatur atë aspiratës hegjemoniste të një vendi tjetër, nuk ka të bëjë asgjë me parimet dhe vlerat evropiane.

Nuk mund të shtiremi se marrëdhënia e Kosovës me Serbinë është marrëdhënie normale dhe se organizimi i zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, është një problem teknik i monitorimit të OSBE-së.

Vendimi për mbajtjen e zgjedhjeve në territorin e Kosovës, është vendim thellësisht politik dhe është shkelje e rëndë e integritetit territorial e institucional të Republikës së Kosovës.

Këtë e ka thënë edhe Qeveria e Kosovës, javëve të fundit edhe me veprimet e saj sporadike të konfiskimit të materialeve zgjedhore. Në qoftë se e gjitha paska qenë vetëm problem i monitorimit nga OSBE-ja, atëherë pse Policia e Kosovës paska konfiskuar material zgjedhor dhe paska arrestuar njerëz që kanë shpërndarë këtë material, kur dihet se në ndërkohë nuk ka ndryshuar as materiali zgjedhor, as ndonjë ligj apo rregullore për këto zgjedhje, as në Serbi e as në Republikën e Kosovës?

Lejimi dhe mirëpritja e këtyre zgjedhjeve është shkelje e Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, të nxjerrë më 15 mars të këtij viti. Do t'ua lexoj vetëm dy pikat e para të kësaj Rezolute, që ta kuptoni këtë. Njërin prej tyre, tashmë e problematizoi nënkryetari i Kuvendit deputeti Sabri Hamiti, pikën e dytë. Unë do t'ia kisha shtuar kësaj edhe pikën e parë, e cila po ashtu e ndalon rreptësisht mbajtjen e çfarëdo zgjedhje të Serbisë në territorin e Kosovës theksojmë se është shkelje e sovranitetit dhe cenim i marrëdhënieve të mira fqinjësore, që të organizojë në mënyrë të njëanshme zgjedhje të përgjithshme dhe lokale

Pyetja ime ka të bëjë me mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë. Pra, me çfarë baze ligjore dhe kushtetuese është bazuar kur ka mirëpritur dhe përshëndetur vendimin e OSBE-së dhe qeverisë së Serbisë, për organizimin e zgjedhjeve të shtetit armik serb në Kosovë?

Unë them që arsyetimi përmes së drejtës së dyshtetësisë është një mashtrim tepër naiv që po iu bëhet qytetarëve të Kosovës dhe deklaratimet e tilla të kryeministrit dhe Qeverisë, në lidhje me këtë mund të kenë bazë vetëm në Kushtetutën e Serbisë, por jo edhe në atë të Kosovës, në emër të së cilës shpesh thirren dhe e shkelin me çdo veprim dhe vendim, që e marrin. Falemnderit.

KRYESUESI: Deputetja Lama, pyetje për ministren Vlora Çitaku. Deputete e keni fjalën!

ALMA LAMA: Falemnderit, kryesues!

Pyetja ime ka të bëjë me vizitën e kryeministrit të Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ka qenë prezente edhe zonja Çitaku, duke qenë se ajo është ministre për integritet dhe fokusi i saj është në lidhje me shtetet e Bashkimit Evropian. Pyetja ime është se cili është rezultati i vizitës në SHBA për sa i përket integriteteve evropiane të zonjës Çitaku? Falemnderit!

KRYESUESI: Ministria Çitaku e ka fjalën.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU

E nderuara deputete Lama,

Fillimisht dua t'ju falënderoj për pyetjen, sepse më jep mundësi të sqaroj një çështje, rreth së cilës ka pasur debat edhe më herët në Kuvendin e Kosovës.

Fillimisht dua t'ju njoftoj që kjo nuk është vizita ime e parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pas emërimit tim si ministre për Integritet Evropian, unë kam qëndruar në SHBA edhe në muajin dhjetor bashkë me presidenten e Republikës së Kosovës, zonjën Atifete Jahjaga dhe e kam shoqëruar atë në të gjitha takimet zyrtare atje. Po ashtu, kam qenë pjesë e delegacionit që ka shoqëruar kryeministrin gjatë qëndrimit dhe vizitës në SHBA.

E nderuara zonja Lama, dua t'ju njoftoj që vizitat e këtij niveli, përbërja e delegacionit dhe temat e diskutimit gjithmonë bëhen në pajtueshmëri me vendin nikoqir dhe bazuar në temat, të cilat do të diskutohen në takime, përcaktohet edhe përbërja e delegacionit.

Unë dua t'ju njoftoj që agjenda evropiane e Kosovës, përkatësisht procesi i integritetit evropian, ka qenë agjendë qendrore në të gjitha takimet e nivelit të lartë që kemi zhvilluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kjo është reflektuar edhe në deklaratat për shtyp të vet sekretares së shtetit, zonjës Hilari Klinton.

KRYESUESI: Falemnderit! Pyetje shtesë. Deputetes Lama fjalën, ju lutem!

ALMA LAMA: Falemnderit!

Unë e kam të qartë se ju keni qenë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prandaj edhe ua kam bërë pyetjen, por duke qenë se mandati juaj lidhet ekskluzivisht me agjendën evropiane,

domethënë, puna juaj lidhet me integrimin në Bashkimin Evropian. Natyrisht, që në SHBA mund të flitet për integrime, sepse nuk është fjalë e ndaluar, por po them, cili është rezultati i vizitës?

Kam parasysh që nuk janë të dëmshme udhëtime të tilla për personin, mirëpo janë të dëmshme për buxhetin e Kosovës. Me një llogaritje të thjeshtë, që mund të bëjmë, kostoja e vizitës suaj mund të ketë qenë 15.000 euro. Ju mund të na e thoni tani sa ka qenë, por besoj se e tillë ka qenë. Dhe a ja vlen pra, gjithë këto shpenzime të një buxheti shumë të varfër për të shkuar në një shtet, i cili nuk lidhet me mandatin tuaj qeveritar. Falemnderit!

KRYESUESI: Ministria.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: E nderuara zonja Lama, Unë sërish po e ripërsëris që edhe përbërja e delegacionit edhe pikat të cilat diskutohen janë reflektim i njëra tjetrës dhe gjithmonë bëhen në harmoni të plotë me vendin nikoqir, pritës. Po ashtu, po ju njoftoj që nuk ka qenë vizita ime e parë në këtë cilësi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe sigurisht nuk do të jetë vizita e fundit. Unë kam një vizitë në SHBA, të paraparë edhe në pjesën e dytë të këtij viti.

Arsyeja pse unë kam qëndruar atje është fakti i pakontestueshëm, që mbështetësi më i madh i Kosovës në procesin e integritimit evropian janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pa shtytjen dhe pa mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kosova në mars, përkatësisht, në fillim të këtij viti nuk do të mund të kishte marrë agjendën konkrete për integrimin evropian. Dhe, kjo është reflektuar edhe në deklaratat e vetë zonjës Hilari Klinton.

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Ramë Buja. Deputete, e keni fjalën.

TEUTA HAXHIU: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Sipas Udhëzimit administrativ numër 13/2011, të datës 30.12.2011, mësimdhënësit dhe edukatorët që kanë ushtruar veprimtarinë edukative dhe arsimore më shumë se tri vjet, obligohen që të vazhdojnë avancimin profesional pa shkëputje nga puna.

Zoti ministër, pyetja ime është: Çfarë keni menduar për të gjithë kandidatët, që kanë të përfunduar shkollën e Lartë Pedagogjike?

KRYESUESI: Zoti Buja, ministër i Arsimit, e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryesues!

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Haxhiu,

Falemnderit shumë, për pyetjen e bërë, mbase ka nevojë të sqarohet edhe opinioni qytetar për këtë gjë, por konsideroj që pyetja bëhet pakëz më ndryshe, por megjithatë sqarimet janë tash në këtë që do të them.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës i përmbahet memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar në datën 31.1.2010 i cili memorandum ka për qëllim sigurimin e procesit të avancimit të kualifikimeve të mësimdhënësve me diploma dyvjeçare të shkollës së lartë pedagogjike, në diplomën bachelor i edukimit si ekuivalent me kualifikimet e ofruara me programet e rregullta të Fakultetit të Edukimit.

Programi Avancim i kualifikimit të mësimdhënësve ose AKM siç thuhet shkurt, ofrohet nga Universiteti i Prishtinës dhe ky proces ofron avancimin e kualifikimit të edukatorëve, mësimdhënësve të shkollave fillore dhe atyre të mesme të ulëta. Pra, vijues të këtij programi do të jenë edukatorët dhe mësimdhënësit në shërbim që kanë përfunduar shkollën e lartë pedagogjike. Programi i AKM-së është në shërbim të realizimit të parimeve dhe orientimeve të kornizës kombëtare të kualifikimeve, të kurrikulës më falni, dhe organizohet në katër qendrat e Fakultetit të Edukimit: Prishtinë, Prizren, Gjakovë dhe Gjilan. Përgjegjësitë e të dy palëve sipas memorandumit të mirëkuptimit janë, si vijon:

MASHT-i ka këto përgjegjësi. Sipas Ligjit të arsimit të lartë neni 12.4. MASHT-i miraton programin e AKM-së në ciklin e parë të studimeve bachelor të propozuar nga UP-ja dhe miratuar nga senati i UP-së.

E zbaton procesin e licencimit të mësimdhënësve, i mbulon shpenzimet për realizimin e programit, përzgjedh kandidatët për pjesëmarrjen në këtë program sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli Shtetëror për Licencim.

UP autorizohet nga MASHT-i të organizojë mësimdhënie teorike dhe praktike me qëllim të plotësimit të kompetencave të përgjithshme dhe specifike lëndore, ndërsa UP-ja ka përgjegjësi të sigurojë që mësimdhënësit e diplomuar në programin dy vjeçar në shkollat e larta pedagogjike t'u njihet kredia prej 120 ects duke i shtuar edhe 14 të tjera për praktikën mësimore drejt shkallës së bachelorit të edukimit. UP-ja mbështet dhe e njeh shkallën e bachelorit baras vlerësuar me programin e rregullt me Fakultetin e Edukimit diplomat për këto kualifikime që iu lëshon UP-ja.

UP shpall konkurs për zgjedhjen e mësimdhënësve - Instruktorëve që do të përfshihen në program.

UP është përgjegjës për rregullimin e procedurave, për pagesat e të angazhuarve në programin AKM.

Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës për vitin 2010 ka përfshirë në studime pa shkëputje nga puna 1300 mësimdhënës, ndërsa në vitin 2012 1700 sosh në dhjetë programe mësimore.

E nderuar, zonja Haxhiu,

Sa i përket pyetjes ju sqaroj se udhëzimi administrativ i datës 13.12.2011 është normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. Ndërsa, udhëzimet tjera i sqarojnë gjërat më në hollësi për këtë gjë. Ky udhëzim administrativ ka të bëjë me përcaktimin e normativit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: A ke pyetje shtesë, deputete Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Po! Zoti ministër, më konkretisht pyetja ishte shumë drejtpërdrejt, përgjigja pak sa e haptë. Kështu që të them më konkretisht.

Të gjithë kandidatët që kanë të përfunduar shkollën e lartë pedagogjike që për momentin nuk janë në marrëdhënie pune për mënyra të ndryshme, ndoshta dikuju ka zvogëluar numri i nxënësve dhe në pamundësi për të vazhduar studimin, nuk i mundësohet: një, të vazhdojë studimet. E dyta, nuk i mundësohet të paktën të aplikojë në një konkurs që hapet vetëm se e ka shkollën e lartë pedagogjike.

Pra, këta kandidatë nuk është me fajin e tyre pse e kanë kryer shkollën e lartë pedagogjike se atëherë kur ka përfunduar shkolla e lartë pedagogjike është dashur shumë më shumë punë se sa sot që kryhet edhe një master.

KRYESUESI: Zoti Buja e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Faleminderit, e nderuara deputete!

Është çështja e përparësisë që kanë ata mësimdhënës që janë në marrëdhënie puna, por nuk iu përjashtohet mundësia që edhe ata që nuk janë në marrëdhënie pune që duan ta vazhdojnë këtë gjë, por faktikisht aktualisht nuk ka mundësi të futen në këtë program njerëzit që janë jashtë marrëdhënies punës. Domethënë, aktualisht janë vetëm ata që janë në marrëdhënie pune për të tjerët, dëshirojmë programe tjera, më vonë. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Lutfi Haziri pyetje për zëvendëskryeministrin Slllobodan Petroviq.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar, kryesues i asamblesë!

Zoti zëvendëskryeministër, sa ndërhyrje ka pasur Ministria e Pushtetit Lokal në vendosjen e ligjit në të gjitha rastet në komunat e Kosovës për vitin 2011 dhe sa për këtë vit? Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër, Petroviq!

SLOBODAN PETROVIĆ: Poštovani predsjedavajući!

Uvaženi narodni poslanici,

Uvažene kolege ministri,

Poštovani narodni poslanice gospodine Haziri.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, u skladu sa obavezama i odgovornostima koje ima, tokom 2011.godine u periodu januar do marta meseca ove godine je kontrolisalo opštine u aspektu implementacije opštinskih nadležnosti u skladu sa zakonom.

Poštovani poslanici,

Poštovani poslanice Haziri,

Pprema zvaničnim podacima Ministarstva administracije lokalne samouprave u 2011. godini, opštine su usvojile ukupno 1.308 odluka i 126 uredbi, a u periodu od januara do marta meseca ove godine usvojene su 37 uredbi i 304 odluke.

Kao rezultat procene zakonitosti opštinskih akata, Ministarstvo administracije lokalne samouprave je tokom 2011.godine identifikovala 17 prekršaja zakonitosti a u periodu od januara do marta meseca do 2012.godine identifikovala 7 prekršaja zakonitosti.

Poštovani poslanice Haziri,

Za sve konstatovane prekršaje opštinama je prenet zahtev za razmatranje nezakonitih akata. Na osnovu zahteva Ministarstva administracije lokalne samouprave a za ponovo razmatranje akata i aktivnosti opština nekih od ovih uslova su uzete u obzir od strane opština međutim ima nekoliko opština koje još preispitaju svoje odluke kao što je deo zahteva Ministarstva pošto nije moga da implementiše sve ono što je Ministarstvo prepoznalo kao propust, pošto ministarstva imaju linearnu zakonodavnost drugih opština.

Dakle, uglavnom kršenja zakonitosti se odnose na sledeće oblasti: imenovanja na mesto zamenika gradonačelnika u opštinama, za zajednici predsedavajućeg skupština opština za zajednice u suprotnosti su sa odredbama člana 54. i člana 61. Zakona o lokalnoj samoupravi.

Dalje, osnivanje javnih preduzeća a u suprotnosti su sa članom 11. Zakona o javnim preduzećima, prenos društvene imovine u ime opštinske svojine odnosno vlasništvo, davanje opštinske imovine na korišćenje bez poštovanja zakonskih odredbi Zakona o korišćenju i razmeni nepokretnosti opština br. 03/L/26, povećanje uprava u opštinama bez prethodne izmene statuta opština...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë, ia mundësoni të flet!

SLOBODAN PETROVIĆ: Kršenje odredbi zakona o upotrebi jezika.

Dakle imajući u vidu o da Ministarstvo administracije lokalne samouprave nije odgovorno u nadgledanju svih opštinskih ovlašćenja, pošto su za jedan deo nadležna linijska ministarstva, bilo je razgovora da se osnuju pod ministarske komisije. Ove komisiji ili odbori su formirani sa ciljem pod ministarske koordinacije za realizaciju razmatranja zakonitosti opštinskih akata.

Želim da istaknem da, veliki deo ovih odbora sada su funkcionirali, čak i u praksi je primećeno da opštine uzimaju u obzir preporuke ili zahteve relevantnih komisija uključujući akte koje smatraju kao nezakonite. Nadam se da sam odgovorio na pitanje koje mi postavili.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shitesë, zoti Haziri?

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Por, njëra prej detyrave kryesore të ministrit është që të gjitha rastet ta detyrojë zbatimin e ligjit dhe në përputhje me ligjin duhet të zbatohet.

Unë si deputetë i kam evidentuar tri raste ku zëvendësministrat e Qeverisë së Kosovës janë kryesues të asamblesë komunale dhe është në kundërshtim me ligjin bazik për qeverisje lokale dhe me Konventën evropiane për qeverisje lokale, nga e cila ka dal edhe ligji.

Natyrisht, që kjo do të evidentohet në Raportin e Progresit në këtë vit, po do të doja që roli juaj me qenë në zbatim të ligjit, sepse aty ku nuk përfilllet ligji do të duhet me ndërhyrë në shkallën e parë ministri dhe në shkallën e dytë kryeministri.

Ju keni tre kryesues të asamblesë komunale që janë zëvendësministra, dhe përderisa këshilltari komunal nuk mundet me e ushtruar detyrën e drejtorit, ai duhet të zgjedh mes të zgjedhurit lokal dhe drejtorit në administratë. A do të ndërmerrni veprime konkrete që të vendoset ligji apo do të vazhdoni me e injoruar rastin dhe me i lënë njerëzit me ushtruar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Slllobodan? Zoti ministër e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Uvaženi narodni poslanice Haziri,

Ono što sam u izveštaju dao kao činjenice, odnosno podatke koje raspolaže Ministarstvo administracije lokalne samouprave, želim da vas još jednom podsetim na činjenicu da, nije samo Ministarstvo administracije lokalnu samoupravnu odgovorno za nadgledanje svih aktivnosti opština, znači postoje i linarna administarstva koje imaju svoje odgovornosti nad određenim aktivnostima naših opština. I s druge strane konkretne zahteve koje ste, ili teme koje ste pokrenuli, svakako da će biti registrovane. I ono što želim i ovom prilikom da istaknem je da je Ministarstvo administracije lokalne samoupravne upravo od Evropske unije kroz izveštaj o napretku Kosova dobilo najveću moguću ocenu, i sigurno za to ima velike zasluge ne samo ovo Ministarstvo nego i naše opštine.

Svakako da želim da iskoristim ovu priliku da uputim i vama jednu veliku zahvalnost kao i poslanicima, kao najvišem domu, i pogotovu gospodine Haziri jer ste vi u prethodnom periodu i bili prvi ministar u ovom Ministarstvo svakako dali ste dobar doprinos za ovo ministarstvo i gotovo sam siguran da ćemo eventualne one zamerke koje imate za rad određenih službenika i u Ministarstvo i u lokalnoj samoupravu na vreme da se sankcionišu. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Haziri pyetje për ministrin Gashi. Ministri s'është këtu. A dëshiron ta bësh pyetjen apo po e len për më vonë? OK! Po e len, atëherë kur të vjen Dardani.

Deputetja Lama pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Turqia në mënyrë të vazhdueshme e ka ngritur çështjen e kthimit të disa shtetasve turq. Në fakt kjo po ndodh prej disa vitesh, të cilët nuk lejohen të futen në territorin e Kosovës, përkatësisht në aeroport ndalohen dhe duke pasur parasysh që Turqia është një nga dy vendet që ia mundëson Kosovës lëvizjen pa viza, dua ta pyes ministrin: se si shpjegohet fakti që në aeroport me këta shtetas autoritetet e aeroportit sillen në mënyrë të tillë?

E marr me mend që ju do të thoni që kjo bëhet për të parandaluar kontrabandën e shtetasve të ndryshëm që kanë destinacion final Evropën. Mirëpo fakti që nga autoritetet turke ngrihet në mënyrë të vazhdueshme kjo çështje, ku i kam dëgjuar edhe vetë personalisht në një vizitë të kryetarit tani, dua të di se si shpjegohet? Ose ju nuk po i sqaroni autoritetet turke ose po veproni në kundërshtim me ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Sidoqoftë, unë mendoj s'është dashur me u bërë kjo pyetje fare se është çështje e administratës dhe e policisë, por ministër, zoti Rexhepi, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

E nderuara deputete Lama,

Republika e Kosovës e ka lidhur marrëveshjen me Republikën e Turqisë mbi heqjen e ndërsjellët të vizave, marrëveshje që është nënshkruar në janar të vitit 2009. Mirëpo, neni 2 paragrafi 2 i kësaj marrëveshje i obligon shtetasit e të dy vendeve që gjatë kalimit të kufirit shtetëror të veprojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi të palëve kontraktuese.

Kjo nënkupton se pavarësisht marrëveshjes, shtetasit obligohen t'i respektojnë dispozitat e brendshme ligjore për kalimin e kufirit. Mbi këtë bazë autoritet policore kufitare të të dy shteteve mund të iu ndalojnë hyrjen në vendet e tyre atyre të cilët nuk i përmbushin kushtet për hyrje në vend. Në rastin tonë, ne i referohemi dispozitave të Ligjit për të huajt dhe atij për menaxhimin dhe kontrollin e kufijve shtetëror.

Po ashtu, paragrafi 1, neni 7 të kësaj marrëveshje i jep të drejtë secilës palë kontraktuese të ndalojë hyrjen në territorin e saj të shtetasve të palëve kontraktuese pa dhënë ndonjë arsye. Pra, edhe përkundër marrëveshjes për heqjen e ndërsjellët të vizave palët kontraktuese e rezervojnë të drejtën e ndalimit të hyrjes së shtetasve në mënyrë reciproke, madje në disa raste pa dhënë ndonjë arsye.

Shtetasit e Republikës së Turqisë, me rastin e hyrjes, të qëndrimit dhe lëvizjen në territorin e Republikës së Kosovës trajtohen në mënyrë të njëjtë si shtetasit e të gjitha shteteve tjera, të cilët hyjnë, qëndrojnë dhe lëvizin në territorin e Republikës së Kosovës.

Më lejoni t'ju informoj se në periudhën kohore janar-prill 2012 në territorin e Republikës së Kosovës kanë hyrë mbi 10.000 shtetas të Republikës së Turqisë, ndërsa iu është refuzuar hyrja në territorin e Republikës së Kosovës 51 shtetasve të Republikës së Turqisë. Arsyeja

më e shpeshtë e refuzimit të hyrjes është qëllimi i hyrjes, përkatësisht deklarimi me rastin e hyrjes.

Shumica prej tyre deklarojnë se vijnë për të punuar dhe nuk kanë të rregulluar lejen e punës. Pas sqarimit të obligimeve ligjore, ata kthehen, e rregullojnë lejen e punës dhe pastaj hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës.

Disa janë kthyer edhe për arsye të mundësisë të migrimit potencial. Po i zbërthej, sipas arsyes së refuzimit të hyrjes:

1. Refuzimi i hyrjes për mungesë të dëshmive, që tregojnë qëllimin e qëndrimit, mungesë garancioni për punësim apo leje pune, janë gjithsej 46 persona,
2. Refuzimi i hyrjes për dyshim të migrimit ilegal por shfrytëzimit të territorit të Republikës së Kosovës si transit për vendet e Evropës Perëndimore, janë gjithsej 5.

Ndërsa, sa i përket vendosjes së regjimit të vizave Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur dokumente strategjike lidhur me implementimin e regjimit të vizave duke i ndjekur praktikat më të avancuara ndërkombëtare.

Po ashtu Ministria e Punëve të Brendshme e ka iniciuar nënshkrimin e marrëveshjes për ripranim në Republikën e Turqisë, e cila do t'i formalizojë procedurat lidhur me ripranimin e shtetasve të dy vendeve të cilët qëndrojnë pa autorizim në territorin e palës së njëra-tjetrës.

Dhe, në fund shumica e udhëtarëve nga vendet e treta udhëtojnë nëpërmjet Turkish Airlines të cilët nuk i kanë respektuar të gjitha rregullat se janë të obliguar ta çojnë listën paraprakisht dhe ndodh që migruesit potencial ilegal të cilët gjenden në aeroplan, gjatë kontrollimit, na i detyrojmë të kthehen me të njëjtin aeroplan dhe këto bien në kosto të kompanisë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Deputetja Lama, pyetje shtesë.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Zoti kryesues, së pari dua të sqaroj që kjo është një çështja e cila ngrihet në nivel politik, prandaj edhe i shtrohet ministrit.

Dhe pyetja ime, duke iu falënderuar ministrit për detajet e hollësishme që dha në lidhje me këtë çështje, është se përse pra duke i pasur parasysh gjithë këto argumente, përse nuk janë sqaruar autoritetet turke në lidhje me këto fakte? Sepse, ata në çdo takim të çfarëdo lloji niveli e ngrenë këto si çështje si problem e madje kanë paralajmëruar edhe vendosjen e reciprocitetit.

Në rast se bëhet fjalë për shtetas turq me pasaportë turke, nuk besoj se mund të trajtohen njëjtë si me shtetasit e vendeve të tjera, të cilët vijnë nëpërmjet Turqisë. Ata, nuk janë shtetas turq, apo jo?

Domethënë, këtu ka nevojë për një sqarim të nivelit politik dhe të ministrive përkatëse, sepse kjo çështje vazhdon të ngelet brengosëse në raportet mes dy vendeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Rexhepi, sqarim shtesë!

BAJRAM REXHEPI: Ne disa herë kemi pas kontakte edhe me ambasadorin e Turqisë, kanë qenë delegacionet dhe i kemi sqaruar shumicën e çështjeve. Edhe një herë po them: ata shtetas të cilët vijnë dhe destinimi i tyre është se pretendon me punuar pa leje të punës, natyrisht që nuk mund të hyjnë.

Këto janë norma dhe rregulla, për çka është nënshkruar Marrëveshja në kohën sa ka qenë ministër i Punëve të Jashtme Skënder Hyseni dhe Ali Babaxhan dhe i përmbahemi legjislacionit.

Mund të them se kompania e cila ka karakter komercial i zvogëlohet pak fluksi ose të hyrat dhe kanë lidhje të fuqishme të politikanët dhe nganjëherë nuk i informojnë drejtë.

Prandaj, ne i kemi bërë ato informacione, por natyrisht se ata politikanë nuk mund t'i dinë detajet të gjitha, dhe na nuk mundemi secilit, qoftë Parlamentit diku tjetër, me ia shpjeguar. Ne adresë e kemi ambasadën, dhe nëpërmjet ambasadës këto sqarime bëhen.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Breca i ka dy pyetje për ministrin Agani.

Unë mendoj që duhet t'i lexojë të dyja pyetjet, e përgjigjet edhe ministri t'i jap njëherazi. Kuptohet duke e shtuar kohën e përgjigjeve. Faleminderit!

NAZANE BRECA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër Agani,

Mjekët nga mbarë Kosova marrin specializime të ndryshme në bazë të një planifikimi regjional dhe planifikimi paraprak që bëhet në Ministri të Shëndetësisë.

Me këtë rast ata nënshkruajnë një marrëveshje, apo një kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë që pas përfundimit të specializimit të kthehen në vendet e tyre.

- Pse nuk po implementohet kontrata, që e nënshkruajnë mjekët me Ministrinë e Shëndetësisë dhe pse kjo nuk po monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë? Çka keni ndërmarrë ju si ministër, në lidhje me këtë çështje?

Dhe pyetja e dytë, është:

- Në bazë të procesit të decentralizimit, sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe kompetencat për kujdesin parësor shëndetësor i takojnë nivelit komunal gjegjësisht drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, kështu që edhe procesi i zgjedhjes së kandidatëve për

specializim nga mjekësia familjare, duhet të bëhet nga niveli komunal, në bazë të kriterëve të cilat paraprakisht përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

- Pse përzgjedhja e kandidatëve për specializim nga mjekësia familjare ende bëhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe a keni ndërmarrë në lidhje me këtë diçka, e nuk bëhet, për shembull, nga niveli komunal. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar kryesues,

Unë e kam pasur një pyetje, të paralajmëruar, e këtu u paraqitën dy, por nuk prish punë. Janë të lidhura, është temë e përafërt.

Sa i përket pyetjes së parë, unë nuk kam informatë zyrtare se ndonjë prej kontratave të nënshkruara me specialistët e Ministrisë së Shëndetësisë, nuk është duke u zbatuar pas përfundimit të shkollimit të tyre specialistik. Në qoftë se i keni, do të ishte mirë t'i paraqitni, por unë nuk kam informatë zyrtare ose ankesë se diçka e tillë është duke ndodhur.

Sa i përket pyetjes së dytë. Zhvillimi i resurseve njerëzore në lëmin e shëndetësisë është në kompetencën ekskluzive të Ministrisë së Shëndetësisë në bazë të Ligjit të shëndetësisë.

Në bazë të Ligjit të shëndetësisë është nxjerrë Udhëzimi administrativ 2008/11, i cili, si organ përgjegjës për shkollimin specialistik, e përcakton bordin për shkollimin specialistik, i cili e m mbikëqyrë tërë procesin prej pranimi e deri në përfundim të shkollimit specialistik.

Neni 11, pika 2.2 e këtij udhëzimi, e lejon mundësinë që financimi i shkollimit specialistik të bëhet edhe nga buxhetet e komunave të caktuara.

Ndërsa, neni 24 i këtij udhëzimi obligon që atëherë kur kemi të bëjmë me financim nga buxheti qendror ose nga buxheti i komunave, pranimi të bëhet në bazë të konkursit publik.

Me nenin 18, pika 1 të Ligjit të shëndetësisë në fuqi 2004/4, thuhet se “komunat sigurojnë zbatimin e kujdesit parësor shëndetësor”. Pra, komunat e sigurojnë zbatimin e kujdesit parësor shëndetësor, ndërsa mbikëqyrja ose më mirë me thënë planifikimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të shkollimit specialistik është në kompetencën ekskluzive të Ministrisë së Shëndetësisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, deputetja Breca?

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuari ministër,

Unë, si anëtare e Komisionit, gjatë vizitave që i kemi bë nëpër spitale regjionale, atje ka pas ankesa në deficit të kuadrit dhe ankesa se ata që marrin specializimin nga ato regjione domethënë e marrin prej regjionit përkatës specializimin përkatës dhe mbasi që e kryejnë specializimin më nuk kthehen në vendet e tyre të punës, por gjejnë punë diku tjetër. Dhe, ajo është e drejtë e mjekut, do të thotë, që ta zgjedh vendin se ku do të vazhdojë të punojë, mirëpo paraprakisht mjekët janë të obliguar ta kthejnë një borxh që e kanë ndaj atij regjioni nga i cili regjion edhe e marrin specializimin.

Dhe, duke u bazuar në këto ankesa, unë mund t'ju jap informata, edhe pse saktësisht në këtë moment nuk mundem, por do t'ua jap informatat se për cilat spitale regjionale bëhet fjalë dhe për çfarë lloj specializimi kemi të bëjmë.

Unë mendoj se kjo çështje duhet të monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe të ndalet, e të mos ballafaqohemi me deficit të kuadrit shumë të nevojshëm nëpër regjione të ndryshme.

Ndërsa, sa i përket çështjes së dytë – të mjekësisë familjare, unë mendoj se pasi t'u kalojnë kompetencat komunave dhe pasi që këta specializantë i marrin pagat nga niveli komunal, atëherë duhet që përzgjedhja të shkojë nga niveli komunal. Bile, bile, këtu një rol shumë të rëndësishëm duhet ta luaj qendra për zhvillimin e mjekësisë familjare që asnjëherë nuk është marrë parasysh se është një lidhje direkte e Ministrisë së Shëndetësisë me nivelin parësor shëndetësor, asnjëherë nuk është marrë parasysh gjatë procesit të specializimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për specializim nga mjekësia familjare, por është tejkaluar.

Ne e dimë se çfarë roli ka pasur qendra për zhvillimin e mjekësisë familjare prej vitit 2000 e deri më sot në implementimin e konceptit të mjekësisë familjare dhe në përf forcimin e kujdesit parësor shëndetësor si gurrthemel i sistemit shëndetësor.

Në vitin 2010, këto kompetenca....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuar zonja deputete,

Fillimisht, specializimet në Republikën e Kosovës nuk ndahen në bazë të regjioneve, por ndahen në bazë të planeve të cilat miratohen nga Bordi qendror për shkollimin specialistik i cili i përpilon këto plane në bazë të propozimeve të komiteteve specialistike për çdo lëmi të veçantë.

Prandaj, edhe kandidatët kanë obligim ndaj Ministrisë së Shëndetësisë. Nuk kanë obligim ndaj regjioneve, në momentin kur e përfundojnë specializimin, sepse sikur regjionet ta kishin marrë edhe obligimin e financimit të tyre, atëherë do ta kishim këtë situatë.

Ne jemi kah e ndryshojmë këtë sistem. Siç e patë, edhe në Udhëzimin administrativ e kemi lejuar mundësinë e financimit edhe nga ana e buxheteve komunale, kështu që në të ardhmen

do ta kemi këtë situatë që ata të kenë obligim të drejtpërdrejtë ndaj komunave që e bëjnë financimin e tyre.

Sa i përket çështjes së dytë, ju e dini mirë se Qendra për zhvillimin e mjekësisë familjare është institucion i Ministrisë së Shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë e ka themeluar, Ministria e Shëndetësisë e financon. Është një organ tejet i rëndësishëm dhe ne krenohemi me programin e specializimit në mjekësinë familjare që kjo qendër është kah e mbikëqyrë.

Ju e dini se ne, deri më tani i kemi 551 specialistë të mjekësisë familjare të përfunduar. Aktualisht janë në program të specializimit edhe 83. Ky program i specializimit është i vetmi që është i akredituar në nivel ndërkombëtar nga Kolegji Mbretëror i Britanisë së Madhe – i mjekëve të Britanisë së Madhe dhe unë mendoj se në këtë aspekt, sa i përket përcjelljes së kualifikimeve, përcjelljes së shkollimit specialistik, e kemi mbërri një standard mjaft të mirë. Ministria e Shëndetësisë është duke e mbështetur qendrën e zhvillimit të mjekësisë familjare në vazhdimësi, e kjo do të ndodhë edhe në të ardhmen, dhe në këtë aspekt nuk shoh ndonjë problem të veçantë dhe mendoj se programi specialistik në lëmin e mjekësisë familjare do të vazhdojë të zhvillohet me sukses, ashtu siç është zhvilluar edhe deri më tash.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputeti Burim Ramadani, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Para disa ditësh, zoti ministër, e keni njoftuar opinionin publik se keni kërkuar nga Republika e Turqisë që të trajnojë njësitin e pilotëve në Policinë e Kosovës.

Duke e ditur faktin se funksionalizimi i këtij njësi është vërtet tejet i rëndësishëm edhe për zhvillimin e policisë por edhe të shtetit të Kosovës, në përgjithësi, njëkohësisht duhet ta shohim me vëmendje se po ashtu është e domosdoshme që standardet evropiane të plotësohen edhe në ndërtimin e zhvillimin edhe të këtij njësi, pos në përgjithësi të organizimit të Policisë.

Pyetja ime është:

-Të cilave shteteve të Bashkimit Evropian, ia keni bërë paraprakisht këtë kërkesë që të trajnojë njësitin e pilotëve të Policisë së Kosovës, nëse keni bërë kërkesa të tilla dhe çka po e shtynë Qeverinë e Kosovës – Ministrinë tuaj në këtë rast, që të mbështetet kaq shumë në trajnimet profesionale nga ana e Turqisë?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Ramadani,

Më lejoni të ju informoj se përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të pajisur Policinë e Kosovës me mjete të specializuara, përfshirë edhe

helikopterët, për shkak të kufizimeve buxhetore kjo është e pamundur për tu realizuar brenda vitit 2012.

Sidoqoftë, ne po vazhdojmë me zhvillimin e legjislacionit përkatës dhe ngritjen e kapaciteteve për funksionalizmin e Njesisë së helikopterëve në kuadër të Policisë së Kosovës. Pra, janë themeluar – Njësi i pilotëve dhe i Mirëmbajtjes.

Në këtë drejtim, kemi biseduar me shumë vende mike, të cilat vazhdojnë të përkrahin konsolidimin në ngritjen e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe konkretisht – kemi biseduar me disa vende të BE-së, si me Austrinë, Francën, Italinë, Slloveninë e tjera, si dhe me Turqinë.

Ministria e Punëve të Brendshme ende nuk ka vendosur për formën e pajisjes me helikopterë. Pra, ende nuk kemi vendosur se a do të merren me lizing apo do të blihen. Dhe kjo mbetet të përcaktohet në të ardhmen e afërt në koordinim me Qeverinë dhe partnerët ndërkombëtarë dhe mundësitë buxhetore. Por në çfarëdo varianti, ne do të kërkojmë nga vendi kontraktues, që paralelisht me këtë, të bëjë edhe trajnimin e kuadrit tonë.

Sa i përket bashkëpunimit me Turqinë në fushën e ngritjes së kapaciteteve të agjencioneve të zbatimit të ligjit, më lejoni të ju informoj se Policia Turke, e cila vlerësohet si një ndër forcat policore më të përgatitura në Evropë, ka trajnuar deri më tani 1.755 zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës dhe aktualisht kemi 11 studentë të cilët vijojnë studime në fushën e sigurisë në Ankara – si përfitues të bursave të plota të ofruara nga shteti turk.

Gjatë vizitës së ministrit të Punëve të Brendshme, ne e ripërsëritëm një kërkesë dhe trajnimin e pilotëve të ri ata do ta bëjnë falas.

Sa për informim, kërkesa nga Austria për trajnimin e pilotëve të cilët do të jenë të licencuar edhe për pilotim civil sipas standardeve evropiane, zgjatë 2 vjet dhe na kushton për një pilot rreth 2 milionë. Ndërsa, Turqia këtë e bën pa pagesë.

Dhe, natyrisht se janë dy lloj licencash, ato që përdoren brenda prej institucioneve shtetërore dhe licenca që ka karakter edhe civil.

Ne i kemi dy kategori të pilotëve. I kemi disa të cilët kanë qenë të licencuar, janë edhe instruktorë dhe duhet ta kenë një trajnim shtesë, dhe kategoria tjetër – duhet prej tash t'i përgatisim disa pilotë të ri, për arsye se ambiciet tona janë që edhe Policia e Kosovës të pajiset me Njësinë e helikopterëve....

(Ndërprerje e regjisë)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ramadani?

BURIM RAMADANI: Faleminderit, ministër!

Nuk ka diskutim, dhe s'besoj që njerëzit që i njohin këto fusha nuk kanë dilema në fuqinë e forcave të armatosura, edhe të ushtrisë edhe të policisë turke, por e vërteta është se standardet

demokratike nuk janë ato për të cilat Kosova ka nevojë që t'i ndërtojë agjencitë e veta të zbatimit të ligjit, dhe si të tilla ne duhet t'i plotësojmë standardet e Bashkimit Evropian dhe jo standardet të cilat, vërtet, kanë në shumë elemente edhe dallueshmëri tepër të madhe me Bashkimin Evropian.

Ajo që po thoni – janë falas, besoj se nuk vlen, për shkak se falas mund të gjenden edhe trajnime tjera edhe prej vendeve tjera, për të cilat interesi strategjik i Kosovës është në pyetje. Unë besoj se ka shumë, shumë argumente me të cilat ju mund të negocioni me shtetet e Bashkimit Evropian dhe ju nuk e përmendët fare Gjermaninë, për të cilën, besoj se ka hapësirë që të negociohet dhe diskutohet kjo fushë. Dhe, në fakt, unë po them...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër?

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Mund të them se përkundër që i kemi miq edhe përkrahja e çështjes së helikopterëve, ka hezitime prej shumë shteteve të Unionit Evropian se mendojnë që tepër ta forcojmë policinë. Pra, ka aso paragjykime. Ne jemi shumë të interesuar që edhe Gjermaninë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të jemi në harmoni me koordinim se çfarë tipi dhe çfarë forme të bëjmë dhe nëse ata e shprehin gatishmërinë pa implikime buxhetore, ne me kënaqësi do t'i dërgojmë në ato shtete.

Edhe një herë po them, legjislacioni është konform aquicomunitaire dhe mënyra e të gjitha tjerat. Trajnimi i pilotëve si çështje teknike, është diçka tjetër. Prandaj, ne jemi në kontakt, por konkretisht kemi biseduar me dy-tri shtete dhe ato nuk kanë shprehur gatishmërinë që t'i bëjnë falas.

(Ndërhyrje...)

Po, nuk është alternativë. Kjo është vetëm çështje teknike dhe të tregova se janë dy lloje të licencave të pilotëve. Ne, për momentin nuk kemi nevojë për civilë ndërkombëtarë por kemi nevojë për struktura të shtetit, në këtë moment.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Mendoj se u ekzagjerua edhe kjo si pikë e rendit të ditës.

Tani kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, që është:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 18, 19 dhe 20 prill 2012.

Të nderuar kolegë, pyes nëse keni vërejtje, në këto procesverbale? Nuk keni!

Atëherë konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 18, 19 dhe 20 prill 2012.

Tani do të bëjmë pauzë prej 10 minutash!

(Vijoi pauza)

(Pas pauze, mbledhja vazhdoi punën)

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj se koha e pauzës ka kaluar për më shumë se 5 minuta. Tash vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, që është: - **Debat parlamentar lidhur me çështjen e personave të zhdukur.**

Por, para se të hyjmë në temë, në emër të ministrit Mujota – ju kërkoj falje që ka pas ta ngrisë një çështje, e unë e kam lënë pa ia dhënë fjalën, lidhur me Projektligjin për themelimin e Agjencisë së shërbimit të navigacionit ajror dhe ky e ka një arsyetim. Dhe unë e sugjeroj, që ai ta paraqes atë propozim apo kërkesë para se të hyjmë pikën e radhës, dhe pastaj kur do të ketë kuorum për votim, do ta votojmë. Zoti Mujota, e keni fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Në emër të Qeverisë kërkoj që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror të shtyhet për seancë tjetër dhe dua të ju informoj paraprakisht se zhvillimet që po ndodhin rreth lirimit të hapësirës së lartë ajrore të Kosovës janë në fazën më dinamike të saj.

Brenda muajit maj, presim që Këshilli i NATO-s të marrë një vendim për lirimin e hapësirës së lartë ajrore dhe sigurisht se do ta marrë në menaxhim një vend anëtar i NATO-s dhe anëtar i BE-së dhe mbi bazën e këtyre zhvillimeve, të presim deri në seancën tjetër, se a do të ketë ndonjë mundësi të interferimit të amendamenteve të Ligjit të cilat Komisioni parlamentar tashmë i ka sjell, dhe unë e çmoj shumë punën e kryer deri më tash.

Prandaj, kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës, të shtyhet për seancë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka ende kuorum të mjaftueshëm, por besoj se edhe nuk ka ndokush kundër kësaj kërkesë të paraqitur.

Ju njoftoj se me marrëveshjen paraprake, është vendosur që pauza të jetë në ora 12,30 dhe të përfundojë në ora 14,00.

Tani, siç u theksua edhe më parë, po vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, që është:

4. Debat parlamentar lidhur me çështjen e personave të zhdukur.

Komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione e ka shqyrtuar kërkesën e Komisionit qeveritar për persona të zhdukur dhe të Këshillit koordinues të asociacioneve familjare të të zhdukurve të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin, me përmbajtjen e debatit parlamentar.

Ftoj kryetaren e Komisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione, deputeten Suzan Novobërdaliu për arsyetimin e Raportit, me rekomandime.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Të nderuara familje të personave të pagjetur!

I nderuari nënkryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Deri sa të mos gjendet personi i fundit i zhdukur gjatë luftës në Kosovë, kërkimi për ta dhe ankthi i familjeve dhe gjithë qytetarëve të Kosovës, do të vazhdojë. Dhe, përkundër orvatjeve të deritashme të faktorëve vendorë e ndërkombëtarë për zbardhjen e fatit të zhdukurve, nuk janë realizuar të priturat.

Zhdukja e njerëzve është një prej krimeve më të rënda kundër njerëzimit, prandaj gjetja e personave të zhdukur, zbulimi i kryerësve dhe shqiptimi i dënimeve ndaj tyre është prioritet i shtetit dhe bashkësisë ndërkombëtare, me të cilat do të realizoheshin dispozitat e të drejtës ndërkombëtare dhe asaj humanitare.

Autoritetet e Serbisë, jo vetëm që nuk kanë treguar interesim për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, por të njëjtit këtë gjendje e shfrytëzojnë për interesa dhe përfitime politike.

Edhe pse kanë kaluar 13 vjet prej krimeve masive nga forcat serbe në Kosovë, edhe pse janë të evidentuar me emër e mbiemër, edhe pse dihen rrethanat e vrasjeve të 13.300 personave në Kosovë, gjyqësori në Kosovë deri më tash ka proceduar dhe me aktgjykim të formës së prerë ka mbyllur vetëm 10 raste.

Gjendja e familjarëve të cilët tash e 13 vjet jetojnë në ankth, është më e rëndë se e çdo qytetari tjetër të prekur nga lufta. Këta familjarë të cilët presin 13 vjet për një informatë për të ditur se ku janë më të dashurit e tyre, që është e drejtë elementare njerëzore, është padrejtësi më e madhe që iu bëhet.

Ka dyshime se një numër i madh i pengjeve janë djegur edhe nëpër furnalta, çka jep të kuptosh se enigma e fatit të disa të pagjeturve nuk do të zbardhet kurrë.

Kosova, nëpërmes faktorit ndërkombëtar duhet të bëjë tryzni ndaj Serbisë, si fajtores për shkakun dhe pasojat e kësaj gjendjeje.

Ajo është fajtores për luftën, për krimet e bëra në Kosovë dhe fshehjen e krimeve dhe personave ende të pagjetur dhe për këtë duhet të përgjigjet sipas të drejtës ndërkombëtare.

Kolegë deputetë,

Nuk ka krim më të madh sot në botë se sa mos deklarimi se ku janë të varrosur personat e kapur gjatë luftës. Kjo gjendje është vazhdim i ankthit për familjet e personave të zhdukur dhe për gjithë shoqërinë kosovare.

Historia na tregon se nuk ka raste të tilla në botë që pas përfundimit të luftës të mos shkëmbehen pengjet dhe informacionet e nevojshme për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur.

Të pagjeturit janë plagë e hapur për gjithë Kosovën. Më 27 prill në Ditën kombëtare të personave të zhdukur, u vu gurthemeli i Memorialit i cili iu kushtohet personave të zhdukur, një iniciativë me vend, por krahas memorialit duhet të ngrihet edhe një muze i veçantë për të zhdukurit - për të treguar për krimin, por edhe për secilin person të zhdukur në një histori të hidhur dhe të papërfunduar.

Kolegë deputetë,

Komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione ia paraqet Kuvendit të Kosovës dhe iu bën thirrje për miratim, të këtyre rekomandimeve:

1. Respektimi dhe zbatimi i plotë i dokumenteve zyrtare të Kuvendit të Kosovës, që trajton çështjen e personave të zhdukur, të miratuara nga Kuvendi, Ligjit për personat e zhdukur dhe ligjeve tjera që e trajtojnë këtë çështje.
2. Intensifikimi dhe mbështetja e punës për Departamentin e mjekësisë ligjore në identifikimin e mbetjeve mortore dhe punës në terren.
3. Angazhim më i madh i institucioneve të Republikës së Kosovës në senzibilizmin ndërkombëtar të çështjes së personave të zhdukur gjatë luftës.
4. Të jetë në fokus kërkesa nga bashkësia ndërkombëtare për të bërë tryzni tek autoritetet zyrtare në Beograd për të ofruar informacion mbi fatin dhe vendndodhjen e personave të evidentuar si të zhdukur.
5. Hartimi i një strategjie shtetërore me plan konkret dhe afatgjatë kohor drejt ndriçimit të fatit të personave të zhdukur.

Rekomandimet tona janë këto, por jemi të hapur sa i përket propozimeve tjera, nëse i keni ju – nga grupet parlamentare. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Qeverisë, nuk e ka kërkuar askush fjalën! Fjalën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zonja Blerta Deliu.

BLERTA DELIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kuvendi i Republikës së Kosovës sot po diskuton njërën prej çështjeve më problematike në Kosovën e pasluftës – çështjen e të pagjeturve, çështje e cila ka 13 vite që nga përfundimi i luftës vazhdon t'i mbajë në ankth familjarët e të pagjeturve.

Këta familjarë, në shekullin XXI po vazhdojnë të presin me vite të tëra vetëm për një informatë, e cila është e drejtë elementare njerëzore dhe padrejtësia më e madhe që po iu bëhet këtyre familjarëve.

Zhdukja e njerëzve përbën njërin prej krimeve më të rënda kundër njerëzimit, e kur kësaj i shtojmë dhe mendimin e Gjykatës ndërkombëtare për krimet në ish Jugosllavi, dihet mirëfilli se kjo Gjykatë nuk ka dhënë drejtësi për krimet e kryera në Kosovë, pasi që gjykatat janë përballur me një numër simbolik me ata që urdhëruan kryerjen e krimeve dhe disa që kryen disa krime në terren, por jo edhe me të tjerët.

E përgjegjës nuk janë vetëm ata që i kryen krimet, por edhe ata që i planifikuan, ndihmuan dhe i fshehën ato krime.

Si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, vlerësojmë se procesi për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur në luftën e fundit në Kosovë nuk është në dinamikën çfarë do të duhej të ishte. Megjithëse institucionet i kanë intensifikuar punët lidhur me këtë çështje, numri prej 1.781 personave të evidentuar si të zhdukur dhe rreth 350 mbetje mortore të paidentifikuara, vazhdon të mbetet shqetësim për Qeverinë e Republikës së Kosovës, për partnerët vendorë e ndërkombëtarë, e në veçanti për familjarët e personave të zhdukur.

Komisioni qeveritar për persona të zhdukur po vazhdon të punojë në zbardhjen e fatit të personave që tash e sa vjet iu mungojnë familjeve të tyre. Krahas punës, mbetet angazhimi i përhershëm kërkesa për faktorin ndërkombëtar që të shtrojë presionin ndaj institucioneve të Beogradit për të qenë bashkëpunues dhe për të mundësuar zbardhjen e fatit të pagjeturve.

E cili nga ne deputetët nuk i kemi të freskëta kujtimet e masakrës së Reçakut, të Likoshanit, të Çirezit, të Prekazit, të Izbicës, të Abrisë, masakrën e Rezallës, të Pokleikut, të Suharekës, të Mejës, Rugovës, masakrën e Celinës, të Krushës së Madhe e të Vogël, Lubeniqit, të Makovcit, Fushë-Kosovës, Gjakovës, Çyshkut, masakrën e Studimes së Vushtrrisë që u përkujtua dje, masakrën e Çabrës e atë të Burgut të Dubravës. Kujtimet vazhdojnë të jenë edhe më të trishta kur shumë nga të vrarët ende mungojnë.

Të nderuar deputetë,

Dita ndërkombëtare e të zhdukurve Kosovën e gjeti me 1.781 persona të zhdukur. Edhe pse deri më tani është arritur që gjysma e numrit të të zhdukurve tu kthehen familjarëve të tyre, mbetet ende shumë punë për tu bërë. Megjithatë, vlen të përmendet puna që është bërë në infrastrukturën ligjore që e rregullon këtë fushë.

Ligji për personat e zhdukur adreson çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave të zhdukur, si dhe familjarëve të tyre, e në veçanti të drejtën për të ditur për fatin e personave të zhdukur. Po ashtu Ligji përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit qeveritar për persona të zhdukur.

Gjatë muajit dhjetor Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi edhe Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës, viktimave civile si dhe familjeve të tyre. E në kuadër të këtij ligji, është rregulluar edhe çështja e pensioneve mujore për familjet e personave të zhdukur.

Strategjia e Qeverisë, e vitit 2012 është hapja e 36 lokacioneve ku pretendohet se ka të zhdukur, ndërkohë që në 29 lokacione pretendohet se ndodhën shqiptarë. Kjo ngjall një fije shprese se po intensifikohen përpjekjet për të zbardhur dhembjen më të madhe të shumë familjarëve.

Është më se e qartë, sado që është i dhimbshëm fakti, se nuk mund të arrihen që të zbulohen të gjithë të zhdukurit mirëpo, si Grup Parlamentar bashkëndejmë dhembjen me familjarët dhe kërkojmë nga institucionet që të bëjnë përpjekjen e tyre maksimale deri në gjetjen e trupit të fundit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kërkon që të shtohet mbështetja mbarë institucionale për Komisionin qeveritar për persona të zhdukur dhe institucionet relevante profesioniste në ndriçimin e fatit të personave të zhdukur, identifikimin e mbetjeve mortore dhe sfidave të tjera që përballen në këtë proces mjaft kompleks.

Si deputetë të këtij Parlamenti i bëjmë thirrje bashkësisë ndërkombëtare për më shumë trusni ndaj institucioneve të Beogradit zyrtar të ofrojë informata mbi fatin dhe vendndodhjen e qytetarëve të Kosovës që u morën të gjallë, u kidnapuan dhe u zhdukën me forcë, e tash e sa vjet vazhdojnë të jenë të evidentuar si të zhdukur.

EULEX-i dhe të gjitha institucionet ndërkombëtare duhet të intensifikojnë presionin mbi Serbinë, konform konventave ndërkombëtare meqë ai është edhe e obliguar që të ofrojë informacione rreth zbardhjes së fatit të personave të pagjetur, të kidnapuar por edhe të arrestuar gjatë luftës.

EULEX-i si mekanizëm ndërkombëtar e ka obligim që të punojë në ndriçimin e fatit të njerëzve, të trokasë në derën ku mund të merret përgjigja për fatin e këtyre njerëzve, e ajo derë është Beogradi.

Instituti për krime të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, i themeluar në vitin e kaluar nga Ministria e Drejtësisë po vazhdon mbledhjen e dëshmimeve dhe të dhënave për të ofruar një mori informacionesh të cilat mund t'i përdorin të gjithë. Madje, këto të dhëna do të shërbejnë si bazë e mirë për të ofruar prova dhe dëshmi kundër Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ky institut në të ardhmen do të ofrojë informacione të sakta për ata që duan të dinë saktësisht historinë por edhe të vërtetën.

Po ashtu, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, Departamenti për mjekësi ligjore po vazhdon punën e tij duke ofruar kështu shërbime mjeko-ligjore, mësimdhënie dhe shërbime përkrahëse për familjet e personave të zhdukur.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne jemi të vetëdijshëm se, me gjithë përpjekjet që po bëhen, familjarët vazhdojnë të kërkojnë të drejtën e tyre elementare, e që është e drejta e tyre për tu informuar lidhur me fatin e më të dashurve të tyre.

Shpresojmë se ky vit do të hapë mundësi të reja për të kthyer në Kosovë trupat e shumë të vrarëve. Dhe, si përfundim, kërkojmë edhe një herë që kjo çështje të jetë si pikë e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës, zonja Hajzeraj-Beqaj e ka fjalën!

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara familje të të pagjeturve,

Vërtet çështja e të zhdukurve është një çështje e dhembshme, por domosdoshmërisht duhet të hapet në Parlamentin e Kosovës dhe po bëhet mirë që po debatohet për këtë çështje, sepse sot në Kosovë ende edhe 1.781 persona janë të pagjetur, për fatin e të cilëve nuk dihet asgjë, e që janë shumë.

Sot familjarët e tyre ende presin me shpresë se të afërmit e tyre do të gjenden diku, por është e pajustificueshme pritja e tyre për gjetjen e më të dashurve të tyre dhe pas 13 vitesh.

Gjenocidi që u ushtrua nga Serbia në Kosovë ishte çnjerëzor. Vrau shumë fëmijë e pleq, bura e gra, nuk kurseu as foshnjat në djep.

Sot jemi shtet i pavarur, katër vjet shtetësi. Sot Qeveria e Kosovës ka edhe Ligjin për të zhdukurit. Qeveria jonë nuk mund ta zbatojë këtë ligj sepse nuk ka vullnet të plotë për zbatimin e këtij ligji, sikurse nuk ka vullnet për zbatimin e shumë ligjeve tjera.

Unë i bëj pyetje Qeverisë së Kosovës pse nuk përkrahet Departamenti i mjekësisë ligjore për zbardhjen e fatit të pagjeturve apo të zhdukurve, ku edhe sot kemi rreth 350 mbetje mortore që janë të paidentifikuara.

Ky departament funksionon me një ekspert për identifikimin e trupave, të cilët gjenden si të zhdukur. Pra, kemi deficit të ekspertëve për këtë fushë. Gjithmonë ky departament me punë vullnetare ka punuar, duke mos u përkrahur fare nga Qeveria.

A ka menduar ndonjëherë kjo Qeveri që të ndajë një shumë të hollave që të trajnohen edhe më shumë ekspertë për këtë fushë, apo Qeveria ka rënë në gjumë.

Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon që çështja e të zhdukurve të merret më me seriozitet nga Qeveria e Kosovës, të paktën sa i përket çështjeve teknike, financiare dhe të jetë e gatshme të punojë dhe të jemi më të vullnetshëm për zbatimin dhe avancimin e më shumë ekspertëve për identifikimin e trupave. Të përkrahë familjarët e të zhdukurve, që të paktën mos të vuajnë edhe për kafshatën e gojës, sepse sot e dimë që shumë nga familjarët e të

zhdukurve janë në gjendje të mjerueshme. Pra, kjo kategori do të duhej që të ketë një vend të merituar, sepse ka vuajtur mjaft.

I bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës që, së bashku me EULEX-in, të bëjnë presion në Bashkimin Evropian dhe Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, të bëjnë më shumë trysni ndaj Serbisë që të zbardhen edhe më shumë vatra të tjera me persona të zhdukur, sepse deri më tani shumë herë kemi hasur në mosgatishmërinë e shtetit serb apo, të themi, asnjëherë nuk kemi hasur në gatishmërinë e shtetit serb për t'i gjetur vatrat tjera, sepse këto krime i ka bërë shteti serb dhe nuk i kanë bërë grupet e individëve andaj përgjegjës dhe duhet të përgjigjet shteti serb. Të paktën të keni ndjeshmërinë dhe të ndani një vend memorial për trupat e të zhdukurve dhe fotografitë e tyre të cilat janë lagur nga shiu e bora, të cilat gjenden në rrethojat e Parlamentit të Kosovës dhe të kenë një vend meritë.

Lidhja Demokratike e Kosovës shpreh dhembjen për të gjithë familjarët e të zhdukurve dhe mbetet me shpresë që sa më parë të gjenden.

Prandaj, ne do t'i shtojmë edhe një rekomandim të gjitha këtyre rekomandimeve të Komisionit dhe kjo pikë është që: Kosova në bisedimet me Serbinë ta ketë prioritet çështjen e të zhdukurve. Faleminderit!

(Drejton mbledhjen kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Vetëvendosjes, deputeti Albin Kurti, e ka fjalën!

ALBIN KURTI: Faleminderit kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Për familjet e të pagjeturve lufta nuk ka përfunduar ende! Ato jetojnë në ankth ose janë edhe të traumatizuara.

Ja se çfarë thotë Deklarata e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në Komisionin e përhershëm të Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës, Varshavë 23 nëntor 2004:

“Kalimi i kohës nuk është shërues për familjet e të pagjeturve. Vetëm përgjigjet mund tu ndihmojnë atyre që të shikojnë drejt ardhmërisë dhe të parandalojnë që ankthi i tyre të shndërrohet në urrejtje të përhershme. Jo vetëm personat e rrëmbyer por edhe familjet e tyre janë viktima të këtij krimi të vazhdueshëm.”.

Familjet e të pagjeturve nuk e kanë pasur asnjëherë përkujdesjen e nevojshme institucionale por edhe sjellja e shoqërisë karshi tyre ka qenë e llojit: – E po luftë ishte ajo!

Flitej me pietet për shpëtimin e popullit duke u neglizhuar ata që nuk shpëtuan. Kjo çështje konsiderohej thua se ato janë probleme të familjeve të tyre, e jo të Kosovës. Më të dashurit e tyre u morën peng sepse janë shqiptarë, e jo sepse iu takojnë familjeve të caktuara.

Ka qenë shumë e rëndë për familjet që të shohin zhvarrosjet nëpër Serbi dhe se si kufomat atje mbeshin në duart e kriminelëve që i kanë vrrarë ata. Secila qeveri në Beograd i ka

shfrytëzuar të pagjeturit për poena politike, duke përfituar nga faktorët ndërkombëtarë me rastin e gjetjes ose kthimit të tyre në Kosovë, për tu dukur sa më ndryshe prej regjimit të Millosheviqit apo edhe për ta sulmuar Kosovën dhe UÇK-ën menjëherë më pas.

Para 11 vjetëve edhe ligji i Serbisë për amnisti i liroi vetëm 220 shqiptarë dhe në fakt kishte për qëllim të lironte 30.000 dezertorë serbë. Ashtu qysh shqiptarët e burgosur lroheshin në grupe të vogla për ta shumëfishuar efektin, edhe kufomat e të pagjeturve ktheheshin nga disa dhjetëra më së shumti, ani pse 860 prej tyre u gjetën vetëm në varrezën masive në Batajnicë.

Të pagjeturit shqiptarë janë pengje të luftës. Pengjet shqiptare nuk u përfshinë në Marrëveshjen e Kumanovës. Aty nuk u fut gjuha e Konventës së Gjenevës si rezultat i negociatave me gjeneralët e ushtrisë së Jugosllavisë së Millosheviqit.

Bombardimi i NATO-s ishte për shkaqe humanitare, mirëpo humanizmi u la jashtë nga Marrëveshja e Kumanovës.

Përgjigja gjithsesi qëndron në Serbi, e cila u mundua ta fundoste të vërtetën nëpër liqenet e lumenjtë e sajë, duke i zhytur kamionët frigoriferë me kufoma atje.

Serbia është fajtores për planin e rrëmbimit, të vrasjes dhe fshehjes së gjurmëve të krimit.

Serbia është e rrezikuar nga e vërteta dhe e kaluara e saj. Nëse flasim dhe e rrëmojmë të kaluarën, atëherë do t'i dalin krime të mëdha dhe të tmerrshme Serbisë. Kjo do t'ia dobësonte pozicionin Serbisë për sulmet e saj të vazhdueshme ndaj Kosovës. Dhe, mbase pikërisht për këtë arsye kjo edhe nuk ndodhë.

Në përgjithësi, të pagjeturit shqiptarë nuk janë përmendur e kërkuar aq nga asnjë qeveri e pasluftës. Duket që ka ekzistuar një pakt i heshtjes, një së lloj marrëveshje xhentëlmeni midis Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë: “Ju mos na i përmendni as kërkonit as serbët e pagjetur, ne s'po ua kërkojmë shqiptarët e pagjetur që janë shumëfish më shumë”.

Në veçanti nuk është përmendur e kërkuar profesor Ukshin Hoti. Është negociuar nga shqiptarët në Rambuje, në Vjenë e në Bruksel për Kosovën me Serbinë por profesor Ukshin Hoti s'u bë as kusht dhe as temë në asnjërën prej këtyre negociatave.

Besoj se është legjitime të dyshojmë që ky mosangazhim vjen prej faktit që ajo çka ka shkruar Ukshin Hoti dhe ajo që kanë bërë këto qeveri të pasluftës përbën një kontrast të thellë sikurse edhe jeta dhe sjellja e këtyre.

Shumë prej të pagjeturve janë vra në Kosovë, janë varrosur në Kosovë, janë zhvarrosur në Kosovë, janë dërguar në Serbi, janë varrosur në Serbi, janë zhvarrosur në Serbi dhe mandej janë varrosur serish në Kosovë.

Vitet e pasluftës, për familjet e të pagjeturve janë vite kur shpresa e tyre plotë dhembje shndërrohej në një dhembje të pashpresë. Nga Serbia janë kthyer dhjetëra thasë me numra që përmbajnë nga një grumbull jo të plotë të eshtrave. Shumë familje kosovare janë detyruar t'i

hapin sërish varret e më të dashurve të tyre për të varrosur edhe eshtrat e një gjymtyre që u kthye më vonë.

Procedurat e identifikimit për ata që i kthyen, ishin jashtëzakonisht të ngadalshme dhe ato për më tepër i karakterizon kualiteti shumë i dobët i ekzaminimit mjekësor. Kësisoj, me rastin e shqyrtimit të tyre në Kosovës, qysh në kohën e UNMIK-ut del në pah një diskrepancë prej 10% në raportet e identifikimit dhe deri në 70% në raportet mbi shkakun e vdekjes.

Çështja e kufomave të pakthyera ka të bëjë me drejtësinë, por edhe me të gjallët, me jetën e familjeve të tyre që është ndalur. Përkundër gjithë kësaj, familjarët e të pagjeturve asnjëherë nuk e kanë ndalur angazhimin. Edhe atëherë kur arrestoheshin nga policia për shkak të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, edhe atëherë kur dihej se suksesi i aktivizmit të nënave ishte veç se sa thasë të kthyer nga Serbia me eshtra të djemve të tyre. Ato përherë kanë kërkuar përgjegjësi dhe drejtësi nga autoritetet për të arritur tek e vërteta për më të dashurit e tyre.

Nga 1 nëntori i vitit 2003 e deri më 1 shkurt të vitit 2004 janë mbledhur 236.311 nënshkrime për petitionin për pengjet e pagjetura, në kuadër të fushatës “Të gjithëve na mungojnë”. Solidarizimi me kërkesat e petitionit për zbardhjen e fatit të pengjeve të pagjetura theksoi rëndësinë e zbulimit të së vërtetës dhe zbatimit të drejtësisë.

Në ekshumimet e kryera në Serbi, s’ka hetime penale për krimet, por vetëm mbikëqyrje gjyqësore. Pra, jo sikurse ishte rasti me Tribunalin e Hagës dhe me tre vëllezërit e zhdukur Bytyqi nga Theranda, të cilët e kishin edhe nënshtetësinë amerikane.

Në ekshumimet që bëhen në Serbi, UNMIK-u nuk ishte pjesëmarrës, por vetëm vëzhgues, derisa kosovarët nuk janë as vëzhgues.

Gjykatat në Serbi kanë ngritur vetëm disa akuza kundër personave për rastet e krimeve të kryera në Kosovë gjatë luftës.

Për bashkësinë ndërkombëtare nuk qëndron çështja se ku duhet të adresohet pyetja, por qëndron pyetja: – pse kjo çështje nuk po adresohet atje tek ata persona që e dinë përgjigjen dhe duhet të përgjigjen. Pra, në Beograd!

Tek të pagjeturit, kemi situatën kur mungojnë njerëzit që janë e vërteta e Serbisë por edhe mungon e vërteta për ta: Ku u vranë, si u vranë, kur u vranë dhe kush i vrau? Tek e vërteta mund të arrijmë vetëm nëpërmjet përgjegjësisë që e kërkojmë. Është Serbia ajo që duhet të detyrohet t’i hapë dosjet të cilat me siguri se do të zbulonin fatin e shumë njerëzve të pagjetur.

Serbia ka dosje. Për shembull, për vrasjet në Vukovar të Kroacisë, i kanë pasur të gjitha dosjet me fotografi dhe procedurë të kryer patologjike për to. Për këtë ka folur Shtefica Kërstiq, një nënë kroate që e ka gjetur djalin e vranë, pas nëntë vjet kërkimi.

Në anën tjetër, prokuroritë dhe gjykatat në Kosovë, edhe gjatë kohës së UNMIK-ut kur ishin pjesë e Shtyllës së parë të tij, edhe tash me EULEX-in më shumë se katër vjet pasi që u shpall pavarësia e Kosovës përgjithësisht janë në gjendje të mjerueshme. Ka fare pak prokurorë të cilët gjithnjë iu japin prioritet rasteve të krimeve ordinere të pasluftës duke qenë se nuk kanë të drejtë të gjykojnë njerëz në mungesë, dhe kriminelët e luftës konsiderohen të arratisur tashmë.

Prandaj, është më se i nevojshëm një hetues i pavarur që do t'i hulumtojë të gjitha çështjet lidhur me rrëmbimin e personave, transferimin e tyre, pastaj transportin dhe zhvarrosjen e këtyre kufomave dhe që do ta zhvillojë procedurën legale për ndjekjen e këtyre krimeve.

Drejtësia restauruese është e domosdoshme e për të janë të nevojshme gjykata të pavarura, shumë vullnet politik e njerëzor, gjetje dhe mobilizim i dëshmimeve dhe dëshmitarëve, kompensim për viktimat.

Nëse koha shëron plagët shpirtërore të të gjallëve për të vdekurit, ajo i rrit ato kur bëhet fjalë për personat e pagjetur. Luftërat shkatërrojnë jetët e shumë njerëzve, por edhe ndërtuan kujtime të hidhura të pashlyeshme. Edhe afër njerëz mungojnë. Nuk duhet të harrojmë që të mungosh do të thotë të jesh. Të pagjeturit janë, porse ata duhet gjetur. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kush e do fjalën? Fjalën e ka deputetja Kimete Bajraktari!

KIMETE BAJRAKTARI: I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

E kaluara e dhembshme si dhe dështimi i mbrojtjes së të drejtave individuale dhe vendosja e sundimit të ligjit rëndon brishtësinë e paqes dhe është pengesë për zhvillimin e shoqërisë demokratike.

Sipas Konventës së Gjenevës, të 12 gushtit 1949 dhe protokolleve shtesë të tyre të 18 qershorit 1977 e drejtë familjare është të dinë për më të dashurit e tyre. Këtë të drejtë duhet t'ia sigurojë Qeveria, e cila e ka obligim për të dhënë përgjigje për secilin rast të personave të zhdukur.

Procesi i personave të zhdukur është humanitar, politik dhe juridik. Si proces humanitar familjeve iu intereson të dinë për fatin e më të dashurve të tyre. Familjarët janë ata të cilët organizohen në shoqata, organizohen në tubime, protesta, greva, greva urie dhe nuk lejuan që krimet e bëra në Kosovë të heshtën.

Që nga viti 2005 kemi bllokim virtual në kërkim për të zhdukurit. Pse? Si duket, nuk ishte me prioritet për Qeverinë zbardhja e fatit të personave të zhdukur.

Në vitin 2001 organet vendore të përkohshme, formuan Komisionin qeveritar për persona të zhdukur i cili deri më tani nuk ka krijuar një arkiv të të dhënave të personave të vrarë dhe të zhdukur gjatë luftës në Kosovë, por ende punohet me regjistrin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Pse i lejohet Fondit për të Drejtën Humanitare, me seli në Beograd, me manipuluar me regjistra për persona të vrarë ku janë futur ushtarë e policë në këta regjistra, ndërsa në këtë rast kemi të bëjmë me vetëm viktime civile të luftës.

Po ashtu, edhe Kuvendi i Kosovës ka debatuar për çështjen e personave të zhdukur dhe atë në prill të vitit 2003, kur është miratuar një rezolutë dhe deklarata e korrikut të vitit 2005, pse nuk u zbatuan.

Më vonë, janë formuar grupe punuese për bisedime në relacionin Prishtinë – Beograd nën lehtësimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq që gjer më tani nuk kemi rezultate të kënaqshme.

Në Asamblenë e Kombeve të Bashkuara, është vendosur të ketë bisedime teknike në mes Kosovës dhe Serbisë dhe se pikënisje e këtyre bisedimeve teknike do të jetë çështja e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur.

Më 13 maj 2012, zonja Edita Tahiri ka mbajtur një takim me anëtarët e Këshillit koordinues të Asociacionit familjar për persona të zhdukur, të cilëve në këtë takim iu është premtuar se këto bisedime do të fillojnë me çështjen e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur.

Sipas deklarimeve të bëra në gazetën “Koha ditore” të datës 2 maj 2012, zëvendëskryeministrja e ka mbajtur premtimin.

Dhe, pasi që zëvendëskryeministrja e ka mbajtur premtimin, le të na tregojë se me kë, kur dhe ku ka biseduar për këtë çështje dhe kush ishte lehtësuesi, dhe kur do të shihen rezultatet e para të pritshme të kësaj të arriture, apo duhet të kalojnë edhe 13 vjet të tjera.

A ka strategji ekipi dialogues apo plan të veprimit për zbardhjen e fatit të të zhdukurve?

Mosvënia prioritet për politikanët dhe mungesa e vullnetit politik për zgjedhjen e fatit të të zhdukurve u pa edhe më 27 prill në “Lëndinën e lotëve” në Mejë – në Ditën e të zhdukurve të Kosovës, ku ata nuk ishin pranë familjarëve të cilëve kryeministri iu kishte premtuar para 2 viteve se do të ndante buxhet për memorialin në Mejë.

Kryeministër, duhet mbajtur premtimet! Ndërsa, presidentja e Kosovës u pa të shkonte në një “ballo vieneze”.

Si çështje juridike, lirisht mund të themi se çështja e ndjekjeve të kriminelëve, që kanë bërë krime, e që dihen me emër e mbiemër, nuk ka filluar fare. Edhe pse janë bërë me dhjetëra kallëzime penale për krime lufte, ato kanë ngelur në sirtarët e prokurorive. Kriminelët, të cilët kanë bërë krime në luftë, sillen lirshëm.

Pse deri më tani, nuk ekziston gjykata speciale për krime të luftës? Pse nuk reagoher në gjykimet që mbahen në Beograd, ku parashtruesi i kallëzimit penal është bërë nga Fondi për të Drejtat Humanitare në Beograd, ku dihet që kriminelët duhet të gjykohen në vendin e krimit. E kemi rastin e Podujevës, Suharekës dhe Qyshkut.

Nëse prioritetet e Qeverisë janë të natyrës teknike dhe çështjen e personave të zhdukur e trajton si çështje humanitare apo politike, bëheni edhe çështjen e të zhdukurve teknike dhe vendoseni në agjendën e prioritetëve, se ne e dimë shumë mirë se gjaku nuk humbet dhe ne do të vazhdojmë të kërkojmë kthimin e më të afërmeve tanë në tokën e Kosovës, se ata i takojnë kësaj toke. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për familjarët që janë sot në seancë!

Përshëndetje për ministrin dhe deputetët e kësaj seance!

Duke marrë parasysh se çështja e të zhdukurve është një çështje shumë e rëndë dhe e ndjeshme që lidhet me tragjedinë që përjetuan shumë familje kosovare gjatë luftës, institucionet e Kosovës, ndonëse kanë krijuar një Komision për të pagjeturit, nuk e kanë trajtuar në mënyrë efektive vetë problemin.

Zgjidhja e këtij problemi po zgjatë më shumë se një dekadë dhe dramat e familjarëve po vazhdojnë.

Grupi Parlamentar i koalicionit për Kosovë të Re, mendon se është momenti i fundit që Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera duhet të shtrojnë këtë problem në mënyrë të vendosur.

Duhet të kërkojmë që kjo çështje të vihet në prioritet të bisedimeve teknike midis Beogradit dhe Prishtinës duke kërkuar nga Beogradi pse po vonohet të kthejë mbetjet mortore nga varrezat masive përreth Beogradit e gjetiu në Serbi.

Institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin një fushatë të gjerë intensive, të informojnë faktorin ndërkombëtar, gjithë organizatat ndërkombëtare e mediat për dimensionet e këtij problemi dhe sjelljet tjera jo humane të një shteti që pretendon të jetë anëtar i BE-së. Faktori ndërkombëtar të bëjë një presion që kjo sjellje e Beogradit të ndryshojë rrënjësisht njëherë e përgjithmonë.

Pra, duke marrë parasysh që kjo çështje, siç e thash edhe në fillim, është shumë e ndjeshme, atëherë mbetet që ne të veprojmë dhe jo të flasim në llogari të njerëzve të cilët sot nuk janë në mesin e të gjallëve. Ju faleminderit!

(Drejton mbledhje kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-ës? Deputeti Sasha Millosavljeviq, e ka fjalën. Regjia, fjalën e ka deputeti Sasha Millosavljeviq!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovane kolege, ja bih želeo na početku da se osvrnem na ove preporuke koje smo dobili od Komisije za ljudska prava i na početku da vas obavestim da poslanica Biserka Kostić, koja je član ove komisije, nije bila u opšte pozvana na pripremu ovih preporuka.

Drugo. Imali smo 10 minuta da razmotrimo ove preporuke. I mi kao Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke se u opšte ne slažemo sa tačkom 3. i tačkom 4. u kojoj se kaže da veće angažovanje institucije Republike Kosova na međunarodnoj senzibilizaciji pitanje nestalih lica za vreme rata tražimo da se doda „i posle rata“. U tački 4. da se fokusira „na zahtev od međunarodne zajednice za prava kod zvaničnih autoriteta u Beogradu“. Tražimo da se stavi „u celom regionu“ jer se ovde po ko zna koji put, gospodo, optužuje samo jedna strana, a to je srpska da je kriva za sve što se dešavalo za vreme i posle rata na Kosovu. To je nedopustivo i mi smatramo da je krajnje vreme da se prekine sa tim.

U ovakvim situacijama, Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke smatra da treba da budemo realni i ispravni u donošenju svih odluka.

Svi lepo ovde znate da nije kriva samo jedna strana. I ukoliko se ne promene ove stavke u ovim preporukama, mi ih nećemo podržati. Hvala!

KRYETARI: Rekomandimet mund të harmonizohen prandaj edhe i keni ato rekomandime. Kush e do fjalën në emër të Grupit Parlamentar 6+? Deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Familjarë të nderuar të personave të zhdukur,

Jemi duke debatuar për një çështje shumë të ndjeshme dhe të rëndësishme, për një kategori të njerëzve të cilët meritojnë që për ta të flitet me respektin më të madh dhe me respekt të veçantë.

Sot, edhe 13 vite pas konfliktit në Kosovë nuk dihet për fatin e mijëra njerëzve të cilët edhe sot konsiderohen si persona të zhdukur dhe për fatin e tyre anëtarët e familjeve dhe të afërmit e tyre nuk dinë asgjë.

Shumica prej tyre kanë humbur besimin se në një të ardhme të afërmit do të jenë të informuar se çfarë ka ndodhur dhe ku gjenden ata të dashurit e tyre. Janë ngritur komisione të cilat kanë me punuar në këtë drejtim mirëpo të gjithë ne e dimë se kjo ka qenë e pamjaftueshme që së paku të sigurojnë informacione lidhur me ndriçimin e fatit të këtyre personave.

Në anën tjetër, parashtrohet pyetja se çfarë dhe sa kanë bërë institucionet e vendit, institucionet ndërkombëtare dhe shoqëria në tërësi për këta njerëz. E ne mendojmë se pak dhe se nevojitet angazhim shumë më i madh dhe sa më parë të zbardhet fati i personave të zhdukur dhe me një angazhim maksimal tu kthehet besimi i humbur dhe t'i jepet fund zhgënjimit të tyre të përditshëm sepse familjarët dhe qytetarët së paku këtë e meritojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke folur në emër të kartelës së Enisit, a mos e keni ndërruar? Mirë, deputeti Albert Kinolli ka folur me kartelën e deputetit Enis Kervan!

(Ndërhyrje)

Jo, regjia atje e regjistron. Unë po flas për regjinë. Tash i kemi edhe 10 minuta deri te një pauzë dhe po shkojmë sipas radhës.

(Ndërhyrje)

Mirë. Fjalën po ia japim deputetit Kurtan Kajtazi. Le të përgatitet deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar familjarë të zhdukurve,

Të nderuar deputetë,

Sot po diskutojmë njërën nga temat më të ndjeshme dhe ë të dhembshme të pasluftës në Kosovë. Po diskutojmë për të zhdukurit dhe plagët e mijëra familjeve shqiptare të Kosovës që vazhdoj në të presin ndonjë lajm për të afërmit e tyre të zhdukur që nga lufta e fundit në vend.

Deri sa po diskutojmë për këtë temë, nuk mund të anashkalojmë pa u kthyer mbrapa për të diskutuar për planet kriminale serbe për zhdukjen e shqiptarëve dhe popujve sllavë të hartuar nëpër shekuj nga ideologët serbë. Nuk mund të diskutohet për të zhdukurit e luftës së fundit pa i kujtuar elaboratet e Çubrilloviqit të vitit 1937 me titull: Shpërngulja e shqiptarëve, referatin tjetër me titull: Problemi i pakicave kombëtare të Jugosllavisë së re, të vitit 1944, Projektin për zhdukjen e shqiptarëve, hartuar në vitin 1939 nga nobelisti serb Ivo Andriq dhe vazhdimin e zbatimit të këtyre projekteve pas Luftës së dytë botërore nga nxënësit e tyre Rankoviqit e Millosheviqit.

Në këto elaborate shihet pikërisht përmasa monstruoze e synimeve të shovinistëve serbë se si qindra mijëra gjermanë, hungarezë, rumunë e në veçanti shqiptarë janë shpërngulur dhe zhdukur, që është një akt i pa precedent kriminal kundër popujve sllavë.

Masat monstruoze të shpërnguljes së popujve sllavë nga Jugosllavia u zbatuan nga ushtria jugosllave, pikërisht ashtu siç i kishte elaboruar ideologu Çubrilloviq me devizën: se vetëm në kohë luftërash është i mundshëm pastrimi i Jugosllavisë nga pakicat kombëtare.

Kjo ëndërr e vjetër e serbëmëdhenjëve, të kralëve të vjetër e të rinj, u josh me të madhe në prag të mbarimit të Luftës së dytë botërore dhe do të zgjasë deri në fund të luftës së fundit në Kosovë, në vitin 1999.

Gjatë viteve 1876 – 1878 ushtria serbe dëboi nga viset shqiptare të Toplicës, Kurshumlisë, Prokuples, Vranjes dhe Leskovcit, më se 300.000 shqiptarë dhe u dogjën rrafsh me tokë më se 80 fshatra. Që nga ajo kohë e deri në prag të Luftës së dytë botërore janë pushkatuar e zhdukur mbi 200.000 shqiptarë dhe janë shpërngulur për në Turqi e Shqipëri mbi 500.000 të tjerë.

Vetëm pas Luftës së dytë botërore, deri në vitin 1948 u zhdukën dhe vranë 40.000 shqiptarë, ndërsa prej vitit 1949 deri në vitin 1956 edhe 30.000 të tjerë. Vetëm në mes viteve 1953 –

1960, Rankoviqi duke zbatuar platformën e mësuesit të tij, nga Kosova shpërnguli për në Turqi afër 240.000 shqiptarë. Dhuna sistematike, vrasjet dhe shpërngulja e shqiptarëve vazhdoi edhe pas pranverës së vitit 81 deri në qershorin e vitit '99.

Projektet për zhdukjen e shqiptarëve vazhduan edhe gjatë luftës së fundit në Kosovë. U dëbuan nga Kosova mbi 1.000.000 shqiptarë. U vranë, masakruan dhe u zhdukën mbi 16.000 persona dhe Serbia asnjëherë, për gjithë ato krime nuk kërkoi falje dhe as bashkësia ndërkombëtare nuk i dha dënimin e merituar.

Të gjitha ato elaborate ishin udhërrëfyes për masakrat e bëra në Kosovë nga ushtria dhe policia jugosllave e sponzoruar nga qeveria e Serbisë.

Sot në Kosovë kanë mbetur të pagjetur edhe 1.781 persona. Familjet e tyre kudo nëpër Kosovë, Vushtrri, Mitrovicë, Krushë, Gjakovë, Besianë, Suharekë dhe shumë qendra tjera, çdo ditë presin me ankth të dinë për fatin e më të dashurve të tyre. Në mesin e tyre është edhe veprimtari, ideologu dhe patrioti i çështjes shqiptare Ukshin Hoti.

Është minimumi që qeveria e Serbisë të tregojë për vendndodhjen e këtyre varrezave masive dhe mos ta përdorë çështjen e të pagjeturve si mjet lufte diplomatike kundër Kosovës, por ta trajtojë si çështje humanitare.

Bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjë tryzni më të madhe, t'i vejë kushte qeverisë së Serbisë, t'i hap dosjet e Ministrisë së punëve të brendshme të atëhershme Jugosllave dhe Armatës së Federatës Jugosllave, për të ditur se çka ka ndodhur me fatin e mbi 1.800 personave, ende të pagjetur.

Në morgun e Prishtinës janë 250 mbetje mortore dhe 101 pjesë të trupave të personave të varrosur menjëherë pas luftës. Kërkojmë që EULEX-i të luftojë më me ngulm për të hulumtuar varrezat masive në qytetet e Rashkës, Peruçacit afër kufirit me Bosnjen e Hercegovinën, në Republikën e Maqedonisë, ku mendohet se janë disa varreza dhe vlerësimi i varrezës së dyshuar në Rudnicë.

Lusim familjarët e të zhdukurve, që të ndihmojnë në sigurimin e mostrave krahasuese të gjakut për mbetjet mortore, që gjenden në morgun e Prishtinës. Gjithashtu, kërkojmë që po ashtu, nga Qeveria e Kosovës të mënjanojnë vështirësitë me të cilat përballet Departamenti i Mjekësisë Ligjore dhe lehtësojë punën e tyre. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Dhe, para pauzës deputetja që do ta ketë fjalën, është Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryetar,
I nderuar ministër,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar familjarë të të pagjeturve,

Gjatë luftës së fundit në Kosovë ndodhën shumë krime barbare mbi popullatën shqiptare, të ushtruar pa mëshirë nga pjesëtarët e forcave policore, ushtarake e paramilitare serbe, krejt të udhëhequr nga një zinxhir komandues shtetëror.

Në këto krime nuk u kursyen as fëmijët, as pleqtë dhe as gratë shtatzëna. Familjarët e të pagjeturve të komunës së Suharekës i kanë shpirtrat e plagosur, sepse në atë tragjedi kanë pësuar 18 fëmijë. Më i riu ka qenë vetëm 9 muaj.

Në Kosovë kanë ndodhur krime aq të tmerrshme, për të cilat mekanizmat ndëshkuese, penale dhe morale janë të pamjaftueshëm për të dhënë satisfaksionin e drejtësisë për viktimat. Asnjë formë ekzistuese e dënimit, as dënimi me burg të përjetshëm nuk e ka fuqinë e mjaftueshme ekuivalente për të ndëshkuar përmasat e krimit ose tmerrit radikal.

Po çfarë bëme ne? Çfarë bëri Bashkësia ndërkombëtare, administrata e UNMIK-ut e EULEX-it, Qeveria dhe partitë politike në Kosovë? A bëme hap konkret politik, me qëllim të zbardhjes dhe ndriçimit të çështjes së të zhdukurve, të kidnapuarve, të pengjeve dhe të viktimave të tjera të luftës.

Fshehja e të dhënave për personat e humbur dhe të vrarë, paraqet para së gjithash shkelje të së drejtës humanitare, të sanksionuar me Konventën e Gjenevës dhe të protokolleve shtesë.

Familjarët, që presin me ankth për fatin e më të dashurve të tyre, nuk janë të kënaqur me punën e gjertanishme të organeve vendore e ndërkombëtare. Edhe pse, sipas negociatores së bisedimeve me Serbinë thuhet se janë arritur rezultate. Çfarë rezultate, ku janë? Ende nuk e dimë, edhe pas kaç vitesh, ku është Ukshin Hoti, ku janë të tjerët, që janë marrë me dhunë. Nga Serbia janë kthyer vetëm 800 mbetje mortore në thasë plastmasti. Ku janë të tjerët?

Është e kuptueshme se në dosjet sekrete të policisë dhe ushtrisë serbe gjendet e vërteta, për të gjitha vrasjet në Kosovë. Andaj, gjatë zhvillimit të bisedimeve Prishtinë – Beograd, është dashur të kemi një dokumentacion komplet me një listë të personave të zhdukur dhe të vrarë. Bile, është dashur të jetë kusht për fillimin e bisedimeve. Së pari, do të duhej të diskutoheshin problemet për zbardhjen e fatit të të pagjeturve, e pastaj për problemet tjera.

Kërkojmë nga të gjithë faktorët relevantë vendorë dhe ndërkombëtarë, që të përdorin ndikimin e tyre për zbardhjen e fatit të të gjithë të pagjeturve, si dhe kërkojmë nga organet e drejtësisë ndërkombëtare, që të ndërmerren të gjitha masat për të vënë para drejtësisë shtetin, i cili vrau gra pleq dhe fëmijë.

Me u anëtarësua në Bashkimin Evropian, e kam thënë njëherë, po e përsëris përsëri, vendi i cili ende nuk ka zbardhur çështjen e personave të zhdukur, për mua është e pakuptueshme. Për t'u futur në BE-në, së pari ky shtet do të duhej të kërkonte falje për të gjitha krimet e bëra në Kosovë, t'i kthejë rreth 1.800 trupa të pajetë të shqiptarëve, si dhe t'i dorëzojë para drejtësisë personat, të cilët i kanë kryer këto krime.

Sa herë që të hyj në Kuvend ose kaloj pranë fotografive të të pagjeturve, më duket se ata po na qortojnë, më duket se ata po thonë se edhe të vdekur nuk po mundemi me qenë në Kosovë. Eshtrat tona po i mbanë peng, ai që na e mori jetën.

Të nderuar deputetë dhe institucione të Kosovës,
E kemi për obligim të bëjmë më shumë për të pagjeturit, sepse familjarët e tyre që sa vite, sa herë troket dera e tyre, mendojnë se po u vinë ata. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Pauzë deri në ora 14.00

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën)

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë me debatin deri sa të ketë kuorum.

Dua të ju njoftoj, që Kryesia në mbledhjen e saj të fundit, bashkë me kryetarët e grupeve parlamentare, ka marrë vendim, që pas fjalës së kryetarëve të grupeve parlamentare ose të përfaqësuesve të grupeve parlamentare, për debat propozohet që fjala e çdo deputeti i të jetë 5 minuta. Besoj se mjafton kaq.

A ka kundër këtij propozimi. S'ka. Atëherë, vazhdojmë me 5 minutshin. Fjalën e ka deputetja, Kimete Bytyqi!

KIMETE BYTYQI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja e të pagjeturve është brengë për shoqërinë tonë. Kjo është plagë, e cila rëndon mbi familjarët e të pagjeturve, rëndon mbi secilin qytetar të këtij vendi, që ka ndjenja njerëzore dhe duke qenë kështu kjo plagë duhet të rëndojë edhe mbi secilin përfaqësues të institucioneve shtetërore, Qeverisë, Presidencës, Parlamentit.

Qeveria është në proces të bisedimeve me përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë dhe unë mendoj se pika e parë në fokus të agjendës të bisedimeve është dashur të jetë, pikërisht çështja e të pagjeturve.

Si mund të jetë pajtimi midis dy vendeve, si mund të ketë marrëveshje midis dy vendeve, kur mijëra qytetarë tanë janë ende të pagjetur dhe Qeveria e Serbisë e din fare mire se ku ndodhen ata?

Para disa ditësh, u takova me një nënë nga Theranda. Kjo plakë 86 vjeçare, i ka më se 24 të zhdukur, me lot në sy pret të kuptojë se çfarë ka ndodhur me djemtë, nipat dhe mbesat e saj. Si kjo nënë, Kosova ka plotë nëna, që presin të njëjtën gjë.

Qeveria e Kosovës duhet të kërkojë nga bashkësia ndërkombëtare, që të bëjë presion mbi Serbinë, që të jep informacione për fatin e qytetarëve tanë. Kjo është çështje urgjente! Nuk

ka marrëveshje dhe nuk ka pajtim me palën serbe, nëse ende nuk është zbardhur fati i qytetarëve tanë të zhdukur. Falemnderit, kryesues!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Ganimete Musliu!

GANIMETE MUSLIU: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Të dashur familjarë të personave të pagjetur,

Një ndër brengat më të mëdha, që Kosova ka sot e 13 vjet, është zgjedhja e fatit të personave të pagjetur. Duke pasur parasysh angazhimin, që po bën Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur, për të zbardhur fatin e 1.781 personave dhe duke i kuptuar rrethanat dhe pamundësitë, për t'i dhënë fund kësaj brenge, që na shoqëron çdo ditë, kërkoj nga Komisioni Qeveritar, që këtë problem ta trajtojë në mënyrë sa më të dinjitetshme dhe me përkushtim të punojë për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur dhe ruajtjen e dinjitetit të familjeve të tyre.

Çështja e personave të pagjetur është një ballafaqim me të kaluarën, që ne në asnjë rrethanë nuk guxojmë ta harrojmë, sepse kujtesa mbi të kaluarën, gjithmonë shërben për ndërtimin e një të ardhmeje paqësore.

Trajtimi me dinjitet i personave të pagjetur është lehtësim për familjarët e tyre dhe mesazh i qartë, që shteti është në shërbimin e tyre.

Të nderuar deputetë, pamjet e fotografive para Kuvendit, me keqardhje them, se e pasqyrojnë të kundërtën, andaj kërkoj nga Komisioni për Persona të Pagjetur, që në pamundësi që familjarëve t'ua kthejë më të dashurit e tyre, në një afat sa më të shpejtë, t'i mbledhë këto fotografi dhe t'i ekspozojë në mënyrë sa më të dinjitetshme, qoftë edhe duke i futur brenda oborrit të Kuvendit, por të jenë të mbrojtura nga reshjet dhe nga çdo dëmtim tjetër. Sepse, është tepër e dhembshme të shihen ato fotografi se si janë katandisur. Besoj shumë, që kjo është e mundur për Komisionin, prandaj shpresoj se kërkesën time e që është edhe kërkesë edhe e familjarëve të pagjetur, ta marrë në konsideratë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Emin Gërbeshi! A është këtu? Nuk është. Deputetja Sevdije Lama. A është? Jo! Atëherë, fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Falemnderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar familjarë të personave të pagjetur,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Se institucionet e Kosovës, përkatësisht bartësit kryesorë të tyre nuk i respektojnë madje, as datat dhe vendimet që i marrin vetë, kjo u dëshmuar më së miri më 27 prill, në Ditën e të zhdukurve në Kosovës. Mijëra familjarë, atë ditë në Mejë të Gjakovës, pritën më kot kryeministrin dhe presidentin e vendit.

Sa për rifreskim të memories sonë kolektive, data të cilën Kuvendi e ka shpallur ditë të të zhdukurve të Kosovës, ishte zgjedhur nga se më 27 prill të vitit 1999 në Mejë të Gjakovës ndodhi masakra më e madhe në Kosovë, kur vetëm për dy orë u rrëmbyen nga familjarët, u vranë e u zhdukën 376 shqiptarë, kryesisht nga zona e Rekës së Keqe, Junikut e disa fshatrave të komunës së Deçanit.

Dhe, çështja më e keqe në Mejë është se asnjë shqiptar nuk i mbijetoi asaj kasaphaneje. Po atë ditë, ndodhi edhe spastrimi më i madh etnik në ato hapësira, ndërsa të gjitha vendbanimet u dogjën në masë 90%. Ky vendim i Kuvendit, aso kohe shënoi aktin më të lartë të respektit dhe nderimit institucional e kolektiv për këtë kategori njerëzish, që janë dhunuar për së gjalli e për së vdekuri. Madje, duke iu zhdukur edhe kufomat. Ndërsa, edhe 13 vjet pas përfundimit të luftës, nuk janë gjetur mbi 1.500 të zhdukur, të gjithë njerëz dhe familjarë tonë.

Në qoftë se institucionalisht u mor vendim nderimi për ta, pse sot pas 13 vjetëve, pikërisht nga këto institucione, nuk ju bëhet ky nderim?

Të nderuar deputetë,

Si deputete e Kuvendit të Kosovës dhe për më tepër, si përfaqësuese e atyre familjeve në atë zonë, më 27 prill, si rrallë herë më parë kam qenë e shqetësuar dhe e tronditur. Njëkohësisht, nga mospërgjegjësia dhe injorimi institucional, që iu është bërë qindra familjarëve nga Reka e Keqe, komuna e Gjakovës dhe e gjithë Kosova.

Si mundet të ndodh kjo? A ka justifikim për të gjithë ata, të cilët e injoruan skajshmërisht, që familjarët e përjetuan atë ditë?

Kjo, në të vërtetë, është e pashpjegueshme! Ku ishin udhëheqësit institucional e shtetëror? Ku ishte presidentja dhe kryeministri i vendit? Apo, kishin punë e angazhim më parësorë!?

Të nderuar kolegë deputetë, a ka turp më të madh që në këtë mënyrë, kaq të ftohtë, të përbuzet gjaku i qindra e qindra shqiptarëve, mbi themelet e të cilit po ndërtohet liria dhe shteti i Kosovës?

Për fatin e keq, edhe kësaj radhe familjarët u ndanë të zhgënjyer nga mospërmbyshja e premtimeve qeveritare, posaçërisht premtimi i kryeministrit për ndërtimin e kompleksit memorial.

Ata vazhdojnë të pyesin: ku janë premtimet e Qeverisë? Do të pyesin edhe më 27 prill të vitit 2013 në Lëndinën e ndarjes së Pikëllimit. Çfarë do t'u themi tash një vit? Mos dhashtë zoti, që edhe pas 12 muajve të harrohen rrugët, që tradicionalisht çdo 27 prill do të çojnë në Mejë të Gjakovës!

Si pasojë e mospërgjegjësisë institucionale komuna e Gjakovës, ka ngelur e vetme për të bërë diç për këta martirë të nderuar, për ta nderuar sakrificën e tyre. Ka mbetur pa përkrahje shtetërore, në realizimin e projektit të premtuar për ngritjen e kompleksit memorial. Ndërtimi i këtij kompleksi memorial, i kësaj kujtese kombëtare është domosdoshmëri, mbase për

shumë arsye të panumërta, sepse, parandalimi i harresës sonë kolektive, historikisht na ka kushtuar shtrenjtë.

Dhe, krejt në fund, a mund të shpresojmë në përkrahjen dhe kontributin e udhëheqësve tanë shtetëror, të cilët në datat si kjo e 27 prillit, do të preferojnë gjithçka tjetër, përveç pjesëmarrjes së tyre në ditën e nderimit për martirët e Kosovës? Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka zoti Hoti, në kartelën e deputetes Albulena Haxhiu!

AFRIM HOTI: Falemnderit, kryesues!

Të pagjeturit, 13 vjet pas luftës së armatosur me okupatorët serb, nxisin dhembje, krenari dhe obligim. Dhembje, sepse po jetojmë pa ta. Krenari, sepse ishin promotorë dhe pjesë e historisë sonë të re e të lavdishme, por edhe obligim që të ndriçojmë fatin e 1.781 personave të pagjetur.

Barrë e veçantë për të gjithë ne duhet të jetë angazhimi i vazhdueshëm, për zbardhjen e fatit të të pagjeturve, sikundër i të gjithë atyre, që lirinë e Kosovës nuk e shohin të plotë, pa gjetjen e më të dashurve tanë.

Sot, nuk guxojmë të lejojmë të pagjeturit të mbesin peng të politikës ditore, ashtu siç mbetën gjatë konferencave 10-vjeçare, në të cilat Serbia fare nuk u detyrua të jap llogari për vrasjet e personaliteteve të shquara politike, vrasjen e mijëra qytetarëve e të mbesin madje edhe të pagjetur deri në ditët e sotme, pas 13 vjetësh.

A kanë bërë institucionet sa duhet dhe a po bëjmë sot, krejt çka është e mundur, që Serbia jo vetëm të dënojë krimet, por edhe të ndriçojë fatin e të pagjeturve? Jo, nuk është bërë sa duhet!

Mijëra familje sot, nuk e dinë ende të vërtetën e më të dashurve të vetë, por negociatorët me Serbinë duhet ta dinë se më e vlefshme është fati i të pagjeturve, se kalimi nëpër Serbi me leje apo me pasaportë.

Më e rëndësishme, për neve është që Instituti për hulumtimin e krimeve, të ngrejë padi ndaj kryerësve të krimit në Kosovë dhe identifikimin e veprimeve gjenocidiale të makinerisë vrastare serbe, jo vetëm gjatë vitit 1998-99, se sa të flitet për përmirësimin e jetës së disa qytetarëve, sepse të gjithëve nuk po u përmirësohet jeta, edhe po bisedohet me Serbinë.

Fati i të pagjeturve dhe ndëshkimi i kriminelëve serbë do të duhej të ishte prioriteti i parë. Fati i të pagjeturve të mos jetë në agjendë për sy e faqe, por pikë prej të cilës nuk lëvizet deri sa nuk zgjidhet. Porositësit dhe ekzekutorët e këtyre masakrave, të marrin dënimin e merituar. Pastaj mund të flasim për fqinjësi dhe kalimin e automjeteve me targa apo me "Proba".

Sot, Kosovës i mungojnë shumëçka, por më së shumti i mungojnë të pagjeturit, persona që nuk janë numra, nuk janë statistika. Pazari për fatin e tyre nuk guxon të bëhet, sepse ai mallkimi i lotëve tanë për më të dashurit e pagjetur do të bie mbi ta.

Ne nuk e kishim ndarjen me Serbinë çështje formale. Angazhimin tonë jetësor kundër okupatorit, nuk e kishim formal. Burgjet, torturat dhe lufta jonë çlirimtare nuk ishte formale, por jetike: Të jesh apo të mos jesh.

Sot nuk mund të flitet për takime formale. Të pagjeturit tanë nuk janë formal, por janë zemra e shpirti ynë që rreh në Kosovë e Shqipëri.

Dëshmorët e kombit, të pagjeturit dhe sakrifica e gjithë popullit janë themeli dhe janë ndërgjegjja jonë për shtet dhe bashkim, si kurrnjëherë më parë.

Është e qartë se të pagjeturit, si kapitull është kapitulli i vështirë i historisë sonë të re, por ky kapitull do të duhej të zgjidhej në fillim duke detyruar agresorin të deponojë emrat e atyre që komanduan torturën, vrasjen dhe zhdukjen e shqiptarëve me metodat më barbare.

Pa zgjidhjen e drejtë të këtij kapitulli, të gjitha të tjerat zgjidhje problemore shqiptaro-serbe do të jenë të pafuqishme për t'u përballur me problemin real shqiptaro-serb.

Ekzekutorët e krimeve serbe në Kosovë janë gjallë. Ata duhet të detyrohen të flasin.

Shpresojmë që Bashkimi Evropian të mos jetë e vështirë marrja e informatave për varrezat masive, për emrat e kriminelëve, shënimet për vendndodhjen e tyre!

Besojmë se kjo është shumë më e lehtë se dhënia e vizës së bashkëngjites së Serbisë me shtetet demokratike!

Absurditeti na shfaqet edhe kur të pagjeturit dhe varrezat masive bëhen çështje tenderësh. Argumentimi absurd i para disa ditëve ishte se nuk ka bagerë për gjermime. Dihet sa kushton ora e bagerit, por sa kushton ora e dhembjes sonë dhe e të gjithë familjarëve të të pagjeturve? Këto absurditete dikush ka përgjegjësi t'i ndalojë, jo për hir tonin, por për hir të atyre që nuk kanë dëshmorë e të pagjetur në familje, që të mos përsëritet historia që aq shpejt dikush po e harron. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Marinković!

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Poštovani poslanici,

Kada govorimo o kidnapovanim i nestalim na Kosovu, moramo biti veoma oprezni i moramo se sa vidnim poštovanjem, krajnje korektno prići ovoj temi i ne zaboraviti da su se za vreme sukoba na Kosovu desili neki događaji koji su svim zajednicama na Kosovu doneli velike patnje, koje neke od naših porodica još osećaju. Jer, znamo da sudbina žrtava rata, koje su kidnapovane i nestale, nisu još razjašnjene.

Skup okolnosti, koji daje težinu ovom problemu činiće ga pre svega političkim pitanjem, na unutrašnjem i spoljašnjem planu. Uticali su na opredeljenost, dinamiku i pristup ovom problemu kao skup svih faktora, ma s koje strane oni dolazili.

Političke aktivnosti na domaćoj političkoj sceni i tako međunarodnoj zajednici ne daju pozitivnu atmosferu, ne stvarajući uslove, koji su neophodni da bi se svi ratni zločini počinjeni nad civilnim stanovništvom rasvetlili, bez obzira na nacionalnu, versku ili bilo koju drugu pripadnost.

Poštovana gospodo poslanici,

Ne može postojati opravdanje za represiju, teror i ostale zločinačke aktivnosti, koje su se organizovano odigrali u vremenu koje je bilo za vreme sukoba i posle sukoba na Kosovu.

Ne može postojati nikakvo opravdanje za nemo posmatranje ekzodusa jednog naroda ili za poricanje svih ovih zbivanja uz upotrebu izmišljenih termina, koji su najblaže rečeno, neprimereni i veoma štetni.

Svojih žrtava se ne trebamo stideti, niti imamo pravo da se ne bavimo zločinima ili njihovim počinocima i istina i pravda ne mogu biti zadovoljeni na stavljanje tačke na slučajeve kada NN lice dobije svoje ime.

Okretanje glave u stranu čutanjem, nečinjenjem, čudnim tumačenjem zakona, subjektivnim i selektivnim pristupom, ne može se ništa značajno učiniti po ovom pitanju.

Žao mi je što od svojih kolega sada čujem da su oni selektirali žrtve i da govore samo o nestalim licima albanske nacionalnosti. Ja kao poslnik pokušavam da ih razumem, zašto tako govore. Ali, gospodo poslanici, nemojmo zaboraviti i druge žrtve nestale i kidnapovane, koje su isto žrtve samo s drugim imenom i prezimenom, i njih ne smemo zaboraviti. I dok se ovaj aporem ne reši, ne možemo krenuti dalje i naše društvo biće neiskreno, jer svaka žrtva mora imati svoje ime a svaki zločin mora se otkriti i počinioći kazniti. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Flora Brovina e ka fjalën!

FLORA BROVINA: I nderuari kryesues,

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Është e sata herë që mblidhemi dhe debatojmë për të zhdukurit dhe për të ardhur gati te i njëjti përfundim. Madje, edhe debati i nxitur nga kolegët e nacionalitetit, që duhet të kërkonin falje së pari, më nxit që të debatoj.

13 vjet më parë, më 27 prill 1999 në Mejë të Gjakovës u ekzekutuan 377 shqiptarë dhe trupat e tyre të pjetë u zhdukën.

Kjo nuk është masakra e parë dhe fatkeqësisht, as e vetmja gjatë periudhës shumë të shkurtër, që është 1998-99.

Unë nuk do t'i përmend me rend të gjitha masakrat. Le të përkujtojmë Qirezin, Lubeniqin, Shtuticën, Reçakun, Shtimjen, Therandën dhe Rahovecin e shumë e shumë vende tjera.

Gjithë kjo i përngjante dhe i përngjanë një Srebrenice, sepse u përdorën të gjitha metodat, të gjitha taktikat që së pari të ndahen burrat dhe gratë dhe pastaj të jepet vetëm një shteg, i cili çonte drejt Mejës. Dhe, forcat shtetërore serbe, e theksoj për shkak të disa debateve këtu, shtetërore institucionale serbe, ushtarake dhe policore, beretat e kuqe dhe civilët e maskuar, bashkëqytetarët, të cilët edhe mund të identifikoheshin nga të tjerët, udhëhoqën ekzekutimin. Këta civilë u ekzekutuan vetëm e vetëm pse i takonin një nacionaliteti tjetër.

Pas shumë vitesh këto kufoma do të gjenden në varreza të ndryshme. Madje, edhe shumica në Serbi. Të kujtojmë Peruçac dhe Batajnicën, ku u gjetën më shumë se 800 trupa të shqiptarëve të persekutuar e në mesin e të vrarëve, në mesin e tyre edhe persona që u persekutuan atje, u morën të gjallë dhe u persekutuan në Batajnicë në poligonin e ushtrimeve ushtarake të forcave famëkeqe serbe.

Është për të ardhur keq, që shumë çështje të pabëra nga Ushtria Çlirimtare dhe komandantët e saj, pa dëshmi dhe me insinuata të ngritura nga Serbia, synuan ta fshehin kriminelin e vërtetë dhe krimet e vërteta.

Për më tepër, këta kriminelë u përkisnin institucioneve shtetërore të Serbisë. Shteti serb heshti. Jo vetëm, që nuk kërkoi falje, por vazhdoi të ngre edhe akuza të pabaza.

Ka pyetje të pafund. Pse dhe si u arrit që në Serbi të arrijnë civilët e vrarë? Kush urdhëroi të hidhen kufomat në Danub? Kush hodhi acid mbi kufomat e ekzekutuara në varrezat masive, për t'u zhdukur identifikimi i tyre?

A është kjo e vërtetë? Po, është e vërtetë! Ekziston dokumenti zyrtar i ekshumimit në Batajnicë, ku për fat të keq Kosova ishte vetëm vëzhguese dhe a i kanë këto dokumentet institucionet tona, a i kanë kërkuar origjinalin e ekshumimit nga ekspertët ndërkombëtar? Dokumenti, së pari duhet të ishte dorëzuar në Kosovë dhe jo t'i dorëzohet Ministrisë së Drejtësisë së Serbisë. Janë shumë çështje thelbësore, që presin prej shumë vitesh për t'u zbardhë.

Natyrisht, zbardhja e fatit të tyre, përsheptimi i procesit të identifikimit të mbetjeve mortore, që janë disa qindra, presin që 13 vjet në morgun e Institutit mjeko-ligjor në Prishtinë. Dhe, kjo kërkon përsheptimin e zgjidhjes së çështjes.

Është kërkuar prej 13 vjetësh që të bëhet presion më i madh ndaj Beogradit, që të detyrohet për të zbardhë fatin e të pagjeturve. Kjo është edhe e drejtë ndërkombëtare.

Beogradi nuk është detyruar dhe nuk ka pasur presion të vazhdueshëm për këtë çështje.

Formimi i grupit të kontaktit në mes të Kosovës dhe Serbisë, në vitin 2004 nuk dha rezultat, sepse ekipet përzgjedhëse nuk ishin kompetente dhe jonjohëse të drejtave ndërkombëtare të njeriut.

A e meritojnë këta persona të rrëmbyer, të vrarë, të masakruar gjatë luftës, që për këta të bisedohet si për një çështje teknike, jo politike, jo kriminale, dhe jo si një çështje e gjenocidit ndaj një populli tjetër?

Aq më tepër, që kjo çështje ngrihet si një çështje e të drejtës së njeriut...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: A do me ta zgjatë edhe një minutë diskutimin, a qysh po ia bën? Një minutë ta jap! Një minutë e ke! Edhe një minutë, deputetes!

FLORA BROVINA: Falemnderit shumë!

Atëherë, aq më tepër, si mund të diskutohet për një çështje si për rrugët, si për vendkalimet, për diplomat, për lëvizjen e lirë ose këmbimin e mallit? Unë ndjehem shumë e prekur dhe kompetente kur flas për këtë çështje.

Them me bindje se qasja ndaj këtij problemi ka qenë e gabuar dhe nuk është respektuar dhe nuk është respektuar as Rezoluta e miratuar prej vitesh nga Kuvendi, dhe as dokumentet tjera. Si rrjedhojë e kësaj, kërkoj zbatimin e rezolutës dhe dokumenteve të nxjerra tjera në Kuvend.

Kërkoj respektimin e të drejtave të njeriut me një presion konkret, të shtuar të Qeverisë sonë dhe e ndërkombëtarëve ndaj Serbisë, për gjetjen e fatit të të zhdukurve.

Kërkoj ngritjen e akuzave për krime ndaj civilëve shqiptarë me qëllim të gjenocidit.

Kërkoj dokumentin origjinal të ekshumimit, që ndodhen në Ministrinë e Drejtësisë në Beograd, emrat e kryerësve të krimit, bartësve të kufomave dhe krimit të dyfishtë për zhdukjen e kufomave në crematorium në Batajnicë.

Kërkoj të di se sa Batajnica tjera i fsheh Serbia. Ku janë 1781 qytetarë tanë që nga 13 maji.

Zbardhja e fatit të zhdukurve është e lidhur drejtpërdrejt me 13 vjet pas luftës me pranimin e së vërtetës për ne por edhe për popullin serb, për të ardhmen dhe fqinjësinë tonë. Kjo është e lidhur me dialogun për paqe në rajon. Të vërtetat duhet të thuhën dhe të mos mbeten peng, dhe vetëm kështu mund të ndërtohet paqja.

Krimi nuk vjetrohet dhe as dhimbja dhe malli për ta pagjeturit.

KRYESUESI: Falemnderit!

Besoj se sekretaria do ta ketë parasysh, që të jetë në procesverbal. Fjalën e ka deputetja Sahatqija!

TEUTA SAHATÇIA: Zoti nënkryetar,

Deputetë të nderuar,

Shumë të nderuar familjarë të personave të zhdukur,

Ky nuk është debati i parë, të cilin po e bëjmë në Kuvendin e Kosovës. Është njëri prej debateve të radhës, po fatkeqësisht është debat në të cilin ende, pas 13 vjetësh, nuk kemi

gjetur zgjidhje adekuate dhe familjarët sot e kësaj dite, ende ballafaqohen me mungesa të informimit për familjarët e tyre.

27 prilli, apo Meja e Gjakovës simbolizon ditën e personave të zhdukur, apo personave të pagjetur të Kosovës. Personat, të cilët nuk i takojnë vetëm Mejës, ndonëse në Mejë ishte një numër shumë i madh, më i madhi i masakrës së organizuar nga forcat e organizuara, të shtetit të Serbisë.

Në këtë “Lëndinën e lotëve” janë varrezat, të cilat çdo vit i vizitojmë. Në ato varreza janë personat e çdo moshe, të çdo gjinie, të çdo feje, se bashku. Dhe, emëruesi i tyre i përbashkët ishte se të gjithë ata ishin shqiptarë.

Po, Meja dhe dita e të zhdukurve është në fakt ditë e cila i simbolizon të gjithë të zhdukurit, të gjithë të pagjeturit, të gjithë viktimat, të cilat janë shkak i luftës në Kosovë!

Në Mejë, më 27 prill u vu gurthemeli i një memorialit përkujtimor. Dhe, meja sërish i tuboi familjarët, i tuboi qytetarët, por nuk i tuboi pushtetarët.

Kryeministri dhe 6 zëvendëskryeministra, një grumbull i madh i ministrave munguan. Aty, me mungesën e tyre treguan që zgjedhjet komunale në Ferizaj dhe të gjitha çështjet tjera teknike dhe joteknike, janë shumë më të rëndësishme, se sa dërgimi i një personi, i cili tregon institucionin, i cili ka një pozitë në Qeveri, që t’u drejtohet aty familjarëve.

Sot e 13 vjet pas lufte, familjarët nuk kanë nevojë për lot, nuk kanë nevojë për mëshirë, nuk kanë nevojë për fjalë të dhembshme.

Ata kanë nevojë për përgjigje. Ata kanë nevojë për drejtësi. Ata kanë nevojë për dinjitet. Ata kanë nevojë për zgjidhje, zgjidhje të mirëfilltë, zgjidhje institucionale, përkrahje institucionale.

Dialogu me Serbinë ishte një rast shumë i përshtatshëm, që kjo çështje e cila ka ngecur dhe e cila ende dhe pas 13 vitesh nuk ka gjetur zgjidhje, që të kushtëzohet me një zgjidhje të mirëfilltë.

Duke pas parasysh, që Serbia e cila ka shumë informata, e cila e ka atë hierarkinë, në bazë të së cilës edhe janë bërë këto krime, që të kërkohen informata për të pagjeturit dhe që kjo të bëhet në mënyrë të planifikuar. Dialogu e huqi këtë mundësi shumë të mirë, për të zgjidhë këtë çështje.

Dua t’u bashkohem të gjithë kolegëve të mi, të cilët thanë që gjetja e informatave, përgjigjja apo zgjedhja është një e drejtë njerëzore e familjarëve. Është një e drejtë që ata të dinë, por është gjithsesi edhe kërkesë, që Bashkësia Ndërkombëtare e cila është e involvuar prej fillimit në çfarëdo bashkëpunimi, që të bëjë trysni në Serbi dhe në të gjitha instancat relevante, të cilat kanë mundësi që të bëjnë zgjidhje, që të tregojnë informata dhe t’u bëjnë të mundshme familjarëve që të gjejnë përgjigje.

I bashkohem kërkesës për respektimin e të gjitha dokumenteve të Kuvendit dhe dua të përfundoj me atë, që këto kujtime duhet të mbahen, që të mos harrohen, sepse atëherë ku harrohen, rrezikon që të përsëritet e njëjta, gjithmonë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja Albana Gashi!

ALBANA GASHI: Falemnderit, kryesues!

Gjatë periudhës së luftës, në vitet 1998-1999, në Kosovë forcat serbe vranë rreth 12.000 shqiptarë e mijëra të tjerë i zhdukën.

Menjëherë pas luftës kanë rezultuar më se 5.000 persona të zhdukur, ku edhe tash pas 13 vjetësh nuk dihet asgjë për rreth 1.781 të tjerë. Të pagjeturit nuk kanë qenë asnjëherë prioritet i institucioneve të vendit. Janë kthyer aq sa ka dashur Serbia, nga se kurrë nuk është bërë presion nga institucionet e vendit, për kthimin e tyre.

Qeveria hyri në negociata pa kushte për Serbinë. Dhe, njëra nga këto kushte duhet të ishte edhe çështja e të pagjeturve.

Pasi që Qeveria e Kosovës pranoi të shkonte në këto negociata pa asnjë kusht, atëherë është e kuptueshme se interesi i Serbisë nuk është çështja e të pagjeturve, duke e ditur se Serbia është ajo që e ka caktuar agjendën e bisedimeve.

Qeveria e Kosovës është angazhuar, që tema kryesore gjatë këtyre negociatave të jenë ato që ia kanë ndihmuar Serbisë integrimin në BE. Këtë e ka pohuar edhe vetë njëra nga këshilltaret e Edita Tahirit, në dhjetor të vitit të kaluar, se çështja e të pagjeturve do të diskutohet, por për shkak të agjendës së ngjeshur dhe rrjedhave të marrëveshjeve tjera të arritura, nuk është diskutuar dhe se kjo temë do të diskutohet vitin e ardhshëm e që i bie këtë vit e që është në kundërshtim me atë, se çfarë na thotë neve Edita Tahiri.

Kjo tregon se sa të relaksuar janë dhe sa vullnet kanë institucionet e vendit, në lidhje me zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.

Fati i tyre nuk do të zbardhet me këtë Qeveri. Kjo Qeveri ka kohë që na thotë se kjo është njëra prej prioriteteve të saj dhe nëse çështjet që janë me prioritet, kjo Qeveri nuk ia arrin t'i zgjidhë me vite të tëra, paramendoni se si do t'i zgjidhë ato që nuk i ka në agjendën e prioriteteve.

Në bisedimet me Serbinë kjo Qeveri, çdo ditë e më shumë, po i pranon kompromiset dhe këto kompromise çdo ditë e më shumë po i hapin rrugë kompromiseve të reja, natyrisht të dëmshme për Kosovën.

Dhe, duke pranuar kompromise, që janë në dëm të interesave të vendit, nuk kanë se si ta zgjidhin çështjen e të pagjeturve. Pra, nuk mund ta zgjidhin çështjen e të pagjeturve ata që janë vetë problemi i Kosovës. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja Kostiq!

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem gospodine predsedavajući!

Poštovani,

Kao što znamo da je rat za nama, znamo da svaki rat za sobom nosi posledice i žrtve. Ono što je najteže za svaku porodicu jeste gubitak njihovih najmilijih, ali je još teže onima koji još uvek ne znaju sudbinu svojih članova porodice. Ne znaju gde su i da li su uopšte živi. Bez obzira na sve, svako od njih zaslužuje da zna o sudbini svojih najmilijih ili u još gorem slučaju da preuzmu posmrtnu ostatku i sahrane ih onako kako dolikuje svakoj osobi današnjeg civilizovanog društva.

Nezavisno na boju, rasu, jezik kojim govori pojedinac, nezavisno na versku pripadnost, ja osuđujem takav način ratovanja i postupanja. Ne trebamo ovde voditi diskusiju o tome da se samo jedna strana osuđuje. U ovom slučaju Srbi i Srbija i baviti se pretpostavkama i nagađanjima gde sve postoje masovne grobnice i da li ih pojedinci kriju.

Ne, gospodo! Na osnovu mnogih izveštaja, i UNMIK-a i EULEX-a i izveštaja drugih međunarodnim organizacija i njihovih predstavnika, koji se bave ovim jako osetljivim i bolnim pitanjima u svim tim izveštajima stoji da se mahom rasvetljuju sudbine Albanaca i pripadnika ne srpske zajednice.

Dakle, drage kolege narodni poslanici, to meni govori da se ovde očigledno kriju tela Srba, jer se najmanje njihove sudbine rasvetljuju.

Možda bismo trebali tela nestalih Srba potražiti u nekim drugim zemljama u regionu i iste te zemlje pospešiti na saradnju.

Znamo da je ekshumacija i identifikacija posmrtnih ostataka jako složen proces i da predstavnici EULEX-a rade na tom polju već duže vreme, sa manje ili više postignutim rezultatima. Imajući u vidu kompleksnost i otežavajuće okolnosti, a samim tim tehničke i finansijske probleme, ne smemo zaboraviti da se još uvek u mrtvačnicama u Prištini nalaze tela ili delovi tela, koji još uvek nisu identifikovani, a to izaziva veliku zabrinutost, kako kod građana, tako i kod članova porodice.

Sveukupno, možemo reći da je postignut delimično mešoviti napredak u ovoj oblasti. Potrebna je veća posvećenost za pronalazak nestalih lica. Uz potporu tehničkih i finansijskih resursa, koje bi trebali obezbediti kao i adekvatno angažovanje.

Ako se ova pitanja ne reše adekvatno, ona će izazivati oslojađenost, ometaće pomirenje i negativno će uticati na opštu političku klimu na Kosovu.

Najpre treba uložiti mnogo veće napore da se sudbina osoba, koji se vode kao nestali rasvetli i da se počinioци istih kazne i izvedu pred lice pravde.

Apelujem da se međunarodna zajednica, Priština kao i Beograd češće sastaju i razgovaraju o ovim pitanjima, kako bi se sudbine nestalih rasvetlile, i jedni i drugi moraju uložiti napore da

se nestali pronadū a sločinci izvedu pred licem pravde i kazne na adekvatan način, kako zaslužuju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Halit Krasniqi!

HALIT KRASNIQI: Falemnderit, kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë

Shumë të respektuar familjarë të të pagjeturve, që neve tani e kemi bërë praktikë t'i quajmë të tillë, përndryshe ata i perceptojmë, i përjetojmë të rrëmbyer, deri tani të pagjetur dhe kështu do t'i trajtojmë dhe do t'i përjetojmë derisa të paraqitet ndonjë shenjë, kudo qoftë dhe sidoqoftë. Është një kapitull shumë i dhimbshëm, që jemi duke trajtuar, i zhvillimeve tona dhe i historisë sonë të dhimbshme.

Ky kapitull, secilin prej nesh e rëndon, e prek dhe e thimthon, varësisht a ka ndonjë të afërm apo jo, por shumica e të pranishmëve këtu kanë nga një familjar e më shumë të tillë që i kanë të rrëmbyer dhe i kanë të zhdukur, që ne tani i quajmë të pagjetur.

Nuk do të shtoja më shumë se sa prej shumë atyre fjalëve që i dëgjuam para meje, por e kisha të vështirë të mos paraqitesha për fjalë, sepse po të isha unë i zhdukur apo ndonjëri prej jush dhe Ukshin Hoti këtu, sigurisht që këtu nuk do të mund të kalonte pa e ngritë zërin e tij buçitës në këtë sallë dhe deri në institucionet ndërkombëtare, që do të duhej të dëgjonin zërin e dhimbshëm të këtij vendi dhe të këtij populli.

Po të ishim ndonjëri prej nesh të zhdukur, të rrëmbyer dhe Xhavit Haziri të ishte këtu deputet, që krejt, krejt lehtë do të mund të zgjidhej, po të mos ishte i rrëmbyer, nuk do të mund të kalonte kjo temë, pa e trajtuar ai me zërin e tij buçitës dhe me gjithë shpirtin e tij militant.

Po të ishim ndonjëri prej nesh të zhdukur këtu dhe në vendin tonë të ishte doktor Hafir Shala, sigurisht se nuk do të mund të kalonte kjo temë pa e trajtuar me përkushtimin e merituar, që do të duhej ta trajtonim këtë temë.

Për hir të asaj që neve e kemi vlerësuar të parin magjistër Ukshin Hotin si një euridit popullor, si një euridit të mishëruar me fatin tragjik të këtij populli dhe me synimet e këtij vendi dhe të këtij populli, gjithashtu edhe me rolin e militantit dhe tribunit vizionar të Xhavit Hazirit, i cili gjithashtu në fillim të viteve të 90-ta ka mbajtur kontakte me organizimin ilegal dhe legal dhe është munduar këto forma t'i kombinojë dhe t'i koordinojë me përkushtim të jashtëzakonshëm.

Dhe doktori Hafir Shala, i cili ishte një militant i burgjeve dhe një koordinator i organizimit, që nga frontet e luftës në Drenicë e deri te institucionet legale.....

...kanë funksionuar në Kosovë dhe të tjerë familjarë, tani që mund të përmendim, por që mund të hymë në hak ndonjërit prej tyre, sepse secili prej tyre ka qenë, ka luajtur dhe ka pasur një rol të veçantë, prej familjes e deri te organizimi i përgjithshëm. Me pak fjalë, ky kapitull i dhimbshëm do të duhej të trajtohej në mënyrë institucionale dhe të ngritej ky shqetësim, jo në emër të familjeve, por në emër të këtij vendi dhe këtij populli që të marrë një trajtim të merituar në çdo kontakt tonin me ndërkombëtarët dhe në çdo kontakt me institucionet relevante që kanë shënime, që kanë qasje në arkiva dhe që i dinë se ku ndodhen tani këta të rrëmbyer dhe të zhdukur deri tani. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuara familje të zhdukurve nga e gjithë Kosova,

Ju përshëndes në radhë të parë juve,

Të nderuar deputetë,

Në mars të vitit 2011, më shumë se para një viti, Lidhja Demokratike e Kosovës kërkoi që zbardhja e fatit të zhdukurve, ndër të tjera, të jetë parakusht për fillimin e dialogut Kosovë – Serbi.

Kjo kërkesë u injorua, sepse dialogu tashmë kishte filluar. Kjo kërkesë po vazhdon të injorohet edhe sot. Kjo kërkesë nuk është vetëm e Lidhjes Demokratike të Kosovës, është kërkesë e gjithë qytetarëve, në veçanti familjarëve të afër 2.000 të zhdukurve. Pse kjo kërkesë u injorua në tërësi dëshmon edhe raporti i kryenegociatores Edita Tahiri, i datës 16 shkurt 2011, një ditë para se shteti i ri i Kosovës të mbushte katër vjet, ajo raportoi në Bruksel se marrëveshjet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk po respektohen dhe zbatohen nga Serbia. Madje, po ashtu, raportoi se të vetmet çështje të pazgjidhura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë: bashkëpunimi rajonal, energjia dhe telekom.

Pra, sipas Qeverisë së Kosovës, çështja e të zhdukurve, fati i tyre, zbardhja e fatit të tyre dhe marrja e informatave nga Serbia për vendndodhjen e tyre nuk është çështje as në këtë agjendë, nuk është çështje që duhet të zgjidhet ndërmjet të Kosovës dhe Serbisë. Kryenegociatorja Tahiri raportoi edhe para një komisioni të Kuvendit, Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe për Personat e Zhdukur. Para këtij komisioni ajo tha që ka marrë të gjitha informatat e duhura nga institucionet qeveritare lidhur me fatin e të zhdukurve, lidhur me numrin e tyre, lidhur me vendet ky dyshohen të jenë varrezat.

Megjithatë, asnjëherë këto informata të mbledhura nga institucionet e Kosovës nuk janë paraqitur në Bruksel, asnjëherë nga institucionet e Kosovës nuk është kërkuar asnjë informatë e vetme nga Serbia, as nuk është vënë parakusht në fillim të dialogut dhe nuk ka qenë kurrë prioritet për këtë Qeveri. Kjo është dëshmuar edhe nga fjalimet çdo tre muaj të ministrit të Jashtëm, Enver Hoxhaj, në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ne po flasim këtu se po mungon trysnia ndërkombëtare. Trysnia ndërkombëtare mbi Serbinë, të nderuar deputetë, nuk do të bëhet në qoftë se ne nuk e kërkojmë vetë atë kurrë. Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, vendi, qendra ku do duhej të bëhen kërkesat në emër të Republikës së Kosovës, është vendi ku asnjëherë nga Ministria e Punëve të Jashtme nuk

është përmendur që Kosovës i mungojnë afër 2.000 njerëz, pa marrë parasysh cilit nacionalitet i takojnë ata. Asnjëherë, nuk është përmendur.

Për më tepër, kjo është dëshmuar edhe njëherë nga mospjesëmarrja e përfaqësuesve institucional në MEI dhe mos lëshimi i deklaratave për Ditën Ndërkombëtare të Zhdukurve. Besoj, që institucionet e Kosovës do të kishin mund të marrin mësim nga vendet më demokratike në botë të cilat edhe pse kanë nga 5 apo 10 të zhdukur nga Lufta e Dytë Botërore, çdo vit deklarohen në Ditën Ndërkombëtare të Zhdukurve për ata njerëz që i kanë të zhdukur nga Lufta e Dytë Botërore. Kjo tregon harresën e plotë institucionale dhe mungesën e ndërgjegjes institucionale lidhur me këtë çështje.

Të nderuar deputetë,

Konventa e Gjenevës nr. 3, që është pjesë e të drejtës ndërkombëtare humanitare, karakterizon mbajtjen peng të zhdukurve si krim lufte. Përderisa Kosovës i mungojnë 2.000 njerëz, kjo nënkupton që sipas çdo interpretimit të drejtës ndërkombëtare, Serbia ende vazhdon të kryejë krim lufte ndaj Kosovës. Do të thotë, është një krim i vazhdueshëm që ende nuk ka përfunduar dhe pikërisht nga ky shtet me të cilin Kosova është ulur në tavolinë dhe po bisedon nuk është kërkuar kurrë përgjigje dhe nuk është kërkuar kurrë kërkim falje për këtë krim.

Ne kemi miratuar në Kuvend një ligj i cili, ndër të tjera, potencon qysh në nenin 1 të drejtën e familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur. Dhe, po ashtu në nenin 10 thuhet që Qeveria duhet të përkrahë çdo iniciativë nga këto shoqata që ka të bëjë me personat e zhdukur duke raportuar publikisht për rezultatet e gjetjeve të tij. Fatkeqësisht kjo nuk është bërë ashtu siç kërkohet me ligj dhe kjo nuk është bërë ashtu siç e kemi kërkuar në këtë Kuvend dhe do ta kërkojmë edhe sot. Një shembull po e përmend edhe sot, në muajin tetor të vitit 2011, në hapësirën e ish- kazermave serbe në Mitrovicë është hasur në mbetje mortore të panjohura. 55 mbetjet mortore të zbuluara në lokacionin afër kazermës serbe, ku tani janë spitalet e Mitrovicës, janë rivendosur në varrezat e dëshmorëve të qytetit të Mitrovicës. Që nga tetori i vitit 2011 e deri më sot, përkundër adresimit të shumë kërkesave të institucioneve qeveritare, këto mbetje mortore nuk janë zhvarrosur me qëllim të identifikimit. Një kërkesë e tillë i është ri adresuar me shkrim Qeverisë edhe në prill të këtij viti.

Fatkeqësisht janë edhe dhjetë varreza të tilla në qytetin e Mitrovicës, disa prej tyre në veri, që kanë filluar eksumimi dhe kanë mbetur në gjysmë. Prandaj i bëj thirrje edhe njëherë Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur që ta përfundojë punën e vetë, që të ekzistojë një mbështetje shumë më substanciale për të gjitha institucionet që duhet të përfundojnë obligimet që dalin nga ky ligj. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Falemnderit!

I nderuar kryesues i seancës dhe nënkryetar i Kuvendit,

Zonja e zotërinj deputetë,

I nderuar ministër,

Janë disa tema që nuk durojnë shumë fjalë, që imponojnë edhe një ton të përmbajtur, që imponojnë edhe një gjuhë integruese.

Mendoj që nuk e durojnë edhe drejtimin e gishtave nga njëri-tjetri. Sa herë hyjmë në Kuvend nga hyrja kryesore, përballemi me sy që jo vetëm na shikojnë, por na flasin, pyesin, kërkojnë, na obligojnë dhe janë të gjitha regjioneve, janë të gjitha feve, të gjitha moshave, të gjitha kombësive, janë të gjitha partive politike. S'mund t'i ndajmë me asnjë kriter partikularist. Duhet t'i trajtojmë ashtu siç janë, si një dhembje të madhe gjithë këtij nën qielli. Mijëra familje janë peng të kësaj dhembje, një popull i tërë praktikisht është peng dhe për më tepër peng janë edhe vetë proceset, peng është edhe procesi i paqe ndërtimit, i pajtimit dhe i normalizimit të përgjithshëm në Kosovë.

Mendoj që duhet edhe ta trajtojmë ashtu, e nuk e kemi trajtuar. Po vazhdon të injorohet ky problem, po dëshmohej përsëri ajo se kur është një-dy janë raste, por kur bëhen me qindra-mijëra, atëherë kthehen në statistikë dhe është fjala për mijëra qytetarë civilë, fëmijë, gra e pleq që s'duhet ta lënë indiferent askënd, bash askënd. Çka do të ndodhte gjetiu në vendet e tjera, të cilat jemi të prirë t'i quajmë të "qytetëruara", po të zhdukeshin 2-3 veta. Do të tundej jo vetëm ai vend, por bota dhe do të bëhej një derman. Dhjetëra vjet ne s'kemi përgjigje për fatin, për të vërtetën. E në mesin e tyre siç u tha janë figura të shquara, si: Ukshin Hoti, Xhavit Haziri, Hafir Shala, po janë edhe të tjerë që janë vrarë e janë gjetur trupat, por bëjnë pjesë në këto kategori, si: Fehmi Agani, profesor Latif Berisha, Bardhyl Qausi, Esat Bicurri e sa e sa tjerë.

S'mund të mos i bashkojmë dhembjet për ta. Dhe, e shoh edhe në tekstin e propozuar një ngurrim për ta cilësuar ashtu siç është. Në çdo kriter ajo që ka ndodhur në Kosovë është gjenocid dhe duhet trajtuar si e tillë. Për fat të keq mungon gatishmëria, sidomos në Beograd për ta trajtuar ashtu siç duhet. Kur ishte në pyetje Bosnja u mbledh pak fuqi dhe u kërkuar një falje e druajtur pa e cilësuar si duhet, po për Kosovën një trajtim tjetër dhe merreni me mend, formalisht i konsiderojnë qytetarë të vetët, e si është tash kjo që qytetarët që i konsideruakan të vetët të injorohen që janë zhdukur, masakruar, varrosur, rivarrosur mijëra të tjerë. Unë nuk dua të bie në grackën e ndarjes së të zhdukurve në baza etnike dhe mendoj që ky Kuvend nuk e ka bërë atë gabim asnjëherë. Është e njëjta dhembje, pavarësisht nga përkatësia kombëtare dhe mendoj që të zhdukurit, të pagjeturit, të masakruarit duhen të trajtohen të gjithë ashtu siç janë edhe ata të gjithë janë bijë nënash, por për të gjithë përgjegjësia megjithatë s'mund edhe të shpërndahet e të avullohet, është megjithatë, shtetërore. Në rezolutën që ky Kuvend ka miratuar vite më parë për Srebrenicën është thënë shkoqur se përgjegjësia i përket shtetit të Serbisë, jo vetëm individëve dhe zinxhirit komandues, atyre po se po, por mbi gjitha shtetit të Serbisë, sepse ka qenë një gjenocid i institucionalizuar, sistematik, i planifikuar dhe për më tepër i strukturuar dhe me evidenca. Kështu që, ekzistojnë informacionet, nuk është vetëm ajo që ndodh nëpër trazira, luftëra etj. ku humbin edhe njerëz pa gjurmë. Këta nuk kanë humbur pa gjurmë, janë gjurmët, puna është që fshihen, sepse janë rivarrosur, janë ri masakruar dhe pa statistika nuk janë bërë ato.

Unë prandaj edhe insisto që në rezolutë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Falemnderit!

Fjalën e ka deputeti Sali Asallanaj.

SALI ASLLANAJ: Falemnderit, nënkryetar!

Përsëritet, ministër,

Kolegë të nderuar deputetë,

Më lejoni që t'i them disa fjali lidhur me këtë temë dhe së pari të konstatoj që nuk kanë munguar fjalët që 13 vjet, në asnjë mënyrë, prej të gjitha organeve në Kosovë, gjithmonë kemi pasur komisione, që nga niveli komunal, asociioni i komunave, komision qeveritar, shoqatat të familjarëve të pagjeturve dhe realisht rezultatet shikuar në përgjithësi janë minimale.

Çka mund të bëjmë më tepër? Unë po shoh këtu këto rekomandimet që kanë nxjerrë Komisioni funksional, që i ka propozuar, unë mendoj që vërtet janë rekomandime shumë të përgjithësuara, të cilat nuk kanë ndonjë mekanizëm matës, a po realizohen apo s'realizohen. Dhe, këtë aspekt unë do ta kisha formuluar me një pikë të vetme, s'ka nevojë t'i kemi 5 pika, por vetëm me një që objektivisht aty ku kemi mundësi, Qeveria ta ketë prioritet numër një dhe kushtëzim numër një. Nëse do të duhej t'i shtensionojmë raportet me Serbinë le të jetë kjo dera e shtensionimit të raporteve. Ju lutem, nuk ka shumë nevojë për politizim të kësaj gjëje, por vullneti i mirë i shtensionimit të raporteve kishte për të shkuar realisht nëpërmjet gjetjeve të personave të pagjetur.

Unë mendoj që ka mekanizëm. Një prej atyre kryesorëve e kemi lëshuar nga duart, sepse iku, i mbajtëm bisedimet, të cilat kanë qenë totalisht të përgatitura dhe vërejtjet e LDK-së pikërisht kanë qenë ndër këtë parim që t'i përgatisim mirë, të dimë si po hyjmë, me çfarë platforme dhe si po dalim nga ato bisedime. U pa se kanë shkuar jashtëzakonisht keq dhe në fund po dëshmohej që kanë qenë bisedime të tilla, të cilat në rastin e pagjeturve sikur janë kënaqur me një psherëtimë të lehtë që kanë bërë në ato bisedime. Por, kurrfarë kushtëzimi dhe kurrfarë fuqizimi të një çështjeje, e cila është e shenjtë për çdo qytetar.

Nuk është kërkesë e madhe e këtyre familjarëve të pagjetur, që po kërkojnë të dinë ku i kanë t'i varrosin më të dashurit e tyre. Unë mendoj që frustrimi i tyre, kenë pasur ju të gjithë rast ta shihni edhe në bisedat direkte, por edhe tash së fundi në komisionin qeveritar kur një familjar në mënyrë tepër të frustruar reagoi nga komisioni qeveritar. Janë frustrime të njerëzve, të cilët objektivisht u ka ardhur durimi në fund. Në këtë aspekt, unë e kisha lutur Qeverinë që të bëjë maksimumin që ta ketë në prioritet pikërisht këtë çështje, sepse ndërgjegjja jonë realisht është në pyetje pikërisht te këta njerëz, të cilët tani e 13 vjet nuk po gjenden. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Vesna Mikić.

VESNA MIKIĆ: Hvala lepo, gospodine predsjedavajući!

Uvaženi poslanici, dame i gospodo,

Duboko se osećam sa porodicama koji su izgubili svoje najmilije u vihoru rata, te sudbine do dana današnjeg nisu rasvetljene. Svesna sam toga da svako novo otvaranje ove teme je ništa drugo do iznova i novo preživljavanje bola, tuge i žalosti.

No, bez obzira na težinu ovog problema, mislim da je činjenica očigledna, jer postoji opšti nedostatak političke volje da se uvaži tragična stvarnost na Kosovu, a ta stvarnost je gospodo da žrtava bilo i sa jedne i sa druge strane, da je kidnapovanih, otetih i masakriranih bilo i iz srpske zajednice, ali da je najlepše u ovom trenutku prebaciti teret samo na jednu stranu.

Svi smo svesni toga da je za sukob potrebne dve strane. To se i dogodilo u tom periodu na teritoriji Kosovo i Metohije. Prva masovna kidnapovanja lica iz srpske zajednice, srpske nacionalnosti, su zabeležena 98 godine, juna meseca, kada je kidnapovana grupa beladževskih rudara, čiji se trag izgubio, o čiju se sudbinu izgubio ne zna do dana današnjeg. Ukupna cifra nestalih Srba se svela na 1300 lica, međutim ne verujem da je to pouzdani podatak.

Nezadovoljstvo srpske zajednice veliko povodom ovog problema i nije usmereno samo ka Vladi Kosova, već je usmereno i ka međunarodnoj zajednici, koja za sve ove godine nije učinila ništa, a takođe mogu slobodno reći da ne čini još uvek ništa po pitanju rešavanju ovog problema. Čak su u nekim momentima stiče utisak da želi da spreči da se do istine dođe.

98 godine je i međunarodna zajednica i velike sile sa zapada i Evropska Unija dobro znala, jer i dokazano postojanja tajnih logora i zatvora gde su se odvodile žrtve drugih nacionalnih manjina, pogotovu i srpske zajednice. Ali se u to vreme čutalo, i ne znam iz kojih razloga se tada nisu te lokacije obelodanile, i ne znam zašto tada nije istraženo do kraja i nije obavljen pretres, kako bi se kidnapovani oslobodili, a počinioči izašli pred licem pravde.

Nažalost, izgleda da srpske žrtve nisu imale jak lobi da bi nekoga zainteresovale. Ispada da je za problem nestalih najstrože je čuvana tajna do prošle godine, i kamen spoticanje ne samo vlasti, već i međunarodne zajednice.

Gospodo, za nekoga je možda ovaj problem teret prošlosti, možda za nekoga ovo bio jedini način da se dođe na vlast, ali za ozalošćene porodice je za ovo sadašnjost i biće budućnost, sve dok počinioči ne iznesu i ne obelodane njihova imena.

Ja ću navesti samo jedan primer iz mesta iz kojeg dolazim. Kidnapovan je dečko 20 godina, koji je verovao u bolju budućnost, koji je kidnapovan samo zbog što je bio policajac. Odveden je na nepoznatom pravcu, da bi posle godinu dana njegova porodica dobio audio zapis da je kidnapovala Oslobođilačka Vojska Kosova. Taj audio zapis još uvek stoji kod porodice. Ja ću ovom prilikom da apelujem na međunarodnu zajednicu, na Vladu Kosova i na sve dobronamerne ljude, ako išta znaju o sudbinu nestalima da jave njihovim porodicama. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë besoj që edhe ju duhet t'i bashkoheni kërkesës sonë dhe ta mbështetim që të gjenden të gjithë, por fajtori për të gjitha këto dihet kush është. Gabime mund të jenë bërë nga të gjitha palët. Fjalën e ka deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Falemnderit, i nderuar zoti kryesues!

Kosova doli nga lufta me rreth 6.000 të zhdukur, ndërsa edhe 13 vjet më pas fati i 1.781 vetave mbetet i paqartë, pjesa më e madhe e të cilëve janë përkatësisë kombëtare shqiptare. Që nga pranvera e vitit 2004, Prishtina dhe Beogradi kanë zhvilluar disa takime të ndërmjetësuar nga komuniteti i Kryqit të Kuq për këtë çështje.

Por, rezultatet janë ende të pakta. Grupet punuese të Kosovës dhe të Serbisë thonë se gjatë këtij viti do të zhvillohen kërkime në 36 vende të ndryshme, ku mendohet se mund të ketë trupa të të zhdukurve. Plaga e familjarëve, të cilët ende i kërkojnë të afërmit e tyre është e hapur, dhe kjo krijon pezëm e dhimbje të vazhdueshme. Edhe më tej vajtohet nëpër shumë shtëpi nga nënat, nga fëmijët që po rriten pa prindër. Institucionet e Kosovës duhet ta japin maksimumin e tyre për ta përmbyllur këtë plagë familjare dhe t'u lejohet trupave të prehen të qetë në vendin e tyre. Në fund të fundit, kjo është një e drejtë hyjnore.

Po ashtu, bëj thirrje që trajtimi i familjeve, që i kanë të afërmit e tyre të zhdukur, të jetë më i posaçëm. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar, nënkryetar i Kuvendit!

Zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim që debati për fatin e të pagjeturve është një debat, sa emocional, aq i dhimbshëm, dhe një debat në të cilin prej nesh kërkohet që vërtet të jemi të sinqertë, sepse familjarëve të të pagjeturve nuk u kanë munguar deri më tani premtimet, nuk u kanë munguar as fjalët e mira, nuk u kanë munguar as zotimet, edhe vendore, edhe ndërkombëtare, se do të bëhet diçka, por u kanë munguar rezultatet konkrete.

Dhe, s'ka dilemë se kjo është çështja më e dhembshme e Kosovës së pasluftës dhe s'ka dilemë se kjo është një nga çështjet tipike humanitare që ka marrë dimensione politike dhe po vazhdon të trajtohet me kriteret politike, edhe pse në shoqëritë e pasluftës kjo çështje rregullohet, qoftë me një aneks të veçantë, qoftë me politika humanitare. Fati i të pagjeturve, apo personave të zhdukur është një temë, e cila në asnjë rast nuk do të duhej të jetë pjesë e agjendave politike. Kjo çështje duhet ta prekë ndërgjegjen e të gjithë neve në periudhën e pasluftës dhe është një problem që i ka përcjellë pothuajse të gjitha qeveritë dhe të gjitha legjislaturat e pasluftës.

Ne duhet të jemi realë dhe racionalë, të shohim çfarë mund të bëjmë konkretisht. Jo të miratojmë për çdo vit nga një rezolutë, apo të japim nga një premtim, por të bëhemi të sinqertë dhe të tregojmë se ku është problemi i vërtetë. Dhe, s'ka dilemë që problemi i vërtetë është aty ku mund të adresohet shumë lehtë nga të gjithë, sepse ne e dimë që Serbia këtë çështje e ka lënë me qëllim të pazgjidhur dhe me qëllim e përdor edhe për qëllime politike. Unë mendoj që kjo çështje duhet të shtrohet në dy rrafsh kryesore: e para, duhet të shtrohet në rrafshin nacional vendor dhe unë përkrah plotësisht projekt-konkluzionet që janë propozuar për këtë seancë, sidomos konkluzionin e fundit, kur angazhohemi që ta kemi një

strategji shtetërore për fatin e të pagjeturve, e cila tani duhet ta ketë edhe një plan konkret operativ, ku duhet të përshkruhen obligimet konkrete të të gjitha institucioneve të Kosovës në drejtim të zbardhjes së fatit të personave të pagjetur.

Pra, në vend të ligjeve dhe rezolutave dhe fjalëve të mira, apo premtimeve të kota dhe boshe, neve na duhet një strategji shtetërore me obligime konkrete, që brenda mundësive që kanë institucionet të ndërmarrin veprime konkrete. Në planin ndërkombëtar, kjo temë duhet të jetë një instrument, me të cilin Kosova do të mund ta kushtëzonte bashkësinë ndërkombëtare, me veprimin e saj aktiv dhe me trysninë, që bashkësia ndërkombëtare mund ta ketë ndaj Serbisë për ta zbardhur fatin e të pagjeturve dhe për ta zgjidhur këtë çështje, që ka dimensione humanitare.

Natyrisht, kur flitet për fatin e të pagjeturve, ne kemi gjithmonë parasysh se kjo çështje nga paslufta nuk është trajtuar drejt, sepse në situatat e vendeve të pasluftës, zakonisht njëra nga temat kryesore që trajtohen në periudhën e ndërtimit të një mirëbesimi minimal ndërmjet shteteve, ndërmjet popujve, ndërmjet kombeve që kanë luftuar, është pikërisht zbardhja e fatit të të pagjeturve, dorëzimi i pengjeve të luftës, dorëzimi i robërve të luftës, por, fatkeqësisht, në Kosovë kjo çështje nuk është trajtuar asnjëherë mirë. Nuk është trajtuar as me dokumente ndërkombëtare, mbi bazën e të cilave Kosova është çliruar dhe e ka fituar pavarësinë, dhe tani e 10 vjet kjo çështje zvarritet me qëllim dhe mbetet si një çështje me të cilën, në fakt, Serbia gjithmonë përfiton edhe në aspektin politik. Kështu, unë angazhohem që në vend të debateve, që po mbajmë për çdo vit, me gjithë premtimet politike, ne e dimë sa është kapaciteti i Kuvendit, çfarë mund të bëjë Kuvendi.

Kuvendi së paku mund ta miratojë këtë strategji shtetërore, me të cilën i obligon të gjitha organet shtetërore që të veprojnë në mënyrë konkrete, në mënyrë që këto diskutime nganjëherë të mos shndërrohen edhe në diskutime demagogjike, edhe në premtime politike, por të jenë të sinqerta, me të cilat ne sinqerisht tregojmë çfarë mund të bëjmë, por atë që duhet ta bëjmë, dhe kemi për detyrim ta bëjmë, duhet ta bëjmë edhe si Kosovë, edhe si institucione shtetërore. Ta kemi një plan shtetëror në formë të një strategjie me plan operativ, me të cilin ne zotohemi që do t'i ndërmarrim gjitha masat që kërkohen, që kjo çështje, nëse jo të zgjidhet përfundimisht, së paku të futet në rrugën e zgjidhjes. Por, detyrimisht zbardhja...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Mua nuk ma ka sjellë komisioni dokumentin e përkthyer - të shkruar në shqip. Më falni! Besoj që është përkthyer në shqip, edhe në serbisht, dhe kryetarët e grupeve parlamentare, le ta harmonizojnë, në qoftë se doni ta votoni këtë tekst që është ofruar.

Fjalën e ka deputeti Imri Ahmeti.

IMRI AHMETI: Falemnderit, nënkryetar!

Meqenëse shumica e çështjeve u thanë, unë do të provoj të jem shumë konkret në dy çështje. E para, pajtohem me gjithë ata që kjo çështje do të duhej të merret me prioritet politik për

Qeverinë, por çështjet që unë dua t'i ngre janë edhe çështjet teknike-administrative, që kanë qenë dhe janë në dorën e institucioneve tona, përkatësisht në dorën e Qeverisë, më saktësisht të Ministrisë së Drejtësisë.

Se sa Qeveria por edhe ne në një pjesë e kemi marrë serioze tregon prezenca këtu në Kuvend e qeveritarëve. Megjithatë, për mua ka qenë shqetësuese deklarata e bashkëdrejtuesit të Departamentit të Mjekësisë Ligjore, zotit Alban Robinson, i cili thekson që për këtë vit nuk kemi bërë asnjë gjermim, nuk do të ketë gjurmime për lokacione të mundshme dhe nuk është bërë madje as transportimi dhe rivarrimi i mbetjeve të identifikuara për shkak të mungesës të kompanisë të kontraktuar. Më saktësisht, Ministria e Drejtësisë prej vitit të kaluar në nëntor, katër herë e ka shpallur dhe e ka anuluar një tender për gjetur një kompani e cila do të merret me gjermime, me hulumtime dhe e cila do të bënte edhe transportimin e këtyre mbetjeve dhe sot e kësaj dite kjo ministri akoma nuk e ka lidhur këtë kontratë.

Çështja tjetër ose fakti tjetër që mua më ka shqetësuar, është raporti i këtij Departamenti për vitin e kaluar, të cilin e kam këtu para veti dhe në të cilin raport në njëfarë forme provohet të relativizohet ky numër i mbetjeve apo ky numër i personave të zhdukur nga 1.780 persona dhe duke e klasifikuar e bie në një shifër 428 si kufoma apo mbetje mortore të pa kategorizuara. Krejt qëllimi këtu del ashiqare në këtë raport është për të relativizuar dhe minimizuar peshën politike të kësaj çështje apo të kësaj teme mjaft të ndjeshme. Megjithatë, çka bën dhe çka është duke pritur Qeveria në këtë rast për ne mbetet e paqartë.

Unë ftoj, nga kjo foltore Qeverinë, që së paku këto punë dhe këto çështje që janë në kompetencën dhe mundësinë tonë teknike- administrative, kanë mund dhe mund t'i përfundojë, siç është çështje e kontraktimit një kompanie që do të bënte hulumtimet dhe gjermimet. Ky Departament deklaroi se ka të evidentuara 30 lokacione në Kosovë dhe jashtë Kosove, për të cilat pret që të lidhet një kontratë për të filluar punët dhe mendoj që Qeveria duhet sa më parë t'i plotësojë këto kushte. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Fillimisht duhet të them se Aleanca do ta mbështesë cilindo rezolutë ose dokument në të cilin duhet ta aprovojë Kuvendi sot. Mirëpo, si individ po flas si deputet nuk kam mund mos t'i thënë disa fjalë për shkak të peshës së temës për të cilën po flasim, por edhe për shkak të debatit të cilin kemi zhvilluar sot.

Unë vij prej Gjakovës dhe mendoj që nuk ka njeri në Kosovë që nuk e di që Gjakova është qyteti më i shkatërruar, më i vrarë dhe më i përdhunuar në Kosovë, gjatë luftës së fundit edhe nuk do mend se secili prej nesh e ka dikën në familje që është i zhdukur, e kam edhe unë. Kam familjarë tepër të afërt që janë varros, janë ekshomuar janë gjetur trupat diku tjetër, ka tjerë që nuk janë gjetur hiq. Këto që po i them sot po i them me vetëdije të plotë se nuk ka transmetim, por mos me u duk që është demagogji, përndryshe sikur të kishte pas transmetim nuk i kisha thënë këto fjalë për shkak se për shumë vite në Kuvend të Kosovës nuk më keni dëgjuar duke folur kështu.

Ne sot këtu kemi bërë politikë edhe bëhet politikë në Kuvend, unë jam ai i cili në foltore të Kuvendit kam thënë që krejt çka folët në Kuvend edhe është politikë edhe është normale të bësh politikë. Secili prej nesh duhet treguar sa shumë na dhemb zemra për njerëzit që janë zhdukur, për ata që nuk janë gjetur ende, për familjet e tyre, për vuajtje e familjeve duhet thënë, ne duhet të themi diçka për shkak se na duket rëndë mos të themi. Mirëpo, edhe serbët thonë diçka se edhe atyre iu duket që është e rëndë mos të thonë diçka se ka edhe serbë të zhdukur në Kosovë. Tani këtë punë që po bëjmë politikë ne duhet pasur disa çështje parasysh për të cilat po flas dhe po kam dëshirë me qenë tepër i kujdesshëm për shkak se janë fjalë, të cilat godasin edhe majtas edhe djathtas edhe çdo fjalë e pamenduar mund të zgjojë kontraverza, mund të keqkuptohet edhe na duhen muaj për të mbërri t' i sqarojmë se çka kemi dashur të themi në të vërtetë.

Ajo që po dua të them unë është se sot ne e kemi folur. Kemi folur edhe e kam frikën se kur kryhet ky debat Kuvendi do ta ketë një ndjenjë se e ka kryer një pjesë të madhe të punës kundrejt elektoratit të vetë për të zhdukurit dhe nesër në mëngjes ose javën tjetër nuk do të ndodhë kurrëgjë. Kjo është çështja tipike çka ndodh kur ka fjalë shumë? Çka do të ndodhë nesër pasi ne ta kryejmë këtë debat dhe ta votojmë këtë rezolutë? Mendimi im është se faktikisht zor që do të ndodhë diçka.

Çështje tjetër është një gjysmë replike, duke pasur shumë parasysh që kemi njerëz ndoshta edhe në sallë që kanë familjarë të zhdukur, jo ndoshta po janë. Qoftë shqiptarë, qoftë serbë.

Kemi të bëjmë me dy çështje të ndryshme. Janë zhdukur serbët në Kosovë, është e vërtetë, por ky Kuvend dhe Qeveria, cilado qoftë ajo qeveri, nuk e ka udhëhequr një ushtri të strukturuar para luftës, nuk ka bërë dosje, nuk ka arkiva, nuk ka pasur gjeneralë, të cilët i ka emëruar vetë, të cilët mund t'i thërrasë, e as arkiva nga të cilat mund t'i nxjerrë dhe ta zbardhë fatin e tyre, përderisa Serbia i ka.

Kjo është diferencë jashtëzakonisht e madhe, është çështje shumë esenciale. Po provoj të jem shumë i kujdesshëm në fjalë, për të mos goditur. Ju thashë që janë çështje, janë caqe shumë të ngushta për t'i goditur dhe çdo fjalë e gabueshme mund ta godasë dikë. Nuk është qëllimi im ky.

Tani, pyetja në Kuvendin e Kosovës është dashur të jetë: Cilat leva i ka në dorë Kosova, si shtet? Cilat leva i ka në dorë Qeveria e Kosovës, në mënyrë që ta imponojë zbardhjen e fatit të të zhdukurve. Duhet ta pranoj se ka pak leva, por prapëseprapë duhet të ju them se ka leva. Çështja është, a do t'i shfrytëzosh ato leva, apo jo. Dhe, tani, a do a nuk do, nuk është çështje e vullnetit. Dua të besoj se nuk është çështje e vullnetit e kujtdo në pushtet, por është çështje e vendosjes prioriteteve. Çka është prioritet? Vetëm sa për hir të argumentit po ju them: A është prioritet të insistohet shumë në zbardhjen e fatit të të gjithë të zhdukurve, apo të pajtohemi disi t'i shpallim pavarësi. Ndoshta dikush ka vendosur ndryshe, por janë çështje të prioriteteve dhe unë e kam një bindje se sot nuk po vendoset prioriteti, dhe nëse para 4 vjetëve ka qenë zor të vendoset ky prioritet, sot është më lehtë. Sot mund të vendoset prioriteti, e cili është ky prioritet për të cilin po flas unë; a duam të kemi bisedime përderisa nuk kushtëzohet zbardhja e fatit të të zhdukurve, apo jo.

Unë mendoj që Qeveria e Kosovës duhet ta kushtëzojë. Nëse gjithë ajo çfarë kemi thënë ne sot në sallë këtu, nëse gjithë ajo që kanë thënë deputetët e opozitës, edhe deputetët e partive në pushtet, është me të vërtetë e vërtetë, nëse me të vërtetë besojnë në atë që e kanë thënë, se duhet të jetë prioritet zbardhja e fatit të zhdukurve, atëherë duhet ta obligojmë Qeverinë, duke thënë: “Nuk do të shkoni për të biseduar, përderisa nuk i merrni të gjitha dosjet prej Serbisë”. Nëse me të vërtetë kemi menduar çka kemi thënë sot, e mua po më duket që ndoshta edhe vetëm kemi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESYESI: Ia vazhdoni edhe një minutë!

ARDIAN GJINI: ...të cilat janë reale, janë të vërteta, nuk janë të rrejshme, e absolutisht besoj se ndjenjat që i kanë shprehur deputetët nuk janë të rrejshme. Mirëpo, a mendojmë ne se duhet ta obligojmë Qeverinë, duke i thënë: “Nuk do të shkoni në bisedime, përderisa Serbia nuk sillet konform së drejtës ndërkombëtare, konform të drejtave të njeriut, konform të një drejte hyjnore”, mund të them, për ta zbardhur fatin e të zhdukurve.

Këto janë mendimet e mia që desha t'i ndaj me ju, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Po shpresoj se kjo rezolutë, të cilën ne çfarëdo qoftë do ta votojmë, për hir të situatës, nuk do të jetë një rezolutë, e cila nesër në mëngjes nuk do ta obligojë askënd, nuk do të bëjë asgjë më ndryshe për zbardhjen e fatit të zhdukurve dhe, të paktën, për pacifikimin e zemrave, për qetësimin e zemrave të familjeve të atyre që janë zhdukur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Tema për të cilën po diskutojmë, pra për të zhdukurit, mund të them se është dashur ndoshta të flitet edhe më herët, jo vetëm sot.

Është diskutuar në forma të ndryshme, është gjetur një këshill dhe ata e kanë pru, por këtu duhet të flitet me emra, të cilët njihen edhe dihen. Nuk janë vetëm të zhdukurit një pjesë, por janë me emra, kush i ka marrë dhe kush janë përgjegjësit kryesorë.

Unë do të flas për pjesën ku ka ndodhur një masakër në Burgun e Dubravës. Në atë masakër janë vra njëqindënjëzet e sa veta, mbi 300 tjerë janë plagosur. Prej asaj kohe nuk dihet për Ukshin Hotin, por dihet kush e ka marrë Ukshin Hotin. Prandaj, dihet që e ka marrë “Aca”, drejtori i burgut, dihet që e ka marrë komandanti i burgut, “Miki”, dihet edhe gardiani ose mbikëqyrësi që e ka marrë “Brankoja”. Do të thotë, dihen njerëzit që e kanë marrë dhe duhet të kërkohet përgjegjësia për këta. Nëse ne vetëm deklarojmë “për të zhdukurit, për të zhdukurit, për të zhdukurit” - nuk kemi bërë asnjë zgjidhje.

Po, Shoqata e të Burgosurve ka bërë një kallëzim, një padi në Gjykatën e Pejës para 3 vjetëve dhe ajo padi i akuzon të gjithë ata që kanë marrë pjesë në krim dhe në vrasje të drejtpërdrejtë. Dhe, atë nuk është marrë asnjë aktivitet, me përjashtim të një rasti, kur është arrestuar një i burgosur që ka marrë pjesë në krim. Do të thotë se ne i dimë njerëzit, ne i dimë ata të cilët

kanë marrë pjesë, ne e dimë që kanë qenë pjesë e institucioneve, dhe ato institucione nuk e kanë marrë përgjegjësinë. Prandaj, te ne flitet se Xhavit Hazirin e ka marrë UDB-ja, organ dhe institucion, me emër e mbiemër. Havir Shalën, po ashtu. Ne sot vetëm flasim për të zhdukurit, e duhet ta japin një përgjegjësi, ose të na japin dosjet. Nuk është e mjaftueshme kjo!

Ky rekomandim apo rezolutë, si do t'ia vëmë emrin, nuk është i mjaftueshëm, përderisa institucionet tona, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Jashtme e kryeministri nuk kanë marrë ose nuk kanë, siç e tha Ardiani, prioritet, pikërisht kur dihen edhe vendoset për këtë çështje.

Prandaj, kërkoj që nëse duam ta bëjmë këtë zgjidhje, nëse edhe kemi mundësi, atëherë t'i vendosen kushtet për të cilët Serbia duhet të japë përgjigje. Nëse për asnjë tjetër nuk mund të japë përgjigje, se thotë: “nuk di”, të paktën për të burgosurit e Burgut të Dubravës e di se kush janë përgjegjësit. Dihen kush janë vrasësit, dihen të vrarët me emra mbiemra, dihet që nuk dihet hala edhe sot ku është Ukshin Hoti. Prandaj, kjo është njëra nga çështjet që Qeveria e Kosovës duhet ta vërë prioritet dhe duhet ta kushtëzojë pikërisht për masakrën e Burgut të Dubravës, që është një nga masakrat më çnjerëzore, më të dhimbshme, që ka ndodhur që nga Lufta e Dytë Botërore.

Nëse këtë nuk e bëjmë, kjo tregon se ne pajtohemi me fatin, kjo tregon se ne pajtohemi që nuk do të bëjmë zgjidhje, kjo tregon se ne pajtohemi që kjo gjendje le të shkojë në pakufi, por çka do të thotë kur këto ditë Ambasada Amerikane thotë: “Kërkoj edhe japim shpërblim, kush di për ushtarët e Luftës së Dytë Botërore, që atëherë qenkan vrarë në Kosovë, na jepni informatë, t'i dimë varret e tyre”. Tash, kur pas 50 vjetëve, shtetet e fuqishme i kërkojnë, e ne i kemi vetëm 10 vjet dhe i dimë njerëzit kush janë e nuk marrim masa, ose nuk kërkojmë angazhim nga shteti të dimë për fatin e tyre.

Prandaj, kërkoj që ky rekomandim a kjo rezolutë të jetë më e plotë dhe të kërkohet më me këmbëngulje që të dihet për fatin e njerëzve, si: Ukshin Hoti, Xhavit Haziri, Hafir Shala dhe të tjerë e të tjerë, të cilët i përmendi edhe Hydajeti, por edhe për masakrën e Burgut të Dubravës, njerëzit duhet të dalin para drejtësisë. Përndryshe, pajtim nuk mund të ketë me Serbinë, ku ajo ka bërë një gjenocid shekullor te ne. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem, predsjedavajući!

Poštovani kolege poslanici,

Najveći zločin bilo kog vremena je neizvesnost. Neizvesnost oko sudbine nestalih lica na Kosovu za vreme, o najvećim broju posle prestanka oružanih sukoba, je vreme koje pritiska članove porodice kidnapovanih i nestalih.

Nažalostk, jedna tako teška situacija koja najdublje zadire u ljudskost, zadire u porodicu, zadire u svakodnevni život, zadire u međuljudske odnose je postala tema za skupljanje političkih poena, tema za patriotske govore, tema o kojem se sve vodi računa - samo ne o

nestalim licima i članovima njihovih porodica. Tema koja se prilazi bez odgovornosti i spremnosti da se dođe do konačnog rešenja.

Osnova za korak napred i početak ozbiljnog razvijanja jednog regiona, našeg regiona, i društvo u njemu zavisi od suočavanja sa prošlošću.

Zahtevati odgovornost od druge strane ali istovremeno biti spreman i ponuditi i sopstvenu odgovornost za dela i za bol koje se ne poznaje nacionalnu pripadnost.

Počinioci tih dela sa obe strane, se moraju nazivati istim imenom i mora se zahtevati kazna da bude podjednako za sve. Mora se graditi budućnost gde svaki ljudski život je podjednako vredan, a to se može jedino ako se prizna i sopstveno odgovornost, a da se pojedini heroji nazovu pravim imenom.

Lično govorim i kao član porodice kidnapovanih i nestalih, ali i kao deo politike, jer je najveće političko odgovornost rešenje ovog pitanja.

Ono što porodice žele da konačno vide, jeste politička zrelost i Prištine i Beograda i Međunarodne zajednice u obavljanju svih neophodnih istraživanja povezanih sa rešenjem sudbine nestalih, proširiti istraživanja i na region veći od Kosova i Srbije, jer postoje opravdane pretpostavke da bi to moglo biti velike od pomoći. I ono što je najvažnije, privođenje pravdi i svakog pojedinca odgovornog za zločin nestalih i kidnapovanih. Hvala.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Xhevahire Izmaqu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Dhe ju shumë të respektuar familjarë të të zhdukurve që jeni sot këtu me ne në këtë sallë, Në vitet '98 dhe '99 ushtria serbe, e ndihmuar nga policia dhe paramilitarët, e fillojnë një aksion të gjerë luftarak edhe në komunën e Vushtrrisë ku u vranë 650 qytetarë, gjersa gjatë këtyre aksioneve kanë zhdukur 116 civilë nga të cilët numri i tyre i madh ende konsiderohet e tillë, pra të zhdukur pasi nuk dihet asgjë për fatin e tyre.

KRYESUESI: Lutfi Haziri është i fundit!

XHEVAHIRE IZMAKU: Vetëm me 22 maj të viti '99 u kidnapuan 68 qytetarë nëpër lagjet e qytetit të Vushtrrisë, të varrosu më pastaj në varreza masive nëpër Serbi, 11 nga të cilët ende presin identifikimin final të trupave për tu varrosur.

Në masakrën e Studimes, më 2 maj '99 për dy orë u vranë 117 qytetarë, nga të cilët 17 femra. U vra edhe nëna me frytnim 8 muajsh në bark, ndërsa u plagosën 25 civilë të tjerë.

Me 16 prill të vitit '99, po ashtu u vranë edhe 9 qytetarë të tjerë duke shkuar nëpër shtëpitë e tyre, gjersa më 15 maj po kjo polici serbe vrau 6 gra të familjes Gërguri.

Më 31 maj '99 ndodhi edhe masakrimi i familjes 12 anëtarëshe të Seladin Gërxhaliut, ku në shtëpinë e tij u vranë 7 fëmijë, pra u ekzekutua një familje e tërë.

Në kampin e përqendrimit në Smrekonicë serbët mbanin 3.000 të burgosur, të cilët u malltretuan skajshmërisht. Aty u zhdukën 12 të ri të moshës fëmijërore dhe po ashtu dhe gra të tjera. Pati dhunime e veçanërisht në dy fshatrat e kësaj komune dhe në një lagje të qytetit ku serbët po ashtu plagosën edhe 484 qytetarë me armë zjarri, derisa në burgjet e Serbisë deportojë edhe 87 qytetarë të tjerë.

Në fshatin Reznik, përveç që kjo polici serbe ekzekutoi 3 qifte bashkëshortorësh me 3 fëmijët e tyre të familjes Ujkani, ajo nuk u kënaq me kaq. Kufomat e tyre ua dogji me gjithë djegien e shtëpisë, gjersa në fshatin Galicë i vret 14 qytetarë duke ua prerë edhe gjymtyrët e trupit tërësisht.

Në Vushtrri përveç viktimave civile pati edhe dëshmorë të Ushtrisë Çlirimtare, djem të cilët u vranë me pushkë në dorë për t'i dhënë fund këtij okupimi dhe masakrimi të qytetarëve nga kriminelët serbë për t'i realizuar një qëllim të vetëm - lirinë e vendit të vetë.

Janë mbi 60 të tillë që kanë lënë 130 fëmijë pa prindër për të arritur lirinë që popujt e tjerë e kanë para qindra vite.

E gjithë kjo ngjarje ka mbetur pa u ndjekur nga drejtësia qoftë ndërkombëtare apo vendore, edhe për të cilën ekzistojnë diku rreth 900 dëshmi automatike të dëshmitarëve të drejtpërdrejtë. Se nuk ka të drejtë askush nga ne të kërkojë t'i falemë e t'i harrojmë këto krime mizore që ushtruan serbët në vendin tonë është edhe ky fakt që përpos tri rasteve të kreut të shtetit të Serbisë, kriminelit të vdekur Millosheviq, grupit të Millotinoviqit dhe rastit të Gjorgjeviqit me të cilin është marrë Tribunali i Hagës - asnjë prej ekzekutuesve të këtyre krimeve, ende as pas 13 vjetëve, nuk janë dalë para drejtësisë.

Pra, sot e 13 vjet po u bëhet sehir këtyre kriminelëve serbë dhe vetë kryeprokurorja Karla del Ponte i mbeti borxh këtyre familjeve duke lënë të vdiste kriminelin pa ia dhënë dënimin dhe emrin kriminel.

Dosjet e dëshmive për krimet e kryera në komunën e Vushtrrisë nga forcat serbe gjatë luftës dhe gjithë ai material voluminoz me dëshmi që është pranuar nga EULEX-i qysh vitin e kaluar në këtë kohë me rreth 1.000 faqe me video incizime tjera përcjellëse të bëra nga vendi i ngjarjes, nuk lëvizën asnjë milimetër, asnjë iniciativë.

Moskapja e kriminelëve të luftës nuk i shërben paqes, nuk i shërben demokracisë, as shtetit të së drejtës. Këtë e di edhe më mirë se ne bashkësia ndërkombëtare, andaj, ne po kërkojmë të kryen punën e vetë ky EULEX i cili nuk do të mbetet zhgënjim vetëm për ne, por edhe për gjithë taksa paguesit e qytetarët e atyre shteteve që bëjnë pjesë në këtë mision.

Tanimë kur ne kemi institutin tonë për zbulimet e këtyre krimeve, nuk ka asnjë justifikim. E fundit dënimi dhe zbulimi i këtyre kriminelëve nuk mund të ngjallë të vrarët tanë, por kthen

besimin te qytetarët, kurajon ardhmërinë e këtij vendi që të vazhdojnë përpara kurrë pa i harruar të vrarët tanë, mirëpo duke e ndërtuar një jetë të re mundësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haziri e keni fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Familjarë të të zhdukurve,

Përfaqësues shoqatave të familjarëve,

Të nderuar kolegë,

Më lejoni që të marr pjesë në këtë debat që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për ne si shoqëri.

Kam dëgjuar shumicën e deputetëve sot kanë shkaktuar debat me apo pa vetëdijen ndryshimin e statusit të pagjeturve, duke i përzier me të vrarët dhe me proceset tjera që kanë ndodh gjatë luftës. Përderisa janë të pagjetur trajtohen si të tillë që të zhdukur dhe statusin nuk ka drejtë ta ndryshojë askush. As me paragjykim, por duhet punuar për zbardhjen e rastet qysh ka ndodh veç e veç, dhe i mbetemi borxh.

Dola me përmend kështu sa i përket çështjeve është tu punu një doktor e ka emrin Arsim Gërxhaliu...

Këtu që do të doja ta falënderoj , sepse është njëri prej njerëzve që udhëheq një Institut apo institucion shteti i cili nuk kursen kohë, angazhim, mund dhe shoqatat e familjarëve, veç shoqatat...

Një Zyre te kryeministri është pro forma, treguesi mos kujdesit është kur e gjen një njeri thua qe ku e ke rrogën vazhdon me trajtuar këtë problem. Sepse me këtë çështje duhet me u marrë vet ministri nëse kryeministri nuk do. Ministri i Drejtësisë sipas përvojave edhe asaj që në regjion kanë kaluar shtetet tjera është që ministri me detyrë kryesore merret me tretmanin e kësaj çështje, ndërsa zyrën duhet t'ia besojmë njerëzve që udhëheqin shoqatat e këta janë shoqatat e familjarëve të zhdukurve. Ata duhet ta koordinojnë aktivitetin në zyre, sepse është pjesë e cila mund t'i besohet këtij angazhimi.

Këtë në këtë Qeveri nuk e kemi edhe pse tema si e tillë ka mbetur e hapur, herë thuhet kem folur, herë s'kemi folur, herë kemi hapur si temë, por është e vërtetë që ai i cili i ka të dhënat nuk i ndanë, nuk i jep i kushtëzon dhe publikisht edhe zyrtarisht edhe jo zyrtarisht ka thënë që Kosova në këtë temë është e kushtëzuar. Kosova ka dështuar ta kushtëzojë Serbinë në këtë temë, ndërsa prej kohës kur ka qenë Kushtunica, kryeministër ai e ka vendosur kushtin që çështja e të zhdukurve lidhet me zhdukurit e pasluftës dhe kjo duhet treguar atyre njerëzve që janë pjesë e atyre familjeve.

Tendenca për ta balancuar dhe trajtuar njëjtë ka ardhur si e tillë dhe është në tavolinë. Këtë kusht Kosova nuk ka guxuar ta pranojë dhe këtë kusht Kosova në bisedime eventuale dhe në kërkimin e dokumentacioneve dhe informatave nuk guxon ta lejoj si të tillë, por procesi si i tillë është blloku sepse është i kushtëzuar.

Dhe ne dëgjuam edhe nga kolegët tanë të komunitetit serbë që përfaqësojnë partitë politike më shumë se komunitetin etnik që rrëshqet kërkesa që rezoluta të merret edhe me këtë çështje. Debati për mua sot ka të bëjë me të zhdukurit e luftës dhe është i ndarë dhe duhet të ndahet nga ajo që ka ndodhur pas 12 qershorit të vitit 99, është tjetër proces edhe është tjetër ambient, por procesi deri aty duhet të sqarohet si e tillë.

Në fund çështja e të zhdukurve të luftës së fundit na përkujton që Kosova nuk është marrë kurrë me zhdukurit e luftës së dytë, këtu është përmend por vetëm Gjilani i ka 1300 të zhdukur në Luftën e Dytë Botërore. Vetëm qyteti i Gjilanit ka humbur 20% të popullatës në Luftën e Dytë Botërore dhe kur askush nuk është marrë me problemin e të zhdukurve të asaj, sepse ky Kuvend ka refuzuar me ndikim të dikujt me dënua regjimin komunist sipas rezolutës të propozuar këtu dhe ajo rezolutë krijon mundësi që me u marrë edhe me problemet e luftës të kaluar, por prioritet mbetet të zhdukurit e fundit , sepse janë me mijëra dhe çdo individ e ka peshën më shumë se çdo ministër që sot nuk ka ardhur këtu. Çdo i zhdukur është më i rëndësishëm se ministrat që s'kanë dashur të vijnë të flasin edhe të dëgjojnë sot debatin edhe brengën.

Në fund unë lus që procesin ta deblllokojë ai i cili ka mundësi ta deblllokojë, sepse ne mund të themi për asnjë temë s'bisedojmë në Bruksel nëse kjo çështje nuk zbardhet deri në fund edhe japim mundësi mu marrë me këtë çështje dikush më shumë se që jemi marrë deri tash. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Janë paraqitur edhe Bekim Haxhiu dhe Agim Kuleta.

Fjalën e ka BEKIM Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Përshëndetje Kabinet qeveritarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përshëndetje dhe për familjarët e personave të pagjetur që janë prezent këtu,

U diskutua mjaftë në aspektin e personave të pagjetur edhe mendoj që sado që diskutojmë në këtë aspekt, është e pamjaftueshme për t'i shëruar plagët e familjarëve, të personave të pagjetur.

Mirëpo, ajo çka ne si deputetë do të mund të bënim që sado pak të bënim për këta familjarë është nëse bëjmë hapa konkretë për zbardhjen e fatit të pagjeturve dhe krijojmë ambient dhe kornizë ligjore në kontestin e zbardhjes së fatit të pagjeturve.

Prandaj nuk do të zgjatem shumë në diskutime përveç faktit atë që e tha edhe kolegu Haziri , për arsye se shpeshherë gjatë punimeve dhe rastësisht ka ndodhur të gjenden edhe eshtrat e personave të pagjeturve nga Lufta e Dytë Botërore e në veçanti është rasti i fundit në Bajr të Mitrovicës ku janë gjetur 55 mbetje mortore të personave nga Lufta e Dytë Botërore. Ndërsa Departamenti i mjekësisë ligjore dhe Departamenti në kuadër të EULEX-sit nuk është marrë fare me trajtimin e këtyre personave. Prandaj, do të ishte mirë edhe apeloj edhe nga Ministria e Drejtësisë që të bëjë tryzni edhe mbi Departamentin e Mjekësisë Ligjore për zbardhjen edhe të merr në konsideratë edhe këto mbetje mortore të cilat janë gjetur në Bajr të Mitrovicës.

Propozoj që te rekomandimet te pika 2 konkretisht të ndryshohet dhe të jetë ndryshe, do të jetë këtu në këtë formë: “Departamenti i Mjekësisë Ligjore duhet të rrisë kapacitetet dhe intensifikojë punën në identifikimin e mbetjeve mortore dhe punës në terren” dhe tek pika 3, domethënë të jetë: “Institucionet e Republikës së Kosovës obligohen që të punojnë më shumë në sensibilizimi ndërkombëtar të çështjes se personave të zhdukur gjatë luftës së fundit por edhe të Luftës së Dytë Botërore”. Këto janë ato, mendoj që duhet t’i shtohen, është propozimi im në kuadër të rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur dhe Peticione. Ju faleminderit!

Seancën e drejton kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Karsniqi

KRYETARI: Edhe i fundit për debat, deputeti Agim Kuleta, e ka fjalën.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar familjarë të pagjeturve,

Unë desha vetëm disa ndërhyrje konkretisht lidhur me tekstin që përmban rekomandimet.

Konsideroj se në përgjithësi ekzistojnë dy të meta te ky tekst, e para është çështja e adresimit, do të thotë mungon një adresë e saktë se kujt t’i drejtohen këto. Në pikën 3 për shembull i drejtohen institucioneve të Republikës së Kosovës që është e përgjithshme dhe përfshin të triat, mirëpo të gjitha pikat tjera nuk kanë adresë të saktë se kujt t’i drejtohen, ndërkohë që përmbajnë detyra dhe çështje të cilat mund të nënkuptohet që edhe Kuvendi duhet të merret me to.

Dhe pika tjetër, ka të bëjë me afatizimin, është pika e 5-të ku thuhet se: “hartimin e një strategjie shtetërore me plane konkrete dhe afate kohore drejt ndriçimit të fatit të personave të zhdukur”, këtu janë përcaktuar afatet që kanë të bëjë me ndriçimin e fatit të personave, por nuk ka afat për hartimin e kësaj strategjie, do të thotë sa kohë duhet. Prandaj, unë propozoj që këtu të shkojë: “hartimi brenda dy muajsh të një strategjie shtetërore me plane konkrete” dhe të vazhdojë tutje.

Gjithashtu një vërejtje tjetër është sa i përket redaktimit, konsideroj se ka fjali që nuk janë të përpiluara mirë, për shembull është pika 4 ku thuhet: “të jetë në fokus kërkesa nga bashkësia ndërkombëtare” e që besoj që është dashur të thuhet: “që të shtohen përpjekjet në drejtim të shtyrjes së bashkësisë ndërkombëtare për të bërë trysni tek autoritetet”. Domethënë këto janë ato vërejtje që i kisha unë. Falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zotni kryetar!

Ne po bisedojmë për një çështje tepër të ndejshme dhe tepër të rëndësishme e cila ka brenda aspektin human, po duhet ta pranojmë edhe aspektin politik dhe është aspekti politik i cili çështjen e ka bërë më të ngatërruar për më shumë se një deçenie.

Unë kam dëgjuar mendimet e kolegëve këtu, kam dëgjuar propozim- rekomandimet në fillim, prapë e kam në dorë një tip përplotësimi, sigurisht është i Komisionit.

Megjithatë kemi një evidentim të si duket të ideve të ndryshme, të cilat edhe është vështirë që të formulohen kështu shpejt. Idetë janë që të kërkohet në mënyrë obligative dhe të merren detyra edhe të afatizuara për problemin i cili po zgjat mbi një deçenie.

Kërkimi i fatit të pagjeturve në çdo shoqëri edhe në shoqërinë tonë, nuk mund të përcaktohet me afate, sepse ky është një proces që zgjat përderisa të gjendet edhe fati i të fundit, sepse e tha zoti Hyseni, më herët, çdo fat është një jetë, është një biografi, është një histori individuale, numrat mbasandaj janë statistikë. Këtu nuk mund të merremi me statistikë, numri i madh, natyrisht thotë që është numër i madh, po kërkimi është individual dhe kërkimi individual nuk mund të bëhet për pa zotimin edhe nacional edhe ndërkombëtar, detyrimin edhe nacional edhe ndërkombëtar si shoqëri dhe si qeveri që prek sot edhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, por edhe Qeverinë e Serbisë. Prandaj, pa një detyrim ndërkombëtar, unë dyshoj që mund të funksionoj bashkëpunimi i informatave dhe i kërkimeve i cili është i domosdoshëm i dy qeverive, i dy shoqërive.

Kështu që për të përmbyllur atë që e kam idenë, mua më duket që diskutimet kanë dhënë ide për të gjitha këto, veçse një tekst ndoshta nuk mund të hartohet tash për tash, por të hartohet me gjithë këto që u biseduan dhe si tekst i saktësuar të votohet në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit. Ky është sugjerimi im. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Fjalën ia kisha dhënë për fund kryetares së Komisionit, deputetes Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Kryetar, unë desha t'i kërkoj 15 minuta për t'u takuar me shefat e grupeve parlamentare. Vërtet, propozimi i zotëri Sabri Hamitit, më pëlqej që të hartohet një tekst, do të thotë rekomandimet e posaçme dhe të njëjtat të votohen në seancën e radhës. Prandaj, ndoshta kishte qenë mirë që të jepet një pauzë 15 minutëshe që të vendosim se a do t'i hartojmë apo do të dalim me një tekst për seancën e radhës?

KRYETARI: Jo, unë mendoj që propozimi i nënkryetarit, Sabri Hamiti është, konsideroj më i mirë dhe le të bëhet një tekst i rishikuar i këtyre rekomandimeve dhe mendoj që duhet të ketë një bashkëpunim mes grupeve parlamentare se secili grup ka pasur diçka të thotë dhe ka thënë diçka të veten, dhe në seancën e ardhshme të formulohet, po edhe Komisioni. Mendoj që është mirë edhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi të jetë pjesë e hartimit të rekomandimeve, po ajo çka unë e kisha thënë në këtë rast se është mirë të mendohet edhe ndërtimi i një memoriali, përveç që do të përmbante të gjithë fotografitë e njerëzve që janë të pagjetur edhe të jetë një farë lloj shoqate, tash ne e kemi një Institut, por një farë lloj shoqate që në atë ndërtesë të jetë një dhomë ose të jetë një hapësirë ku njerëzit që kanë dëshmi dhe unë mendoj që kanë dëshmi të ndryshme, në pjesë të ndryshme të Kosovës, t'i rrëfejnë dhe t'ia lënë historisë ato rrëfime në mënyrë që kjo do të shërbente jo vetëm si një dokumentacion i asaj që ka ndodhur, por të jetë edhe një mesazh që të mos përsëritet ajo që ka ndodhur në një kohë. Unë mendoj që ne duhet ta kemi një ndërtesë e cila në një mënyrë ose tjetër e memorializon atë që ka ndodhur në mënyrë të veçantë në luftën e fundit.

Nëse jeni dakord dhe po më duket jeni dakord, ne po e lëmë që për seancën tjetër, deri në seancën tjetër të harmonizohet teksti i rekomandimeve.

Me një votim formal, kush është “për”? Faleminderit!

A ka “kundër”, nuk ka.

Atëherë me votimin e shumicës absolute, brenda javës le të harmonizohet teksti i rekomandimeve.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës-

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror

Ministri ka kërkuar tërheqjen e tij dhe unë jam që të tërhiqet për seancë të radhës.

Kush është “për”? Faleminderit!

A ka “kundër”? Nuk ka. Abstenim, nuk ka.

Do të thotë pika 5 hiqet nga rendi i ditës.

Shkojmë te pika gjashtë e rendit të ditës-

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadergjonaj që ta marrë fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin numër 04/L-114 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale, seancës i ka rekomanduar disa plotësim - ndryshime të cilat janë më shumë teknike dhe gjuhësore, prandaj raporti me rekomandime është votuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa nga anëtarët e këtij Komisioni, ka kaluar pa ndonjë ndryshim në komisione tjera të cilat duhet ta shqyrtojnë raportin përfundimtarë dhe rekomandoj që kështu siç janë rekomanduar dhe të votohen në seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

A do dikush tjetër fjalën? Nuk ka.

Atëherë shkojmë në votimin e amendamenteve.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.
 “Kundër”, nuk ka.
 Abstenim, nuk ka.
 Miratohet.

Amendamenti 3.
 “Kundër”, nuk ka.
 Abstenim, nuk ka.
 Miratohet.

Edhe ky ligj kishte 3 amendamente.
 Prezentë në sallë janë 73 deputetë.
 Tani votojmë ligjin në tërësi.
 Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.
 Konstatoj se me 57 vota “për”, 7 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për tatim në të ardhurat personale.

Vazhdojmë pikën e shtatë të rendit të ditës, që në fakt është e gjashtë.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadergjonaj, që para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Në Komisionin për Buxhet dhe financa po ashtu është shqyrtuar edhe Projektligji numër 04/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të ardhurat e korporatave. Në Komision të gjitha këto ndryshime të cilat janë bërë këtu dhe këto më shumë janë edhe në ligjin e mëparshëm ndryshime teknike. Të gjithë anëtarët e Komisionit janë pajtuar me këto ndryshime dhe unë kisha sugjeruar deputetët që ta miratojnë raportin me rekomandime.

KRYETARI: Faleminderit!

Ka ndonjë komision që e do fjalën? Jo.

Amendamenti 1.
 “Kundër”, nuk ka.
 Abstenim, nuk ka.
 Miratohet.

Amendamenti 2.
 “Kundër”, nuk ka.

Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 3.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 4.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Tani votojmë tekstin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash. Prezentë janë 72 deputetë.

Konstatohet se me 56 vota “për”, 8 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratohet Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave. Falemnderit! Pika e radhës-

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadergjona, që para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Komisionin për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin numër 04/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03L/146 për tatimin mbi vlerën e shtuar. I ka përgatitur rekomandimet për seancë, mirëpo tek amendamenti 11 është lëshuar një gabim gjatë hartimit të raportit përfundimtar, kështu që kur të vijmë te amendamenti 11, kërkoj fjalën që të japë sqarimin se si ka qenë i miratuar në Komisionin për Buxhet. Përndryshe amendamentet tjera rekomandoj që të miratohet ashtu siç i ka propozuar Komisioni.

KRYETARI: Falemnderit! A do dikush tjetër fjalën? Jo. Vazhdojmë.

Amendamenti 1.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 2.
“Kundër”, nuk ka,

Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 3.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 4.
“Kundër” nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 5.
“Kundër” nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 7.
Kundër, nuk ka.
Abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Deputete, fjalën e kërkoje për amendamentin 11.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka miratuar ndryshimin në amendamentin 11, që ka të bëjë me nenin 27, paragrafi 1, në reshtin e 3-të, pas fjalëve : “i nenit 28 të këtij ligji” të shtohen fjalët: “për të cilën periudha kalimtare përfundon më 31 dhjetor 2014”. Domethënë, në amendament është: “për të cilën periudha kalimtare përfundon”- mirëpo data se kur përfundon është bërë një gabim teknik gjatë hartimit të raportit përfundimtar, kështu që kisha kërkuar që të bëhet ky plotësim. Dhe, amendamenti 11 i plotësuar të jetë kështu: “Neni 27, paragrafi 1, në reshtin e 3-të, pas fjalëve: “i nenit 28 të këtij ligji”, të shtohen fjalët: “për të cilën periudha kalimtare përfundon më 31 dhjetor 2014”.

KRYETARI: A jeni dakord? Po.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka, pra miratohet me ndryshimin e propozuar nga kryetarja e Komisionit, deputetja Safete Hadergjonaj.

Amendamenti 12.

“Kundër”, nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Miratohet.

Dhe, votojmë ligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.

Prezentë janë 70 deputetë.

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Vazhdojmë tutje:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë,

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadergjonaj, që para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet ka shqyrtuar Projektligjin numër 04-L/99 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe akcizave, i përgatitur disa amendamente të cilat më tepër janë teknike dhe gjuhësore, po ka edhe rregullim të referencave të cilat kanë qenë në projektligj, kështu që raportin me rekomandime, ftoj deputetët që ta votojnë ashtu siç e ka paraqitur Komisioni për Buxhet dhe Financa, i cili është miratuar me votë unanime në Komision. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Tjerë nuk ka të interesuar për diskutim. Vazhdojmë.

Amendamenti 1.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 2.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 3.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 4.
“Kundër”, nuk ka,
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 5.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 7.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.

“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
miratohet.

Amendamenti 11.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Tani votojmë ligjin në tërësi.
Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.
Prezentë janë 69 deputetë.
Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë.

Dhe tani kemi pikën e fundit të rendit të ditës

- Shqyrtimi i vendimit të Presidencës së Kosovës për kthimin në shqyrtim të Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Ju kisha lutur pak më shumë qetësi dhe ju falënderoj që po i kryeni dy punë përnjëherë.

Kuvendi ka miratuar Ligjin numër 04/L-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, më 15 mars 2012.

Ligji është dërguar presidentes së Kosovës për shpallje, më 26 mars 2012. Presidentja e Kosovës, më 3 prill 2012 ia ka kthyer ligjin Kuvendit me amendamentet e propozuar në nenin 27.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2012, ka ngarkuar Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, që ta shqyrtojë vendimin e presidentes dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar vendimin e presidentes së Kosovës për kthim në Kuvend të Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin.

Ftoj kryetarin e Komisionit, deputetin Amet Isufi, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë rekomandimin.

AHMET ISUFI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni Parlamentar për Punë të brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në bazë të nenit 61, paragrafi 4 i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2012, ka shqyrtuar vendimin e presidentes për kthimin në rishqyrtim të ligjit numër 04/L-084, për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe ka rekomanduar që kjo çështje të diskutohet dhe të vendoset në mbledhje plenare të Kuvendit.

Mendoj që pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës duke qenë një institucion shumë kredibil në Kosovë edhe për të kaluarën e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, meritojnë një nderim dhe një respekt më të madh se sa që i është bërë deri më tani, për arsye se me propozimin e presidentes i lihet e drejta e Qeverisë që të shkurtojë kur të dojë pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kjo mënyrë arbitrare e veprimit besoj që e dëmton Forcën e Sigurisë së Kosovës, pjesëtarët e saj dhe perspektivën e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Prandaj, konsideroj që ligji të aprovohet ashtu siç ka qenë duke kundërshtuar paragrafin në nenin 27 të propozuar nga presidentja. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Ministër, a po i dëgjojmë do diskutime janë lajmëruar deputetët, pastaj sqarimi është juaji. Dakord. Fjalën e ka kërkuar deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje” kundërshtojmë rekomandimin e presidentes, pra amendamentin që e ka kthyer presidentja duke vlerësuar që është i pabazuar, madje është i pabazuar edhe mbi pikën 84.6 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Shembulli i kthimit të ligjeve në këtë formë është bërë një shembull jo i mirë për shkak se shumë ligje janë kthyer nga presidentja jo të mbështetura mbi nenin 86 të Kushtetutës e cila i garanton apo i jep të drejtë presidentes apo presidentit të kthejë ligjet apo amendamentet e veçanta.

Mendojmë që kthimi i Ligjit për pensionet e FSK-së ka qenë i pambështetur dhe i paarsyetuar për shkak që nuk e rrezikonin dhe nuk do ta rrezikonin kurrë pensionet e FSK-së, as buxhetin e Republikës së Kosovës për shkak të masës shumë të vogël që kanë pensionistët e FSK-së dhe po ashtu më lejoni t’ju them që në konkluzën që jep presidentja ku thuhet pa inkorporimin e këtij neni do të rrezikohej funksionimi demokratik dhe kushtetues i institucioneve të Republikës së Kosovës, mendoj që ky arsyetim dhe kjo konkluzë nuk qëndron.

Pra, pensionistët apo pensionet e veteranëve, pensionet e invalidëve, familjeve të dëshmorëve dhe pensionet e ushtarakëve, nuk do të duhej këto pensione të ishin ato pensione të cilat do ta bartnim barrën e mosmarrëveshjeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që ka krijuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Pra, përveç se nuk është i mbështetur ky arsyetim mendoj që nuk është i nevojshëm kthimi i këtij ligji dhe si të tillë lëvizja “Vetëvendosje” nuk e mbështet rekomandimin e presidentes së

Republikës së Kosovës, duke menduar që ka qenë i paarsyetueshëm, i pambështetur dhe krejt i panevojshëm kthimi i këtij neni për të amendamentuar sërish. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja, Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Është mirë që është përpiluar ky projektligj për përfitimin e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, këto pensione, dhe këtë projektligj e kemi miratuar në një nga mbledhjet e kaluara. Projektligji, siç jeni në dijeni është kthyer nga presidentja e Republikës së Kosovës, duke iu shtuar një paragraf nenit 27 me përmbajtjen tash më të njohur për deputetë. andaj, me këtë paragraf neni nënkuptohet kur kemi para, ju japim dhe kur s'kemi para nuk iu japim.

Ndërsa konkluzat e përpiluar nga presidentja kur thotë rrezikohet funksionimi demokratik i institucioneve të Republikës së Kosovës, si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, mendojmë që nuk qëndron, andaj Grupi jonë parlamentar nuk e mbështet dhe nuk e miraton këtë nen me këtë paragraf. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputetë! Fjalën e ka deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pa u lëshuar në arsyetimin e kthimit të ligjit prej presidentes sa ka qenë ligjore dhe i arsyeshëm, besoj që arsyeja kryesore për ta propozuar grupi parlamentar që të miratohet ky paragraf në nenin 27 është arsyeja e relacionit që ka Kosova me Fondin Monetar Ndërkombëtar edhe duke u bazuar në zotimet e Qeverisë, letrën zotuese për të qenë funksional gjithëherë edhe për t' i absorbuar të mirat prej programeve financiare që dalin prej Fondit Monetar Ndërkombëtar e këtë tërthorazi edhe me Bankën Botërore, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, propozon që të aprovohet ky paragraf. Arsyetim tjetër është edhe mundësia edhe pritja e disa pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë që të pensionohen, planifikimet që i ka bërë Forca e Sigurisë për një periudhë kohore me dinamikën e paraparë dhe me fondet e ndara për pensionimin e këtyre pjesëtarëve, gjegjësisht ish -pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë. Andaj, lus gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës që të votojnë këtë paragraf të propozuar edhe më parë nga Qeveria për t'ia lehtësuar edhe Forcës së Sigurisë, por edhe Qeverisë relacionin me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra, deputetë,

Unë mendoj që propozimi i presidentes është shumë i padrejtë, i paarsyeshëm dhe në asnjë mënyrë nuk duhet pranohet për arsye se është fjala për pensionet e disa pjesëtarëve të FSK-së. Këta, pjesa dërmuese e këtyre ish -ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët tash

duhet të shkojnë në pension dhe mendoj se vendimet të tilla fyejnë edhe dinjitetin e atyre njerëzve të cilët kanë qenë në vijën e parë të frontit dje.

Arsyetimin që jep presidentja se mund të rrezikohet sistemi financiar i Kosovës nuk qëndron, po ashtu edhe rekomandimet që japin nga FMN-ja janë shumë të paarsyeshme dhe të paqëndrueshme dhe në asnjë mënyrë rekomandime të tilla nuk duhet të pranohen.

Çështja tjetër është se pjesa më e madhe e këtyre njerëzve janë edhe kryefamiljarë dhe në rast të shkuarjes në pension ata duhet të mbajnë familjen dhe gjithsesi janë mbajtës të familjes.

Mosha e tyre është e tillë se kanë vështirë të gjejnë vende të punës, prandaj një pension i plotë për ata është i domosdoshëm. Unë u bëj thirrje gjithë deputetëve që mos ta pranojnë një propozim të tillë të presidentes tepër të paarsyeshëm, tepër të panevojshëm dhe në një farë mënyre që prek dinjitetin e njerëzve që dje kanë qenë pjesë e luftës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti dhe i fundit le të përgatitet deputeti Daut Haradinaj.

SABRI HAMITI: Zotni kryetar, falemnderit!

Zotni ministër, më i durueshmi që rri këtu,

Kolegë të nderuar,

Unë, normalisht që nuk e ndaj mendimin, e kam mendimin për këtë çështje që e tha zonja deputete e LDK-së, por po ndiej nevojë sot dhe këtu të nënvizoj që ky Kuvend nuk duhet të hartojë ligjet që nuk zbatohen. Kam parasysh edhe këto dilema që po dalin tash, por edhe ligje të tjera. Kjo ka të bëjë edhe përkufizime kohore. Ne kemi hartuar edhe ligje të tjera për kategori të veçanta ku thuhet, zbatohet mbas kaq muajsh ose kaq viti dhe ku kanë futur nene të tilla kufizuese, sepse nëse futet një nen i tillë në cilindo ligj, unë e di që ekzistojnë dhe në ligje të tjera, atëherë i jepet mundësia që Qeveria cilado qoftë kjo sot apo ajo nesër, të silllet në mënyrë arbitrare dhe në mënyrë politike dhe politiciste në momente të caktuara me kategori të caktuara, që i bie për t'i përdorur politikisht dhe kjo është antikushtetuese dhe është antiligjore.

Dhe e treta, është interesant mënyra dhe arsyetimi i presidentes që s'i takon. Arsyetimet që ajo i jep në të vërtetë janë interesa të Qeverisë, cilado qoftë, në këtë rast Qeverisë së sotme, dhe nuk është kujdestare presidentja për çështjet financiare, është Qeveria që merret me ato punë. Unë e di që është metodë që të kalohet për andej, po ju sikur unë e dini që është një nen që s'ka kaluar në Komision parlamentar, që s'ka kaluar në Parlament dhe natyrisht nuk ka arsye të kalojë edhe me këtë urgjencë qeveritare, me firmën presidenciale. Unë mendoj që kjo është kategori që duhet parimisht nëse jepet kjo e drejtë t'ju jepet kjo e drejtë dhe të mos ju shkurtohet qoftë për humorin e një qeverie ose një garniture pushtetare, qoftë për arsyetimet financiare që gjithmonë kalkulohen në buxhete dhe në bazë të ligjeve që janë në fuqi. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti, Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Falemnderit, kryetar!

Më së pari një propozim i tillë sigurt që s'ka për të kaluar se koalicioni i ka veç 10 deputetë në sallë edhe absolutisht është e pamundur, po sido që të jetë nuk mendoj që e dëmtojnë buxhetin e Kosovës, 70 pjesëtarë në vjet nëse dalin në pension, ministër, edhe shumë më interesant do të ishte për juve në rast se ju i kishit hequr do zëvendësministra, ua kishit rralluar disa kerre këshilltarëve që i keni bërë dy- tre qind se sa t'ua hiqni pensionet 70 pjesëtarëve në situata kriza.

Ju lus deputetët që ta hedhin poshtë propozimin e presidentes.

KRYETARI: Fjalën e ka ministri për Financa, zoti Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Falemnderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Siç jeni në informacion, më datën 27 prill Fondi Monetar Ndërkombëtar ka aprovuar programin me Republikën e Kosovës.

Unë dua t' i falënderoj deputetët e Kuvendit të Kosovës për punën e tyre dhe për mundësinë që ne të arrijmë në këtë program.

Ky program, përveç rëndësisë financiare dhe ekonomike ka edhe rëndësinë e vet politike dhe rëndësi tjera.

Financiarisht dhe ekonomikisht ky program mundëson që Qeveria e Republikës së Kosovës, Kosova t'i ketë përfitimet nga Banka Botërore deri më 30.6, 50 milionë dollarë, të ketë përfitime nga Fondi Monetar Ndërkombëtar 107 milionë dhe gjithashtu edhe fondet e Komisionit Evropian, si përkrahje direkt buxhetore lidhen me këtë program.

Unë dua t' i falënderoj deputetët e Kuvendit të Kosovës që e kanë miratuar një ligj, por edhe Qeveria ka sponsorizuar një ligj për pensionimin e pjesëtarëve të FSK-së. Të gjithë e dimë që këta njerëz e meritojnë, mirëpo besoj që është bërë një trajtim korrekt i tyre dhe janë në pozitë më të mirë se sa kategoritë e tjera.

Ka pasur kërkesa që me rastin e skadimit të kontratave të tyre të punës të mos u vazhdohet. Ka pasur kërkesa që me rastin e pensionimit të tyre të trajtohen si gjithë pensionistët e tjerë. Mirëpo, ky ligj është përgatitur mirë, është përkrahur nga të gjitha institucionet dhe është ligj që përmban koston e hollësishme për periudhën e ardhshme. Nuk kemi të bëjmë me 70 pjesëtarë të FSK-së, po kemi të bëjmë me ma shumë dhe është në mënyrë tabelore e specifikuar nëpër secilin vit kur priten të pensionohen, është kosto e llogaritur dhe është pjesë e tabelave të buxhetit.

Dua t' ju siguroj, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, që fillimisht kriza dhe problemet financiare në Kosovë nuk janë në sipërfaqe dhe nuk jemi në vështirësi.

E dyta, nëse vijmë te shkurtime buxhetore, ka mundësi të ndodhin shkurtime buxhetore në shumë pozicione tjera para se të ndodhin këto. Programi i Kosovës, me Fondin Monetar Ndërkombëtar, tash është publik.

Në pikën 9, të letrës së qëllimit nuk kemi të bëjmë vetëm me Ligjin për pensionimin e pjesëtarëve të FSK-së, po kemi të bëjmë me të gjitha ligjet që kanë pagesa prej buxhetit të Kosovës.

Në pikën 9, nën c. thotë: Çdo ligj i tillë, ndryshim ligji ose rregullore, do të përfshijë një nen që në mënyrë eksplicite lejon shkurtime e përfitimeve në rast të fondeve të pamjaftueshme buxhetore, është kriter i vazhdueshëm strukturor. Mosplotësimi i kriterit strukturor nënkupton që automatikisht ne mund ta humbim marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Prandaj, nuk kemi të bëjmë me shkurtime. I njëjti nen do të jetë edhe është pjesë e Ligjit për skema sociale, pjesë e ligjit për kategoritë e dala nga lufta, pjesë e ligjit për pensionet dhe pjesë e të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me përfitime prej buxhetit të Kosovës.

Prandaj, në rast të vështirësive financiare, por nëse s'ka para ai nënkuptohet që s'do të kenë mundësi t' i marrën si ke ky, si s'ke. Po, prandaj, ju lutna që ta përkrahni propozimin dhe kjo të jetë pjesë e ligjit me qëllim që ne të vijmë në situatë që ta implementojmë ligjin, me qëllim që këta njerëz t' i përfitojnë këto pensioni të cilat, realisht i meritojnë. Konsiderojmë që është kategori që është trajtuar brenda mundësive reale buxhetore më korrekte dhe unë ju ftoj që të njëjtën ta përkrahni. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, ministër!

Ministër i Forcës së Sigurisë, a e donë fjalën? Jo.

Në sallë janë prezentë 71 deputetë.

Ju i dëgjuat edhe kryetarin e Komisionit, edhe deputetët që morën pjesë në debat edhe ministrin përkatës. Po unë dua t' ju tërheq vërejtjen se për t'u miratuar kërkesa e presidentes, duhen së paku 61 vota.

(Reagim nga salla)

Nëse nuk e qesim sot duhet ta qesim në seancën e radhës. Mirë, realisht unë po kërkoj nga deputetët që ta kenë parasysh arsyetimin e ministrit dhe lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 29 vota "për", 34 "kundër" dhe 2 abstenime, Kuvendi nuk e miraton amendamentin e propozuar nga presidentja.

Mirupafshim në mbledhjen e radhës!

Përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë e Kuvendit të Kosovës